

Summary of the general Local Plan of Dropull Municipality

Working group: *Besnik Aliaj, Sotir Dharmo, Sherif Lushaj, Godiva Rembeci, Eranda Janku, Amanda Terpo, Dea Buza, Ledian Bregasi.*

Dropull Municipality: *Mihal Mano, Gage Meci, Niko Papaile, Alqi Kazaqi, Mite Mejdi, Abana Curi, Thalia Pulla, Lindita Xhumba, Spiro Kallo, Thanas Naka, Lefter Nasto.*


Assistants: *Dea Rogova, Aldo Sulaj, Joana Pavli, Klevis Delli, Andrea Rapo, Esmerina Hidri, Reada Lemnusha, Sadmira Malaj.*

Summary*

The inhabitants of Dropull have historically recognized themselves as a community, kept together by the common traditions, culture and territory. But it was during the recent years that the territory was comprised in one municipality. The establishing of the new administrative unit created the opportunity for developing a new General Local Plan. POLIS University offered to the newly formed municipality the possibility of drafting the plan in a participated process that would profoundly and comprehensively involve the community. The plan is one of the most important instruments for governing the territory and for managing the future opportunities. In this sense the plan is structured in a series of consecutive documents, organized in three groups. The initial and primary document is the analysis of the territory, its culture and its economy. Out of this analysis a series of treats and opportunities emerge. The second document builds on the strengths of the municipality and tries to translate the opportunities into a vision. Dropulli's vision foresees the municipality as a linear development corridor of settlements, and as rural development pole between the regional centers of Gjirokastra and Ioannina, from one side and the southern mountain ranges of Albania and the Ionian coast on the other. A territory with a strong historical and cultural character and identity, a model of coexistence between different nationalities, an important gateway to the cross-border area and a bridge between Albania and Greece.

The municipality can turn into a center focused on the development of tourism, agriculture, livestock, and processing industry that utilizes local products to create a complete production cycle. The territory can welcome and provides space for research and for the establishment of start-ups based on tourism and bioproducts. In this way it can become a cross-border pole that uses sustainably the potential of a consolidated local economy and a favorable atmosphere for the return of population and for the attraction of investments. In order to achieve this vision, in the third and implementation part of the plan, four strategic objectives are proposed. The first one fosters the higher accessibility to the territory and its integration to the larger infrastructural networks. This topic represents one of the most important challenges to the new municipality which is heavily influenced by the geographic position and by the rough terrain. The second strategic objective is the strengthening of the regional and cross border economic position through the development and diversification of the local economic activities. In this case, the geographic position of the municipality can be further exploited in order to become part of larger exchanges networks. The fourth strategic objective is the protection of the rural character of the settlements and the improvement of the quality of life. This objective is one of the most complex to achieve because it requires the creation of a balanced and sustainable development model which gives value to the historical settlements, without altering them but at the same time avoiding the freezing of every development initiative. The fourth and final strategic objective foresees the protection of the environment and the prevention of natural hazards. The strategic objectives are then turned into an operative form through the proposal of programs and projects which are consequently represented in the land use plan and in a budget.

Summary prepared by PhD Ledian Bregasi



Source/ Dropull Municipality

PARIMET E PLANIFIKIMIT DHE METODOLOGJIA E HARTIMIT TË STRATEGJISË

1.1 Parimet e Planifikimit për hartimin e Strategjisë Territoriale

Strategjia Territoriale e Bashkisë Dropull u hartua nga Bashkia Dropull në bashkëpunim me Universitetin POLIS. Kjo strategji formon dokumentin bazë mbi të cilin do të hartohet Planin i Përdorimit të Tokës dhe Rregullorja e Zhvillimit. Strategjia ka si qëllim:

- Të ofrojë një vizion dhe drejtim konsistent, si dhe një vlerësim strategjik jo vetëm të asaj që është e dëshirueshme, por edhe asaj që është e mundshme në kontekste të ndryshme;
- Të mbrojë të drejtat e njerëzve. Aksesimi në tokë përkthehet në të drejta dhe obligime, ndaj është e nevojshme që të menaxhohet ndryshimi, që këto të drejta dhe obligime të respektohen;
- Të mbrojë sistemet natyrore. Sistemet natyrore kanë kërkesa operacionale, të cilat duhet të respektohen për të mbrojtur qëndrueshmërinë afat-gjatë të zhvillimit njerëzor, si dhe për të evituar degradimin mjedisor në shkallë të madhe;
- Të sigurojë përdorimin eficient të burimeve, si toka, uji, energjia, financat, materialet e ndërtimit, aftësitë etj.;
- Të arrijë një cilësi të lartë të ofrimit të shërbimeve në të gjitha fushat e qeverisjes;
- Të koordinojë veprimet dhe investimet që të sigurojë impaktin pozitiv maksimal nga investimi i burimeve. Ka mjaft rëndësi që investimet të koordinohen në hapësirë dhe në kohë. Gjithashtu koordinimi duhet të jetë si ndërmjet formave të ndryshme

të veprimeve nga autoritetet publike, ashtu edhe midis veprimeve të ndërmarra nga autoritetet publike dhe ato private sëbashku;

- Të vendosë prioritetet. Të mundësojë krijimin "e rrugëve" të ndërmjetme që nevojat për zhvillim të një vendi të arrihen në mënyra të drejta;

- Të evitojë dublikimin e përpjekjeve nga departamente dhe sfera të ndryshme të qeverisjes.

Bazuar në ligjin 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në fuqi, Strategjia Territoriale për Bashkinë Dropull është e strukturuar si më poshtë:

Kapitulli i Metodologjisë (në këtë kapitull shpjegohet mënyra e përdorur për formulimin e Strategjisë Territoriale);

Kapitulli i Analizës S.Ë.O.T (në këtë kapitull strukturohen konkluzionet e fazës së parë të analizës së territorit. Konkluzionet e bazuara në analizën S.Ë.O.T shërbejnë për zhvillimin e Vizionit, Objektivate Strategjike dhe më pas të Programeve, Politikave e Projekteve);

Kapitulli i Vizionit dhe Objektivate Strategjike (në këtë kapitull shpaloset Vizioni Strategjik për zhvillimin e Bashkisë Dropull në 15 vitet e ardhshme. Ky Vizion më pas detajohet në Objektiva Strategjike); Programet dhe Politikat (Objektivat Strategjike operacionalizohen me anë të programeve. Secili program, sipas rastit, shoqërohet me një kombinim Politikash dhe Projektesh, të cilat mundësojnë arritjen e Objektivate);

Projektet (Plani i Investimeve Kapitale/ Plani i Veprimit, shtjellon projektet dhe i kategorizon ato në kohë, prioritet dhe





hapësirë. Matrica e projekteve i shërben Bashkisë gjithashtu edhe në hartimin e Programeve Buxhetore afatmesëm si dhe në tërheqjen e donatorëve, apo në aplikime për financime);

Projekt Fishat (secili projekt shoqërohet me një projekt fishë, ku shtjellohet në mënyrë të detajuar projekti, koha e realizimit, aktorët përgjegjës, burimi i financimit etj. Projekt fishat më pas mund të përdoren për kërkimin e financimit të projekteve nga donatorët, aplikimin për fonde pranë instancave të ndryshme, si dhe angazhimin e partneriteteve publike-private për implementimin e projekteve).

1.2 Parimet e Planifikimit për Strategjinë e Bashkisë Dropull

Në hartimin e Strategjisë Territoriale për Bashkinë Dropull u përcaktuan disa parime për të udhëhequr metodologjinë dhe më tej hartimin e strategjisë dhe objektivave specifike. Në këtë mënyrë u garantua cilësia dhe u sigurua një përqasje e hapur, transparente dhe gjithëpërfshirëse në formulimin e strategjisë territoriale, jo vetëm duke respektuar bazën ligjore e plotësuar qëllimet e dokumentit, por edhe duke krijuar bazat e një etike pune, e cila do të mund të forcohet më tej me implementimin dhe bërjen operationale të strategjisë.

- Parimi Demokratik

Që procesi i planifikimit të territorit të jetë legjitim dhe eficient vendimmarrja duhet të jetë transparente, e drejtë dhe e bazuar në parimet e qeverisjes demokratike. Planifikimi i territorit si një nga detyrat kryesore të qeverisjes, ka një impakt të

drejtpërdrejtë mbi cilësinë dhe kushtet e jetesës. Në këto kushte në mënyrë të ndërsjelltë një qeverisje e mirë është baza e një planifikimi të qëndrueshëm.

- Parimi i Pjesëmarrjes

Vendimmarrja bëhet legjitime kur ndër të tjera është transparente dhe gjithëpërfshirëse. Përfshirja e të gjithë grupeve të interesit në procesin e planifikimit jo vetëm krijon kushtet për një proces demokratik dhe të paqtë, por u jep të gjithë aktorëve ndjenjën e përkatësisë dhe përgjegjësisë.

- Parimi i Integritetit dhe Bashkërendimit
Planifikimi i territorit është një proces, i cili për të qenë i suksesshëm duhet të bashkërendojë vendimmarrjen në shkallë të ndryshme dhe të integrojë të gjithë autoritetet përgjegjës. Struktura operationale e planifikimit të territorit duhet të mbështetet në një kornizë strategjike, institucionale dhe ligjore të mirë-integruar për të eliminuar çdo mundësi për mbivendosjen e institucioneve, ligjeve apo të kompetencave, gjë që do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë qëndrueshmërinë e strukturës.

- Parimi i Proporcionalitetit

Planifikimi duhet të dëshmojë një angazhim të fortë dhe udhëheqës të Qeverisë në proceset zhvilluese, në formën e politikave të qarta dhe robuste. Në të njëjtën kohë politikat e planifikimit duhet të kenë fleksibilitet të mjaftueshëm për t'u adaptuar me ndryshimet ekonomike, sociale dhe teknologjike, si dhe duhet të marrin në konsideratë interesat e aktorëve



Source/ General Local Plan of Dropull Municipality

të ndryshëm, për të qenë të drejta, proporcionale dhe të garantojnë ekuilibrin midis interesave publike dhe private në zhvillimin e territorit.

- Zhvillimi në bazë zone

Ky parim synon kthimin drejt një qasjeje të re për të eliminuar përfundimisht zhvillimin në bazë parcele, i cili nuk koordinohet me politikat e autoriteteve publike dhe thith në mënyrë të padrejtë të gjitha të drejtat e zhvillimit në një zonë.

- Zhvillimi ligjor i tokës dhe rikuperimi i vlerës së krijuar

Aplikimi i të drejtës së zhvillimit në bazë parcele që aplikohet nga procesi i planifikimit krijon përfitim për pronarin ose zhvilluesin, ndërkohë që kostot i ngarkohen territorit, pra bashkisë dhe si rezultat edhe shoqërisë. Zhvillim i drejtë ndodh kur vlera e krijuar i kthehet atij që e krijon – pra shoqërisë, dhe përfituesi mbulon kostot e veprimit të tij.

- Vendimmarrja e drejtuar për qëndrueshmërinë

Ky parim konsiston në aplikimin e politikave dhe investimeve që promovojnë qëndrueshmërinë, jetueshmërinë dhe aftësitë për të përballur presionet mjedisore, ekonomike dhe sociale.

- Investimet Strategjike

Investimet duhen bërë në infrastrukturë, programe dhe projekte, të cilat shfaqin një ndikim të qartë tek borët dhe zhvillimi ekonomik.

Politika Efektive

Qeverisja duhet të ketë një theks të fortë të pjesëmarrja e shoqërisë civile, partneritetet e shëndetshme publike-private dhe zbatueshmëria e vazhdueshme.

1.3 Metodologjia

1.3.1 Analiza e Planeve të Hartuara më Parë

Metodologjia e Hartimit të Strategjisë së Zhvillimit të Territorit është bazuar në praktikën e “Planifikimit Strategjik”. Në këtë kuadër, për të njohur kontekstin në të cilin ndodhet dhe që impakton në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë zhvillimin e Bashkisë Dropull, u shqyrtuan të gjitha dokumentet e planifikimit të territorit në shkallë të ndryshme, duke nisur nga ato ndërkombëtare e kombëtare, në ato rajonale e vendore.

Analiza e Planeve Ndër/Kombëtare

- Strategjia 2020 e Evropës Juglindore-Punësimi dhe prosperiteti në një këndvështrim Evropian (BE/ Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal);

- Programet e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA – Programi “Greqi- Shqipëri 2014-2020”;

- Plani i Përgjithshëm Kombëtar Plane Rajonale/ Qarku

- Strategjia e Zhvillimit të Qarkut Gjirokastrë 2005-2015;

Plane Vendore


- Plani Operacional për Zhvillimin Lokal të Bashkisë Dropull;


Plane territoriale të Bashkive fqinje që impaktojnë zhvillimin e Bashkisë Dropull

- Planet Operacionale për Zhvillimin Lokal të Bashkive fqinje Libohovë, Delvinë, Finiq, Përmet;

LEGJENDA

- BASHKIA DROPULL
- "GREEN BELT" / FASHA E GJELBËR
- VIJA BREGDETARE / TURIZMI BREGDETAR
- QENDËR RAJONALE
- ZONË EKONOMIKE (PËRPUNIM PRODUKTESH)
- ZONË EKONOMIKE (BLEGTORI / BUJQËSI)
- ZONË EKONOMIKE (PEJZAZH / AGRO-TURIZËM)
- KUFI SHTETËROR SHQIPËRI - GREQI
- AUTOSTRADË
- RRUGË INTERURBANE KRYESORE
- RRUGË LOKALE
- RRUGË INTERURBANE KRYESORE (PROPOZIM)
- RRUGË LOKALE (PROPOZIM)
- LIDHJE DETARE (TURIZËM + TREGËTI)
- QENDËR E BANUAR KRYESORE (POL)
- QENDËR E BANUAR DYTËSORE
- 🌲 PARK KOMBËTAR





- Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Gjirokastrër;
 - Plani Rajonal për Rajonin e Janinës.
- Pas studimit dhe vlerësimit të materialeve të mësipërme dhe strategjive përkatëse, grupi i punës është thelluar më tej në analizat e gjeneruara me anë të sistemit GIS në bazë të parashikimeve ligjore, por jo vetëm, duke u munduar të investigojë të gjitha problematikat, potencialet dhe sfidat e kontekstit mjaft specifik të Bashkisë Dropull.

1.3.2 Parashikimet që rrjedhin nga plani i Përgjithshëm Kombëtarë

Plani i Përgjithshëm Kombëtar është një document i cili ka synon të nxisë përdorimin e qëndrueshem të burime dhe potencialeve të vendit. Ky document shërben si një koncept cadër, i cili orienton zhvillimin e aseteve dhe rritjen ekonomike për njësitë e qeverisjes vendore. Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) “Shqipëria 2030”, vjen si detyrim për zbatimin e kornizës ligjore, i përcaktuar si dokument referues i detyrueshëm për të gjitha planet që hartohen në Republikën e Shqipërisë. Bazuar në Planin e Përgjithshëm Kombëtar të publikuar nga AKPT dhe MZHU, disa nga direktivat kryesore të cilat rrjedhin për PPV të Bashkisë Dropull janë:

- Bashkia Dropull është pjesë e Rajonit Tepelenë- Gjirokastrër- Sarandë, gjithashtu kondisderuar si Pol Zhvillimi Rajonal;
- Në këtë Rajon Bashkia Dropull konsiderohet si qendër terciare;
- Territori i Bashkisë Dropull konsiderohet si zonë, në të cilën prioritare janë fuqizimi i zhvillimit dhe rigjenerimi e kooperimi, me specializim drejt ekoturizmit, turizmit të aventurës, blegtorisë, bujqësisë, e sektorit përpunues;
- Bashkia Dropull është një zonë strategjike ndërkufitare, ku bashkëveprimi me territorin përtej kufirit është gjithashtu një prioritet. Pika kufitare e Kakavijës ndodhet në territorin e Bashkisë Dropull;

- Shumë shërbime Bashkia Dropull do të mund t'i marrë nga Gjirokastra dhe Saranda, që përpos fatit që kanë distanca relativisht të vogla nga Dropulli, konsiderohen nga PPK si Metropole dhe Porta Hyrëse. Ndër të tjera Gjirokastra do të ofrojë edhe shërbimin e aeroportit, dhe Saranda të portit detar;

Përmes territorit të Bashkisë Dropull kalon një nga akset primare infrastrukturore të rëndësishë kombëtare, që lidh Tiranën me Gjirokastrën, e më tej shkon drejt zonës ndërkufitare për t'u lidhur me Janinën;

- Hekurudha e propozuar nga PPK dhe PPV

i Bashkisë së Gjirokastrës, kalon gjithashtu përmes territorit të Bashkisë Dropull dhe pritët të ketë një impakt të madh përsa i përket jo vetëm integritit të Shqipërisë në rrjetin hekurudhor Ballkanik e European, por në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe të vetë Bashkisë Dropull me rajonin përreth, brenda dhe përtej kufirit;

- Zona e Mbrojtur e Pyllit të Bredhit të Sotirës i jep zonës së Dropullit rëndësi në panoramën kombëtare të habitateve të mbrojtura, ku në rastin konkret Zona e Mbrojtur ka rëndësi edhe për rajonin ndërkufitar dhe kthehet në një objekt të projekteve të mundshme të bashkëpunimit ndërkufitar.

1.3.3 Puna dhe mbledhja e të dhënave në terren

Për të realizuar me sukses këtë fazë grupi i punës nuk është mjaftuar vetëm me të dhënat zyrtare të siguruar nga institucionet përkatëse, por ka realizuar gjithashtu një databazë të dedikuar territorit të Bashkisë Dropull falë vizitave të shumta studimore në terren. Deri në këtë fazë janë zhvilluar gjithsej 7 ekspedita 2-3 ditore pune dhe 4 ekspedita 1 ditore.

Vizita 1: 14-15 Dhjetor 2016

- Njohja me territorin e Bashkisë Dropull. Vizitat në çdo fshat në Njësitë Dropull i Sipërm dhe Dropull i Poshtëm.

Vizita 2: 25-26 Janar 2017

- Njohja me territorin, problematikat dhe sfidat e Njësisë së Pogonit.

Vizita 3: 8-9 Shkurt 2017

- Kryerja e pyetësorëve mbi ofrimin e shërbimeve, ekonominë dhe kushtet e banimit, në të 41 fshatrat e Bashkisë Dropull. Një pjesë e grupit ju dedikua takimeve me të gjitha bizneset (AGNA, ELKA, GLINA, Gjirofarma etj.) që operojnë në territorin e Bashkisë së Dropulli.

Vizita 4: 15-16 Mars 2017.

Takime me bashkitë fqinje Gjirokastrër, Libohovë, Finiq dhe më Prefektin e Qarkut Gjirokastrër. Një pjesë e grupit të punës vazhdoi ndërkohë punën në terren për mbledhjen e të dhënave në lidhje me demografinë, punësimin dhe ekonominë, dhe problematikat mjedisore.

Vizita 5: 5-6 Prill 2017

- Takim me Prefektin e Rajonit të Janinës dhe ekipin e tij të ekspertëve. Gjatë takimit u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi midis dy palëve, Rajonit të Janinës dhe Bashkisë Dropull.

Vizita 6: 23-24-25 Prill 2017

- Punë në terren në Njësinë Administrative të Pogonit në kuadër të hartimit të VSM. Njohja me problematikat kryesore mjedisore.

Vizita 7: 5 Maj 2017

- Dëgjesa e parë publike me grupet e interes në kuadër të hartimit të VSM dhe prezantimi me rëndësinë e hartimit të PPV dhe hapat përkatës që do të shoqërojnë të gjithë procesin.

Vizita 8: 12-13-14 Maj 2017

- Punë në terren për katalogimin e përdorimit dhe gjendjes së çdo godine në të 41 fshatrat e Bashkisë Dropull.

Vizita 9: 13 Korrik 2017

- Dëgjesa e dytë publike në lidhje me prezantimin e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit.

Vizita 10: 17 Tetor 2017

- Konsultim final i materialit të korigjuar të Analizës dhe Vlerësimit të Territorit, pas komenteve të mara nga AKPT, dhe konsultim paraprak i Strategjisë, Objektivave dhe Projekteve.

Vizita 11: 2 Nëntor 2017

- Konsultim dhe punë përgatitore për Strategjinë Territoriale.

1.3.4 Skenarët e Propozuar

Duke marrë parasysh të gjitha analizat e bëra mbi territorin e Bashkisë Dropull dhe duke u bazuar në dinamikat sociale dhe ekonomike të zonës, u morën në konsideratë 3 skenare bazë për zhvillimin e territorit.

Skenari 1: Dropulli, zonë rurale ndërkufitare Bashkia Dropull, një territor me identitet rural bujqësor, turistik që karakterizohet nga vendbanime dhe shërbime të decentralizuara. Një zonë tranzit e pjesës ndërkufitare midis dy qendrave rajonale Gjirokastrë dhe Janinë, e pasur me potenciale natyrore dhe peizazhe të mbrojtura.

Skenari 2: Dropulli, një satelit shërbimesh industriale

Bashkia Dropull, një satelit i Gjirokastrës dhe vend-përqëndrim i shërbimeve dhe njësive ekonomike përpunuese më të mëdha të Rajonit Jugor Shqipëtar. Hambar produktesh dhe zonë ekonomike me rëndësi ndërkufitare, që siguron konkurrencë, ekonomi shkallë dhe mundësi punësimi për popullsinë e zonës, si brenda dhe jashtë kufirit.

Skenari 3: Dropulli, portë hyrëse dhe pol zhvillimi rural

Bashkia Dropull, pol zhvillimi rural midis dy qendrave rajonale Gjirokastrë, Janinës dhe vargmaleve jugore të Shqipërisë dhe bregdetit të Jonit, me fokus në zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, turizmit dhe industrisë përpunuese. Një territor me karakter dhe identitet të fortë historik e kulturor, model i bashkëjetesës midis kombësive të ndryshme, dhe urë lidhëse midis Shqipërisë dhe Greqisë. Një territor që përdor në mënyrë të qëndrueshme potencialet për një ekonomi lokale të konsoliduar dhe atmosferë favorizuese për kthimin e popullsisë dhe tërheqjen e investimeve.

KAPITULLI 2- ANALIZA S.W.O.T

S.W.O.T

Bazuar në VKM 671 dt. 29/07/2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" analiza S.W.O.T është orientuar në bazë të 5 (pesë) sistemeve territoriale. Ndërkohë, është gjykuar si e arsyeshme që të përfshihet një element i 6-të në strukturën e analizës, i cili konsideron "kuadrin institucional". Analiza do të shërbejë më pas si bazë për programet dhe politikat, në mënyrë që ato të marrin në konsideratë dhe zbatueshmërinë apo masat për të arritur në zbatimin e tyre.

PIKAT E FORTA

Sistemi Institucional

- Ndërgjegjësim i lartë për detyrimet qytetare/ publike në pagimin e taksave (si popullsia banuese e përhershme, ashtu edhe ajo emigruese e sezonale);
- Administratorët e Njësive (Dropull i Sipërm, Dropull i Poshtëm, Pogon) kanë njohje të mirë të territorit dhe mbajnë lidhje të ngushta me kryetarët e çdo vendbanimi (fshati);
- Si administrata, ashtu edhe popullsia lokale janë mjaft mbështetës dhe të gatshëm të kontribuojnë dhe punojnë sëbashku për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për territorin e Bashkisë Dropull;
- Remitancat kanë lehtësuar investimet e Bashkisë në infrastrukturë dhe shërbime ekonomike/tregtare (banorët kanë vetë-financuar përmisimin e këtyre shërbimeve);

Sistemi i Vendbanimeve

- Zona me trashëgimi të pasur kulturore dhe historike;
- Rrjet i pasur monumentesh me rëndësi fetare dhe arkeologjike;
- Traditë në përpunimet artizanale;

- Karakteristika dalluese arkitektonike;
- Bashkëjetesë midis etniciteteve të ndryshme;
- Pozicionim strategjik midis Shqipërisë dhe Greqisë;
- Prani të bizneseve të mëdha me impakt ndërkombëtar;
- Distanca të vogla midis zonave të ndryshme të banuara;
- Ri-konstruktim dhe restaurim i shesheve kryesore dhe disa prej banesave tipike (remitancat si burim financiar);

Sistemi Infrastruktural

- Vendbanimet shtrihen përgjatë aksit kryesor infrastrukturor dhe lidhen midis tyre përmes këtij aksi;
- Afërsi me pikën kufitare të Kakavijës – Portë hyrëse për në Shqipëri nga Greqi;
- Afërsi me portet e Igoumenitsa-s dhe Sarandës;
- Afërsi me qendrat rajonale Gjirokastër dhe Janinë;
- Sistemi bujqësor ka ruajtur një pjesë të madhe të infrastrukturës mbështetëse të vaditjes dhe kullimit;
- Sistemi Hidrik
- Rrjet i pasur hidrografik – Afërsi ndaj luginës së Drinosit;
- Prania e burimeve ujore në afërsi të zonave të banuara;
- Burime të pasura ujore nën-tokësore;
- Prania e ujit në afërsi të zonave bujqësore;
- Ekzistenca e pikave me atraksion kulturor dhe historik/ natyror (Lumi Drinosit, Lumi Suhës, Liqeni Viroit, Shpellat nën-ujore të Viroit dhe Skotinisë, etj.);

Sistemi Bujqësor / Blegtoral

- 18.3% e sipërfaqes së përgjithshme është tokë bujqësore;
- Bujqësia përbën një nga degët kryesore të zhvillimit ekonomik për Bashkinë e Dropullit;
- Bonitet i tokës ka përgjithësisht katëgorinë III, III-IV dhe IV-V;
- Varietet produktesh;
- Iniciativa private për përpunimin e produktit vendas në mënyrë artizanale dhe krijimin e një marke lokale;
- Kërkesë në rritje në treg për produkte lokale/artizanale;
- Sistemi Natyror
- Pejzazhi dhe natyra përbëjnë një nga sistemet mbizotëruese në Bashkinë Dropull;
- Zona me karakteristika të veçanta natyrore dhe pejzazh dallues;
- Shpërndarje të zonave natyrore në të gjithë territorin e Bashkisë dhe një marrëdhënie e ngushtë e tyre me vendbanimet;
- Monumete të shumta natyrore;

- Shumëllojshmëri e relievit/ malor/ kodrinor/ fushor/ lumor;
- Sipërfaqja Natyrore përbën 78% të sipërfaqes së përgjithshme të Bashkisë, nga ku pyjet përfaqësohen me rreth 12,061 ha.

PIKAT E DOBËTA

Sistemi Institucional



- Pas Reformës Territoriale, Bashkia ka një sipërfaqje më të madhe të territorit, gjë që përbën një sfidë për manaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve, sidomos duke konsideruar karakterin ruralv e të shpërndarë të vendbanimeve dhe relievin;
- Mungesë e kapaciteteve institucionale;
 - Bashkia për momentin ofron shërbime të ndryshme në fshatra të ndryshëm (Sofratikë, Vrisedra, Vanister, Dervician) / Godina e re e Bashkisë, e cila do të mbledhë ofrimin e të gjitha shërbimeve administrative është duke u ndërtuar në Sofratikë;
 - Mungesë e theksuar e informacionit mbi territorin e Bashkisë;
 - Ndryshim i madh ndërmjet popullsisë së deklaruar nga INSTAT (3,507 banorë) dhe asaj të deklaruar nga Regjistrat Civil i Popullsisë (22, 898 banorë);
 - Ndonëse në territorin e Bashkisë Dropullit operojnë bizneset më të mëdha në vend, me impakt ndërkombëtar, shumica e personave të punësuar në këto biznese nuk janë vendas;

Sistemi i Vendbanimeve

- Promovim i dobët i vlerave kulturore, historike dhe arkeologjike;
- Amortizim i banesave si pasaojë e largimit të popullsisë në emigracon (shumica prej të cilave janë banesa karakteristike tradicionale);
- Popullsi ‘sezonale’ (mungesë e shërbimeve dhe aktiviteteve gjithë-vjetore);
- Sistem vendbanimesh i shpërndarë në territor (41 fshatra), duke ndjekur aksin kryesor rrugor;
- Mungesë e theksuar aksesit dhe shërbimesh në Njësinë Administrative të Pogonit (relieve i vështirë si sfidë ndaj kësaj problematike);

Sistemi Infrastruktural

- Mungesë e infrastrukturës së plotë lidhëse midis Njesive Administrative Dropull i Sipërm/Poshtëm dhe Pogon;
- Mungesë e lidhjes së shpejtë me portin e Sarandës për shërbime tregtare/biznesi dhe turizmi;
- Ngritja e një pike kufitare zyrtare dhe rehabilitim i infrastrukturës lidhëse me Greqinë, përmes zonës së Glinës dhe



SKENARI 1:

Dropulli, një zonë rurale ndërkufitare.

Bashkia Dropull, një territor me identitet rural bujqësor, turistik që karakterizohet nga vendbanime dhe shërbime të decentralizuara. Një zonë tranzit e pjesës ndërkufitare midis dy qendrave rajonale Gjirokastrë dhe Janinë, e pasur me potenciale natyrore dhe peizazhe të mbrojtura.

SKENARI 2:

Dropulli, një satelit shërbimesh ekonomike.

Bashkia Dropull, një satelit i Gjirokastrës dhe vend-përqëndrim i shërbimeve dhe njëësive ekonomike përpunuese më të mëdha të Rajonit Jugor Shqipëtar. Hambar produkte dhe zonë ekonomike me rëndësi ndërkufitare, që siguron konkureshmëri, ekonomi shkallë dhe mundësi punësimi për popullsinë e zonës, si brenda dhe jashtë kufirit.

SKENARI 3:

Dropulli, portë hyrëse dhe pol zhvillimi rural.

Bashkia Dropull, pol zhvillimi rural midis dy qendrave rajonale Gjirokastrë, Janinë dhe vargmaleve jugore të Shqipërisë dhe bregdetit Jonian, me fokus në zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, turizmit dhe industrisë përpunuese. Një territor me karakter të identitetit të fortë historik e kulturor, model i bashkëjetesës midis kombësive të ndryshme, dhe urë lidhëse midis Shqipërisë dhe Greqisë. Një territor që përdor në mënyrë të qëndrueshme potencialet për një ekonomi lokale të konsoliduar dhe atmosferë favorizuese për kthimin e popullsisë dhe tërheqjen e investimeve.

- Vllaho Goranxisë;
- Mungesë e theksuar e infrastrukturës rrugore midis fshatrave në Njesinë Administrative Pogon;
 - Mungesë e sistemit të transportit publik;
 - Mungesë e ofrimit të plotë në të gjithë territorin e bashkisë, të shërbimeve të furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm;

Sistemi Hidrik

- Burime pikësore të ndotjes përgjatë rrjedhës së lumit;
- Ndotja e lumit të Drinos nga hedhjet e paorganizuara të mbetjeve urbane;
 - Ndryshim në vite i shtratit të lumit si pasojë e erozionit dhe ndryshimit të morfologjisë së terrenit nga ndërhyrjet dhe përdorimet e reja të tokës të prezantuara në zonë;
 - Shtrirje e zonave të banuara pranë shtratit të lumit (rrezik ndaj përmbytjeve);
 - Amortizimi i sistemit të vaditjes dhe kullimit;
 - Mungesë e njohjes dhe promovimit të potencialeve lokale;

Sistemi Bujqësor / Blegtoral

- Mungesë e vlerësimit të përshtatshmërisë së tokës për kultivimin e produkteve specifike;
- Fragmentizimi i tokës bujqësore;
- Braktisje e tokës së punëshme;
- Kosto e lartë e prodhimit;
- Mungesë e pikave të grumbullimit dhe tregtimit të produkteve;
- Mungesë e organizimit në tregëtimin e produkteve, që lë hapësirë për tregëtimin individual të produkteve, e rrjedhimisht rrit kostot;
- Mungesë e kushteve të përshtatshme për magazinim e produkteve;
- Mungesë e kontrollit të cilësise dhe certifikimit të produkteve;

Sistemi Natyror

- Prerje pa kriter e pyjeve;
- Aktiviteti i gjuetisë i pakontrolluar;
- Mbjellje e paorganizuar e bimëve medicinale;
- Erozion përgjatë rrjedhës së Drinosit (prerje e pyjeve, aktivitete që zhvillohen përgjatë rrjedhës së lumit);
- Mungesë e lidhjeve të rrjeteve natyrore me kontekstin përreth, parqet rajonale/ kombëtare/ ndërkuftare;
- Thatësira ekstreme gjatë stinës së verës;
- Zjarre të shumta gjatë stinës së verës (temp. të larta; mungesë kontrolli dhe pajisjesh etj.).

RREZIQET

Sistemi Institucional

- Vështirësi në ngritjen e kapaciteteve lokale;
- Paaftësi në mbulim të territorit me ofrimin e shërbimeve/ kosto të mëdha administrative;
- Thellimi i ndryshimit mes popullsisë së raportuar nga INSTAT dhe asaj të Regjistrit të Gjendes Civile, gjë që reflektohet edhe në transfertat financiare nga Qeveria Qëndrore;
- Largimi i forcës së punës dhe popullsisë drejt qyteteve më të mëdha të rajonit dhe vendit, sidomos drejt vendbanimeve të tjera fqinje përtej kufirit;
- Pabarazi në zhvillimin rajonal krahasuar me vendet fqinje;

Sistemi i Vendbanimeve

- Humbja e vlerave kulturore-historike;
- Braktisja e vendbanimeve për arsye të emigracionit (qoftë sezonal, qoftë në terma më të shkurtër kohor);
- Braktisje e vendbanimeve në zonat e thella malore, kryesisht në Njesinë Administrative të Pogonit, si pasojë e terrenit të vështirë dhe mungesës së infrastrukturës shërbyese;
- Amortizim i mëtejshëm i banesave si pasojë e largimit të popullsisë;
- Cilësi e ulët e jetesës si pasojë e mungesës së shërbimeve dhe aktiviteteve ekonomike;
- Rritje e aktiviteteve ekonomike informale dhe të paorganizuara, dhe humbja e mundësisë për të materializuar në nivel vendor përfitimin nga këto aktivitete dhe potenciale ekonomike;
- Pamundësia për të materializuar përfitimin nga prezencën e bizneseve më të mëdha, të cilat momentalisht ndodhen në territorin e Bashkisë Dropull (taksa, shërbime, punësim etj.);
- Braktisje dhe rrënim i monumenteve të kulturës (kisha, shtëpi, ura etj.);

Sistemi Infrastrukturor

- Bashkia Dropull si një pikë tranziti mes qytetit të Gjirokastrës dhe territorit përtej kufirit, pa materializuar në aktivitete dhe shërbime potencialet që zotëron;
- Ndotje e burimeve të ujit të pijshëm nga aktivitetet ekonomike të pakontrolluara, si bizneset, ashtu edhe në bujqësi;
- Amortizim i infrastrukturës rrugore lokale;
- Investim vetëm në akset kryesore strategjike, dhe jo në ato dytësore e lokale që u shërbejnë zonave të banuara. Kjo do të çonte në braktisje të mëtejshme të këtyre zonave;
- Amortizim i mëtejshëm i veprave kryesore infrastrukturore e me rëndësi historike (rrugë historike, ura të vjetra, akuadukte etj.);
- Mos-integrim i territorit në strukturat



rajonale (brenda vendit dhe përtej kufirit), duke humbur mundësinë e gjenerimit të fondeve dhe zhvillimit të mëtejshëm të territorit, përmes projekteve të përbashkëta ndërkuftare;

Sistemi Hidrik

Ndotje e pasqyrës ujore nëntokësore dhe mbitokësore nga aktivitetet ekonomike të pakontrolluara, si bizneset, ashtu edhe në bujqësi;

- Shfrytëzim pa kriter i zonave për marrjen e inerteve (që do të çonte në rritjen e ekspozimit ndaj përmytjeve);

- Rrënim i mëtejshëm i veprave kryesore të ujësjellësit, të cilat janë jo vetëm funksionale dhe shërbyese ndaj zonave të banuara, por kanë edhe vlera historike (p.sh. Ujësjellësi i Selckës etj.);

- Humbje e mundësisë për të materializuar në shërbime dhe të ardhura potencialet hidrike me vlera turistike (rrjedha e Drinosit, Suhës, shpella nënujore e Viroit, shepella nënujore e Sktorinisë etj.);

Sistemi Bujqësor / Blegtoral

- Rritje e braktisjes së tokës së kultivueshme;

- Kultivim një-sezonal i tokës, pra humbje e mundësisë për të rritur prodhueshmërinë në sasi dhe kohë-zgjatje;

- Fragmentarizim i mëtejshëm i tokës së kultivueshme;

- Ulje e aksesit të kultivuesve dhe prodhimit në treg;

- Zvogëlim i prodhimit/ prodhim individual/ impakt i vogël në ekonomi;

- Humbje e produkteve tradicionale sipas zonave (humbje e metodave tradicionale të prodhimit, por edhe e produkteve tradicionale, duke mos i kultivuar më ato);

- Vështirësi bashkëpunimi midis sipërmarrësve të ndryshëm midis tyre, si dhe midis sipërmarrësve dhe Bashkisë;

- Standarte të ulëta të prodhimit/ më pak prodhim;

- Rritje e ekonomive informale dhe pa kontroll cilësie;

- Braktisje e tokës bujqësore dhe blegtorisë si pasojë e emigracionit, ose kostove të mëdha të zhvillimit të tyre;

Sistemi Natyror

- Dëmtim i zonave natyrore e pejzazhistike si pasojë e rritjes së aktivitetit të erozionit dhe rrëshqitjeve;

- Rritje e ndotjes natyrore nga mbetjet industriale, bujqësore dhe të ngurta urbane;

- Dëmtim i zonave të mbrojtura (rritje e rasteve si ai i Bredhit të Sotirës etj.);

- Humbja e mundësisë për të integruar potencialet natyrore në strukturat ekonomike turistike të Bashkisë;

- Zhvillim i aktiviteteve njerëzore në zonat e ndjeshme natyrore;

- Zhvillim pa kriter e pa kontroll i turizmit në zonat natyrore/ zonat e mbrojtura;

- Mos-integrim i potencialeve natyrore në strukturat rajonale (brenda vendit dhe përtej kufirit), duke humbur mundësinë e gjenerimit të fondeve dhe zhvillimit të mëtejshëm të këtyre potencialeve, përmes projekteve të përbashkëta ndërkuftare;

MUNDËSITË

Sistemi Institucional

- Manaxhim i integruar i territorit, duke lejuar mundësi për zhvillim të planifikuar dhe sipas rregullave për çdo fushë;

- Zhvillim në bazë të prioriteteve nga momenti i hartimit të planit;

- Krijimi i databazës së të dhënave për bashkinë e Dropullit;

- Kualifikim i stafit të bashkësi dhe rritje e kapaciteteve vendore;

- Dixhitalizim i shërbimeve dhe shërbimet online;

- Krijimi i qendrave multifunksionale në territor që shërbejnë edhe në kuadër të procesit të decentralizimit;

- Përmirësim i sasisë dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara;

Sistemi i Vendbanimeve

- Krijimi i identitetit lokal/ shndërrimi i zonave të banuara në zona me karakter specifik sipas karakteristikave specifike;

- Shtimi i shërbimeve dhe zgjerimi i gamës së shërbimeve të ofruara në cdo Njësi Administrative e qendër banimi;

- Ofrimi i mundësisë së arsimit profesional e specilizimeve sipas karakteristikave lokale të ekonomisë;

- Mirëmbajtja e banesave, rikonstrukcioni dhe restaurimi i banesave që janë në gjendje kritike;

- Krijimi i një manuali ndërhyrjeje për cdo banesë, me qëllimin e unifikimit të stileve dhe formave të ndërhyrjeve (kjo në kuadër dhe të krijimit të identitetit lokal të sipërpërmendur);

- Restaurimi dhe mirëmbajtja e monumenteve kryesore kulturore e historike;

- Krijimi i hapësirave publike cilësore, dhe përdorimi i tyre si katalizatorë për rritjen e aktiviteteve sociale dhe gjithëpërfshirjes;

- Privatizimi ose shfrytëzimi i ish-zonave industriale në dobi të njesive të ndryshme administrative (ish-depo ushatarake, kapanone etj.);

- Përmirësimi dhe rritja e bashkëpunimit me zonat fqinje përtej kufirit (konsiderimi i zhvillimit në disa prej këtyre zonave, si shembull për nxitjen e zhvillimit edhe në



territorin e Bashkisë Dropull);

- Prezantimi i përdorimeve alternative të banesave që banohen në mënyrë sezonale (krijimi i shtëpive pritëse/ bujtina etj.);
- Integrimi i aftësive përpunuese artizanale në sistemin e zhvillimit ekonomik dhe ofrimit të shërbimeve;

Sistemi Infrastruktural

- Rritja e aksesueshmërisë së qendrave kryesore me zonat më periferike dhe të izoluar;
- Përmirësimi i infrastrukturës shërbyese rrugore sidomos në zonat e thella malore (zona e Pogonit);
- Përmirësimi i aksesit dhe lidhja e shpejtë me portin e Sarandës;
- Përmirësim i aksesit dhe lidhja me aeroportin e Gjirokastrës;
- Ndërlidhje e shpejtë me pikën më të afërt të sistemit hekurudhor që përshkon rajonin;
- Implementim i një sistemi të rregullt të transportit publik në të gjithë territorin e Bashkisë së Dropullit;
- Prezantimi i formave alternative të transportit që mund t'i shërbejnë edhe zhvillimit të turizmit (makina off-road, bicikleta, kuaj);
- Krijimi i infrastrukturave pritëse për zhvillimin e turizmit (qendra informacioni, shtëpi pritëse, mundësi alternative transporti, opsione itinaresh turistike, shërbime alternative etj.)
- Nxitja e aktiviteteve ekonomike dhe shërbyese komplementare me pjesën tjetër të rajonit (si atë më të zhvilluar-Gjirokastrën e Sarandën, po ashtu edhe bashki të tjera fqinje e të ngashme-Libohovë, Finiq, Delvinë etj.);
- Përmirësimi i shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe furnizimit me ujë të pijshëm;
- Sistemet ekologjike të trajtimit të ujërave/ infrastruktura e gjelbër;

Sistemi Hidrik

- Rivitalizim/ rikonstruktion/ rihvillim e zgjerim i sistemit të kanaleve kulluese e vaditëse;
- Minimizimi i ndotjeve të pasqyrës ujore nëntokësore dhe mbitokësore;
- Manaxhim i mbetjeve industriale/ bujqësore e urbane, për të ulur ndotjen e sipërfaqeve ujore e natyrore;
- Identifikimi i të gjitha burimeve kryesore ujore, manaxhimi, kontrolli dhe vënia në funksion e tyre sipas kritereve të mirë-përcaktuara;
- Prezantimi i masave mbrojtëse për pasuritë kryesore ujore;
- Promovimi i pasurive kryesore ujore, dhe integrimi i tyre në zhvillimin e turizmit;

Sistemi Bujqësor/ Blegtoral

- Krijimi i fermave të prodhimit bujqësor e blegtoral;
- Krijimi i pikave të grumbullimit, tregëtimit dhe lidhja me tregjet rajonale (brenda vendit dhe përtej kufirit);
- Sigurimi i kontrollit të cilisë dhe krijimi i markës lokale të produkteve (si mundësi për të futur prodhimin vendas edhe në tregun Europian);
- Zgjerimi i gamës së produkteve të kultivuara dhe prodhuara (plotësimi i sistemit me ciklin e përpunimit të produkteve);
- Promovimi i përpunimit artizanal të produkteve, si mundësi edhe për ruajtjen e metodave tradicionale të përpunimit;
- Mbështetja e sipërmarrjeve të vogla;
- Ripërdorimi i tokës djerrë (taksimi dhe subvencionet);
- Nxitja e partneriteteve publike-private;
- Manaxhimi i mbetjeve për të shmangur/ minimizuar dëmtimin e sistemit bujqësor/ blegtoral;

Sistemi Natyror

- Vlerësimi i potencialeve natyrore dhe zgjerimi i zonave të mbrojtura;
- Pasurimi i legjislacionit dhe masave mbrojtëse për mbrojtjen e sistemit natyror dhe pejzazhit;
- Krijimi i zonave me atraksion natyror/ pejzazhistik për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm;
- Krijimi i zonave me biodiversitet të lartë/ kthimi në zona më interes studimi për kërkime shkencore;
- Nxitja e zhvillimit të turizmit multidimensional dhe gjithëvjeter;
- Nxitja e zhvillimit të sporteve ujore dhe të bazuara në natyrë;
- Krijimi i mikro-zonave për zhvillimin e plazheve lumore;
- Lidhja me potencialet natyrore me rëndësi rajonale (brenda vendit dhe përtej kufirit)/ Rritja e mundësive për zhvillimin e projekteve ndërkufitare (CBC);
- Manaxhimi i mbetjeve për të shmangur minimizuar dëmtimin e sistemit natyror;

2.1 Analiza Metabolike dhe vlerësimi i përgjithshëm i territorit të njësive vendore

Metodologjia për analizën Metabolike Dropull

Analiza e metabolizmit është një analizë komplekse, e cila kërkon një sasi shumë të madhe informacioni të përditësuar për të qenë e bazuar në të dhëna sa më aktuale dhe për t'i bërë gjetjet e analizës sa më të besueshme. Mbledhja e informacionit është bërë në disa burime:

Në institucionet që kanë të dhëna mbi mjedisin (INSTAT, Bashki/Komuna, Qark,



Source/ General Local Plan of Dropull Municipality, E.Janku





Ministria e Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Industrisë dhe Energjisë, dhe institucione të tjera qëndrore sipas nevojës dhe flukseve që janë përcaktuar);

Vizita në terren- kjo metodë ka shërbyer pak për qëllimin e studimit, pasi nuk jep të dhëna sasiore;

Takimi me ekspertë të fushave të ndryshme, për të dhënat cilësore.

Kjo analizë kërkon një sasi të madhe informacioni, ndaj kërkon një metodologji të mirë për analizimin e të dhënave në territor. Analizimi i të dhënave mund të bëhet duke u bazuar në një nga mënyrat e përpunimit të informacionit mbështetur në konceptin e "Smart Cities":

- Mass – Balance

Kjo metodologji mbështetet në një sistem, i cili lidh origjinën, sasinë dhe daljen ose humbjen e sistemeve në një "peshore", e cila balancon informacionin duke krijuar një panoramë për rrugën e ndjekur nga fluksi. Kjo krijon një skemë për hyrjet dhe daljet, duke përcaktuar humbjet dhe balancën e përgjithshme të flukseve në territor.

Duke u mbështetur në metodologjinë e zgjedhur për të analizuar flukset e Bashkisë Dropull është përcaktuar edhe formati i softëare-it për të lehtësuar paraqitjen e flukseve në formë diagramatike, mbështetur në tabelat exel që janë krijuar për të kategorizuar informacionin në territor.

Zakonisht identifikimi i fushave që do të analizohen për metabolizmin urban varet nga sasia e të dhënave në dispozicion, si dhe konteksti për të cilin kryhet analiza. Kategorizimi i të dhënave krijon një tablo të plotë të flukseve, të cilat më vonë do të shërbejnë si bazë për hartëzimin. Në rastin konkret për Bashkinë Dropull, për secilin nga treguesit e marrë në analizë janë kryer matjet dhe llogaritjet për të bërë sa më të qartë inputin dhe outputin e përgjithshëm për fushën e marrë në analizë. Më tej hartëzimi i analizave është bazuar mbi të dhëna sasiore, ndaj kjo ka bërë që edhe procesi i hartëzimit të kryhet më mirë në GIS.

Flukset e analizara janë: (a) fluksi i energjisë, (b) fluksi i ujit, (c) fluksi i ushqimit dhe (d) fluksi i mbetjeve. Analizmi i flukse është bërë nëpërmjet identifikimit të hyrjeve dhe daljeve për secilin prej tyre. Hyrjet dhe daljet krijojnë një tablo të plotë të mënyrës së funksionimit të territorit, duke evidentuar potencialet dhe burimet që e bëjnë territorin të funksionojë si një i tërë.

2.1.1 Fluksi i Mbetjeve

Fluksi i mbetjeve për analizën e

metabolizmit në bashkinë dropull mbështetet në mbledhjen dhe krahasim e informacionit. Ky fluks ka marrë në konsideratë disa elementë: sasinë e mbetjeve në nivel individ sipas të dhënave të përcaktuara në nivel qarku, në nivel bashkie dhe gjetjeve të grumbulluara nga grupi i punës. Ky informacion është konvertuar në sasi mbetjesh të gjeneruara për individe/ton/vit, kjo për të kuptuar impaktin që ka ky fluks në nivel bashkie. Një element tjetër i marrë në konsideratë është largësia e qendrave të banuara, vendet e depozitimit të mbetjeve. Ketu janë konsideruar ato formale dhe jo formale si dhe shpeshtësia e ofrimit të shërbimit të pastrimit. Nga kjo panorama jemi përpjekur të kuptojmë sesi ndikojnë llojet e ndryshme të mbetjeve duke bërë një ndarje, por në munges të informacionit të detajuar dhe transporti të mbetjeve jashtë territorit të bashkisë ka kufizuar këtë analizë. Bashkia Dropull gjatë janar 2017 dhe Qeshor 2017 ka gjeneruar 5,665 ton mbetje totale për një popullsi 7,138 banorësh. këto mbetje depozitohen në nivel rajonal në Gjirokastër ku me pas behet dhe transporti i tyre për në landfill-in.

Gjenerimi i mbetjeve në bashkinë Dropull është i përqendruar në zonat urbane dhe kryesisht në aksin kryesorë lidhës ku është e vendosur dhe numri më i madh i bizneseve. Transporti i këtyre mbetjeve bëhet me mjetet komunale të administruara nga bashkia, por dhe në menyrë individuale sic veprojnë shumë nga bizneset vendase në mirëkuptim me bashkinë. Largësia mjaftë e madhe midis qendrave nga njera-tjetra dhe numrit jo të madh të rezidentëve në këto zona ka bere qe ky shërbim të ofrohet më pak se 1-2 herë në javë, kjo është akoma më e ulët në zonat malore të cilat e kanë këtë shërbim 1 herë në tre javë, ose në muaj, kjo edhe për shkak të vështirësisë në akses.

Në Bashkinë Dropull problematikat në lidhje me mbetjet lidhen me vëndet e depozitimit dhe shpeshtësisë e ofrimit të këtij shërbimi. Në munges të ktyre vëndeve kemi fenomene të ndotjes dhe krijmin e zonave të depozitimit informale dhe pa kushtet e duhura për mbrojtjen e tokës dhe mjedisit. Kjo munges ndihet dhe në zonat urbane ku mungojnë koshat. Një përpjekje e vogël riciklimi gjendet nga ana e bizneseve të cilat riciklojnë dhe shesin mbetjet e tyre të letres, plastikës dhe kartonit bizneseve te tjera në zonë.

Përsa i përket përpjekjeve për kompostimin e mbetjeve nuk ka të dhëna të sakta për përdorimin e kesaj metode, por nga bisedat dhe intervistat e kryera në bashki

nga grupi i punës kemi shumë nga familjet të cilat përmiqen ta përdorin, kjo metodë përdoret kryesisht në zonat malore ku dhe aksesimi është më i vështirë. Pavarësisht gjetjeve të grupit të punës nuk ka të dhëna zyrtare të cilat të konfirmojnë përdorimin e kësaj metode në bashkinë Dropull dhe të intervistuarit nuk kishin një skemë të qartë për aplikimin e kësaj metode.

2.1.2 Fluksi i Energjisë

Analizimi këtij fluksi është mjaft kompleks pasi duhet marrë në konsideratë sigurimi i energjisë dhe konsumi i saj në nivel familje dhe biznesi, duke përdorur formulën për llogaritjen e energjisë: Energji/kw/vite.

Fluksi ndërtohet në mënyrë të posaçme për bizneset sipas tipologjisë së tyre, duke marrë në konsideratë që në territorin e Bashkisë Dropull ka m^w shumë se 150 biznese që operojnë në prodhim, ose përpunim. Nga k^{wt} kushte dhe duke marrë në konsideratë këto tregues për të identifikuar fluksin e energjisë dhe mënyrat e gjenerimit të tij, zona e biznesit wshtw ndarw në tre fasha kryesore.

P^w tw vlerësuar konsumin e energjisë vjetore për familje wshtw konsideruar numri total i familjeve rezidente në Bashkinë Dropull, dhe më pas wshtw vlerësuar fluksin në tre sezonet e ndryshme, ku janë përfshirë dhe banuesit sezonalë gjatë muajve Mars- Prill, Qeshor-Korrik-Gusht dhe Dhjetor- Janar. Këto janë dhe sezonet gjatë të cilave konsumi i energjisë është më i lartë. Në konsideratë janë marrë dhe mundësitë alternative të sigurimit të energjisë, siç janë panelet diellore, të cilat aplikohen në nivel individual, pra në bazë familjeje.

Matja e fluksit për bizneset është bërë duke kategorizuar një fashë të përhershme të konsumit të energjisë që shtrihet përgjatë dy krahëve të Rrugës Interurbane SH4 Gjirokastrë-Kakavijë. Këto biznese janë ndarë në biznese të kapaciteteve të mëdha, të mesme dhe të vogla. Të dhënat janë siguruar nga intervista të kryera në terren nga grupi i punës, dhe nga kryerja e një pyetëso, përmes së cilit u përcaktua nr. i punonjësve, hapësira që biznesi përdor në m², makineritë që përdoren dhe kapaciteti i tyre, si dhe të dhëna në lidhje me konsumin e energjisë gjatë muajve të ndryshëm.

Fluksi mbështetet në burimet e energjisë dhe mënyrat e gjenerimit të saj. Një tregues mjaft domethënës është propozimi për ndërtimin e dy Hidrocentraleve që impaktojnë këtë Bashki: ai i Selenicës 1 dhe i Selenicës 2, me një kapacitet të propozuar deri në dy mega. Kjo ndërhyrje impakton analizën e këtij fluksi, pasi rrit

prodhimin e energjisë. Një e dhënë shtesë është dhe ekzistenca e 175 digave të vogla për përdorim bujqësorë, shumica e të cilave janë mjaft të vjetra dhe tejet të amortizuara.

2.1.3 Fluksi i Ujit

Bashkia Dropull ka një sistem hidrik mjaft të pasur. Analizimi i këtij fluksi mbështetet në matjen e sasisë së ujit që shkon për konsum familjar, humbjet e sistemit, si dhe përdorimi nga pusët e ujit. Për të llogaritur këtë fluks janë grumbulluar të dhëna nga Bashkia, por edhe janë marrë në konsideratë pyetësoret e kryer në zonë nga grupi i punës, për të mundësuar vlerësimin e konsumit të ujit me formulën: familje/m³/vite.



Për të kuptuar sasinë e ujit të konsumuar në këtë Bashki, analiza është përqendruar në disa komponentë për të kuptuar sasinë e ujit që qarkullon në territor. Fillimisht janë analizuar bizneset që operojnë në Bashkinë Dropull, duke i ndarë ato sipas profileve të tyre prodhuese dhe madhësisë: biznese të mëdha, të mesme dhe të vogla. Për të realizuar këtë ndarje janë konsideruar të dhëna si: nr. i punonjësve, hapësira që përdor çdo biznes në m², makineritë që përdorin ujë, kapaciteti i tyre si dhe të dhëna mbi konsumin e ujit gjatë muajve të ndryshëm.

Komponentë të tjerë që janë marrë në konsideratë janë dhe prurjet e lumejnve dhe furnizimi i tyre gjatë pranverës nga përrenjtë sezonalë, ku përfshihet lumi Drinos dhe degëzimet e tij. Pjesë e analizës janë bërë dhe rezervuarët, sipërfaqjet ujore të përdorura në bujqësi dhe blegtori, si dhe burimet ujore të shpërndara në territor.

Këto elemente kanë një rëndësi të madhe për të kuptuar gjenerimin e fluksit dhe rrugën që ai ndjek. Formula e përdorur për të realizuar matjet përkatëse është: sasi uji/tokë bujqësore/vite. Në Bashkinë Dropull ka më shumë se 9 zona të pasura me burime ujore nëntokesore, të cilat si pasojë e përdorimit individual nuk janë pjesë e sistemit. Përrashtim bën burimi i ujit Glina, i cili është shndërruar në një "produkt konsumi" përmes industrisë së ngritur që operon mbi këtë burim. Për të matur rëndësinë të burimeve me përdorim individual, brenda sistemit, janë marrë në konsideratë elemente si: kapaciteti i tyre sipas stinëve të ndryshme në bazë të prurjeve, dhe shfrytëzimi i tyre.

2.1.4 Fluksi i Ushqimit

Analiza e këtij fluksi mbështetet në llogaritjen e sasisë dhe llojeve të prodhimit ushqimor në territorin e Bashkisë Dropull. Për kryerjen e analizës meren





në konsideratë dy fakte: që sipërfaqja bujqësore zë rreth 18.03% të sipërfaqjes totale të territorit, si dhe klasat kryesore të bonitetit të tokës bujqësore. Klasat e bonitetit variojnë nga III-VIII, duke filluar me III në Veri- Lindje, për tu ndërthurur më pas në klasat IV-V në pjesën qendrore të Bashkisë, e për të përfunduar me klasat VII-VIII në Jug- Lindje, ku prodhimtaria është më e vogël dhe terreni më i thepisur. Duke konsideruar bujqësinë si një aktivitetet kryesore ekonomike të zonës janë marrë në shqyrtim tregues, të cilët ndihmojnë të kuptohet konsumi i produkteve të zonës nga familjet. Të dhënat për të llogaritur këtë fluks janë siguruar nga Bashkia dhe mbi këto të dhëna janë ndërtuar një sërë analizash, që më pas në bazë të llojit të produktit dhe sasisë së prodhuar është mundur të përcaktohet sasia e konsumit në terma lloj/ton/vite.

Zona prodhon disa produkte, por një pjesë të produkteve që konsumon për shkak të klimës dhe vështirësive që ajo paraqet, nuk mund të prodhohen në Bashkinë Dropull, ndaj duhet t'i marrë nga Bashki të tjera. Sipas intervistave të bëra, shumë nga këto produkte shkëmbehen midis tregëtarëve të Bashkive fqinje. Importi i produkteve për zonën është mjaft i ulët dhe kjo shifër nuk ka ndikuar në ndryshimin e të dhënave të këtij fluksi. Eksporti nga ana tjetër, ka luajtur një rol mjaft të madh, pasi në fashën ekonomike ndodhen biznese të industrisë ushqimore të lehtë, bimëve medicinale dhe erqzave. Këto produkte shkojnë kryesisht për eksport në vendet Europiane, por një sasi e vogël e tyre konsumohet nga vetë banorët e Dropullit. Prodhimi është kryesisht i orientuar drejt prodhimeve sipas stinëve, dhe nuk ka një konsideratë të llogaritur përsa i përket përshtatshmërisë së prodhimit, sipas tipit të tokës.

Një element i rëndësishëm i këtij fluksi janë dhe serat e prodhimit, stallat dhe pularitë që operojnë si biznese prodhuese të vogla, të cilat kryesisht operojnë në nivel familjar dhe funksionojnë me referime për të aksesuar tregun. Mungesa e një tregu lokal dhe rajonal ka limituar zhvillimin e iniciativave të vogla prodhuese, duke i lënë ato të pa konsiderueshme në matjen e këtij fluksi.

■ Konkluzione

Kjo metodologji Analize është përdorur si një instrument për të përmirësuar cilësinë e jetesës, si dhe për të kuptuar se si menaxhohet fluksi dhe zinxhiri që ai ndjek brenda territorit të Bashkisë Dropull.

Gjatë kryerjes së analizave janë marrë në konsideratë më shumë se 50 lloje

të ndryshme të dhënash sasiore, të përthyerë më pas në ilustrime grafike dhe hartografike.

Disa nga problematikat e hasura gjatë këtij procesi lidhen me mungesën e informacionit. Për të kryer analiza të sakta dhe përfaqësuese duhet të sigurohen dhe përdoren të dhëna sasiore, të cilat duhet të jenë të plota dhe të përditësuara për të pasqyruar sa më mirë dinamikën e territorit. Për të këtë arsye, për realizimin e analizave metabolike mbi territorin e Bashkisë Dropull, grupi i punës ka shfrytëzuar disa burime, duke përfshirë jo vetëm të dhënat zyrtare (INSTAT, Ministrinë përkatëse, autoritetet vendore etj.), por edhe të dhëna të grumbulluara nga intervistat individuale, pyetësorët dhe evidentimet e realizuara në terren në kuadër të hartimit të PPV.

Përfaqësimi i këtyre flukseve është lidhur ngushtë me tipologjinë e territorit, specifikat, problematikat dhe resurset e tij.

2.1.2 Konkluzionet për Fluksin e Mbetjeve:

- Fluksi i mbetjeve tregon se menaxhimi i shërbimit të mbetjeve duhet përmiresuar dhe duhen gjetur mënyra alternative për të ofruar këtë shërbim;
- Kompostimi ndodh në nivel të vogël, pa marrë dimension më të gjerë, dhe jo duke u përfshirë në një cikël të plotë prodhimi e përdorimi;
- Përqëndrimi i bizneseve në një pjesë të territorit ka ndihmuar në grumbullimin dhe manaxhimin e mbetjeve.

2.1.3 Konkluzionet për Fluksin e Energjisë:

- Fluksi i energjisë reflekton impaktin e mungesës së energjisë në periudha të caktuara të ditës, si dhe problematika me linja të ndryshme në zona me mbulim të dobët;
- Fluksi ka një impakt konsumi të lartë në zonën ekonomike, ku janë përqëndruar dhe pjesa më e madhe e aktiviteteve prodhuese dhe përpunuese;
- Ndërtimi i hidrocentraleve në aspektin energjistik ndikon në sasinë e energjisë së prodhuar në vend, por kjo nuk impakton prodhimin e energjisë në Bashki.

2.1.4 Konkluzionet për Fluksin e Ushqimit:

- Fluksi i ushqimit reflekton ndjeshëm mungesën e aksesit në treg të bizneseve të vogla dhe kjo impakton zhvillimin e tyre, por dhe njohjen nga Bashkitë e tjera;
- Sasia e ulët e tokës bujqësore të kultivuar reflekton aksesin e ulët në treg, i cili impakton në mënyrë të drejtëpërdrejtë

dhe gjenerimin e prodhimit në vetvete;

- Bizneset e mëdha dhe importimi i produkteve nga vendet fqinje konkuron dhe nuk ndihmon në njohjen e produkteve vendase.

Konkluzionet për Fluksin e Ujit:

- Burimet e ujit në zonë nuk kanë asnjë adresim, përdorim ose mirëmbajtje. Kapaciteti dhe potenciali i tyre nuk vlerësohen;
- Diferenca midis konsumit të ujit dhe prodhimit të tij tregon se sistemi ka humbje;
- Prurjet e mëdha të lumejnve shkaktojnë dëme dhe humbje toke. Nevojitet aktivizimi i kanaleve të drenazhimit;
- Rrjeti i furnizimit me ujë ka një mbulim jo të plotë dhe është në gjendje të amortizuar.

KAPITULLI 3- VIZIONI, OBJEKTIVAT STRATEGJIKË DHE SISTEMET

3.1 Vizioni Hapësinor i Zhvillimit të Territorit për Bashkinë Dropull

Bashkia Dropull, korridor zhvillimi linear i vendbanimeve, dhe pol zhvillimi rural midis qendrave rajonale Gjirokastrë dhe Janinë, dhe vargmaleve jugore të Shqipërisë e bregdetit Jon.

Një territor me karakter dhe identitet të fortë historik e kulturor, model i bashkëjetesës midis kombësive të ndryshme, portë e rëndësishme e zonës ndërkufitare dhe urë lidhëse midis Shqipërisë dhe Greqisë.

Qendër me fokus në zhvillimin e turizmit, bujqësisë, blegtorisë, dhe industrisë përpunuese që vë në përdorim produktet vendase, për të krijuar një cikël të plotë prodhimi dhe tregëtimi. Zonë që mirëpret dhe siguron hapësirë për kërkimin dhe ngritjen e start-upeve të bazuara tek turizmi dhe bioproduktet, duke u shndërruar kështu në një “pol” ndërkufitar që përdor në mënyrë të qëndrueshme potencialet për një ekonomi lokale të konsoliduar dhe atmosferë favorizuese për kthimin e popullsisë dhe tërheqjen e investimeve.

3.2 Objektivat Strategjike

Me qëllim specifikimin dhe përkthimin e vizionit të mësipërm në një udhëzues të vlefshëm dhe lehtësisht të aplikueshëm, janë hartuar 4 objektiva kryesorë strategjikë, të cilët synojnë të jenë të prekshëm dhe lehtësisht të zbatueshëm nga Bashkia gjatë 15 vjeçarit të ardhshëm.

OS_1: Rritja e aksesueshmërisë dhe integrimi territorial

Siç është shprehur edhe gjatë fazës së Analizës së Territorit për Bashkinë Dropull,

rritja e aksesueshmërisë dhe integrimi territorial si në nivel makro dhe atë mikro, përbën një nga sfidat kryesore të Bashkisë momentalisht. Kjo vjen jo vetëm si pasojë e konfigurimit të territorit pas Reformës së re Territoriale, por edhe si pasojë e terrenit të vështirë malor, i cili përbën një nga sfidat kryesore për Bashkinë dhe popullsinë vendase.

Në nivel makro infrastruktura kryesore rrugore lidh Dropullin me qytetin e Gjirokastrës, qendrën e Rajonit Jugor të Shqipërisë (rajon në të cilin Bashkia Dropull bën pjesë), me qytetin e Janinës përtej kufirit, që është dhe qendër e Rajonit me të njëjtin emër. Rruga Interurbane Kryesore SH4 lidh këto dy qendra rajonale midis tyre, duke shërbyer territorin e Bashkisë Dropull që gjendet në mesin e këtij aksi në zonën ndërkufitare, dhe duke rritur mundësitë e integritit të këtij të fundit në aktivitetet ekonomike dhe sociale. Ndonëse në termat e infrastrukturës fizike lidhëse Bashkia Dropull është përgjithësisht e mirë-integruar në këtë makro-Rajon ndërkufitar, ka mangësi përse i përket integritit më të mirë me qëllim zhvillimin ekonomik. Si pasojë e mungesës së një rrjeti të plotë të infrastrukturave alternative të aksesit dhe shërbimeve, të cilat mbështesin dhe shtojnë më tej zhvillimin ekonomik dhe integrimin e Bashkisë Dropull në makro-Rajonin ndërkufitar, shumë nga aktivitetet që zhvillohen janë ende lokale dhe të izoluara, pa pasur një impakt të gjerë konkret në makro-Rajonin në fjalë. Në këto kushte përmirësimi i infrastrukturës rrugore lidhëse dhe shërbimeve, si dhe trajnimi i administratës për të qenë e aftë të jetë partnere, sëbashku me autoritetet fqinje, në Projekte të ndryshme të Bashkëpunimit Ndërkufitar.

Në nivelin mikro lidhja e dy Njësie Administrative Dropull i Sipërm dhe Dropull i Poshtëm me Njësinë e Pogonit është një nga prioritetet kryesore, në mënyrë që Bashkia Dropull të arrijë integrimin e plotë të të gjithë territorit që ka nën administrim. Momentalisht Njësia e Pogonit mund të aksesohet vetëm nga një arterie lidhëse (dalja nga Rruga Interurbane Kryesore SH4 nga Sofratika, përmes grykës së Selckës dhe Suhës), e cila është pjesërisht e shtruar dhe paraqet mjaft vështirësi aksesit drejt fshatrave Sopik e Skore dhe sidomos drejt fshatrave Hllomo, Çatistër dhe Mavrojer. Arteria tjetër lidhëse me Njësinë e Pogonit është përtej kufirit. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore lidhëse mes Njësie Administrative Dropull i Sipërm dhe Dropull i Poshtëm, dhe Njësisë së

Pogonit, do të ndikojë në një qeverisje dhe integrim më të mirë të të gjithë territorit të Bashkisë Dropull, do të rrisë aksesin ndaj çdo zone të banuar, dhe do të shtyjë më tej përmirësimin e ofritit të shërbimeve dhe aktiviteteve të ndryshme ekonomike dhe sociale të popullsisë.


Integrimi mikro-territorial konsiston gjithashtu edhe në ngritjen e një sistemi infrastrukturor lokal alternativ që do të lidhë të gjithë fshatrat midis tyre, për t'u aksesuar jo vetëm nga automjetet, por mbi të gjitha nga biçikletat dhe këmbësorët. Kjo do të kontribuojë gjithashtu në ndërhyrjet pasuese për krijimin e itinerareve turistike në kuadër të zhvillimit të turizmit bazuar tek natyra, pejzazhi dhe bioproduktet, ku vetë fshatrat dhe banorët do të luajnë një rol mjaft të rëndësishëm.


Për të siguruar një shpërndarje më të mirë në ofrimin e shërbimeve dhe integrimin e plotë të territorit Bashkia Dropull do të ketë një sistem centralitetesh të reja (polet Dervician, Sofratikë, Jorgucat, Vrisera dhe Poliçan), të cilat do të jenë plotësisht të dedikuara funksioneve specifike në kuadër të implementimit të vizionit hapësinor të zhvillimit, për zhvillimin ekonomik, rritjen e aksesueshmërisë dhe sjelljen e shërbimeve më pranë popullsisë dhe nevojave lokale.

Për realizimin e këtij objekti strategjik janë përcaktuar një seri programesh strategjike si më poshtë:

- Programi Strategjik OS1PS1: Lidhja e Shpejtë me Portin e Sarandës dhe Itinerari Turistik drejt Rivierës;
- Programi Strategjik OS1PS2: Përmirësimi i infrastrukturës rrugore ekzistuese dhe implementimi i sistemit "sloë line" infrastrukturor alternativ që lidh më mirë fshatrat midis tyre, si dhe siguron akses ndaj vendeve me atraksion turistik;
- Programi Strategjik OS1PS3: Konsolidimi i pikave kufitare në Koshovicë, Radat dhe Sopik (përmirësimi i portave hyrëse të Bashkisë Dropull dhe lidhjeve strategjike rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare);
- Programi Strategjik OS1PS4: Krijimi i Terminalit Multimodal Interurban pranë polit Jorgucat;
- Programi Strategjik OS1PS5: Krijimi i Stacionit të Trenit;
- Programi Strategjik OS1PS6: Centralitetet e Bashkisë Dropull / Polet: Dervician, Sofratikë, Jorgucat, Vrisera dhe Poliçan.

OS_2: Integrimi në rajonin ekonomik ndërkufitar përmes zhvillimit dhe diversifikimit të ekonomisë lokale





Duke marrë në konsideratë pozicionin strategjik të Bashkisë Dropull në makro-Rajonin ndërkufitar, midis qendrave Gjirokastrë, Janinë e Sarandë, si dhe gamën e gjerë të potencialeve që territori i Bashkisë ka, diversifikimi dhe zhvillimi i mëtejshëm e ekonomisë lokale do të kontribuojë në integrimin më të mirë, pjesëmarrjen aktive, si dhe rritjen e konkureshmërisë së Bashkisë Dropull në këtë makro- Rajon ekonomik.

Me implementimin e ndërhyrjeve lidhëse dhe integruese infrastrukturore të prezantuara në Objektivin Strategjik 1, territori do të jetë i gatshëm të mirëpresë një seri ndërhyrjesh me qëllim zhvillimin ekonomik të Bashkisë Dropull.

Duke vlerësuar potencialet kryesore ekonomike të zonës, si një territor me karakter të theksuar rural, bujqësia dhe blegtoria janë dy degët kryesore me kontributin më të madh në punësim dhe gjenerim të ardhurash. Por si pasojë e mjaft faktorëve të analizuar edhe në Dokumentin e Analizës së Territorit (migracioni dhe emigracioni, madhësia e vogël e fermave/ sipërfaqeve të kultivuara që si rrjedhojë sjell inefiçencë në prodhim, konkurenca në treg e produkteve të importuara etj.), këto dy degë momentalisht nuk shfrytëzohen në potencialin e plotë të tyre. Në këto kushte një sërë ndërhyrjesh si: konsolidimi i tokës bujqësore, rritja e madhësisë së fermave bujqësore e blegtorale, rehabilitimi i tokave të lëna djerrë, zgjerimi i gamës së kulturave të kultivuara, krijimi i ciklit të plotë të prodhimit (prodhim-grumbullim- përpunim-tregëtim), brandimi dhe promovimi i produkteve lokale, kontrolli i cilësisë, ngritja e tregjeve lokale për tregëtimin e produkteve, aksesimi në tregjet lokale brenda vendit dhe përtej kufirit në makro- Rajonin ndërkufitar, lidhja e fermerëve me bizneset e mesme dhe të mëdha, etj., do të synojnë të rivitalizojnë ekonominë lokale të Bashkisë Dropull, rrisin konkureshmërinë e saj në Rajon, si dhe ta bëjnë atë pjesë aktive të një zinxhiri ekonomik të plotë që funksionon në makro-Rajonin ndërkufitar, duke rritur mundësitë e përfitimit për të gjithë aktorët e përfshirë.

Përpos zhvillimit të degëve të bujqësisë dhe blegtorisë, përkrahja e zhvillimit të biznesit dhe industrive përpunuese, që momentalisht përbëjnë një tjetër sektor me rëndësi të ekonomisë së Bashkisë Dropull, është një tjetër prioritet. Ndonëse momentalisht zhvillimi i njësive të ndryshme të biznesit shfrytëzon territorin e Bashkisë Dropull për vendosjen fizike të

tyre, pa një impakt të konsiderueshëm në lidhje me punësimin e popullsisë vendase, ose investimeve për përmirësimin e kushteve të territorit, vendosja e një marrëveshjeje bashkëpunimi me interes dy-palësh, mes Bashkisë Dropull dhe njësive të biznesit do të ndikonte në një impakt më të madh pozitiv të operimit të tyre në territorin e Bashkisë. Në këtë bashkëpunim, Bashkia mund të ofrojë vendin fizik të vendosjes së tyre, ndërkohë që njësitë e biznesit sigurojnë punësim të sigurtë për popullsinë vendase, si dhe parashikojnë një plan investimesh në infrastrukturën lokale dhe mjedisin në të cilin ato operojnë. Në këtë mënyrë, jo vetëm do të krijohet një cikël i plotë ekonomik, por dhe përfitimet reale nga ky cikël nuk mbeten vetëm ndërmjet njësive operuese, por bëhen të prekshme dhe të dobishme edhe për Bashkinë Dropull dhe territorin që ajo zotëron.

Turizmi përbën degën e tretë të zhvillimit ekonomik të Bashkisë Dropull. Zhvillimi i këtij të fundit nuk duhet parë si një fenomen rastësor, aksidental, ose sektorial, por duhet trajtuar në mënyrë të integruar dhe bashkërenduar me sektorët e tjerë të ekonomisë, në mënyrë që të krijohet një zinxhir i plotë ekonomik që siguron të ardhura shtesë për popullsinë vendase dhe Bashkinë. Duke kombinuar zhvillimin rural që e karakterizon territorin, me peizazhe të rralla dhe habitate natyrore të pasura, me zhvillimin e degëve si bujqësia, blegtoria, kultivimi i bimëve medicinale, por edhe me industrinë përpunuese dhe ofrimin e shërbimeve, turizmi do të marrë një zhvillim të plotë 360 gradë dhe gjithëvjetor (pra që shkon përtej një sezoni të vetëm), duke u shndërruar në një promotor të rëndësishëm të vlerave të territorit të Bashkisë Dropull. Integrimi i popullsisë vendase në këtë zinxhir do të luajë një rol shumë të madh përsa i përket rritjes së punësimit, integritetit të popullsisë në ekonominë lokale, rritjen e të ardhurave, si dhe mund të kthehet në një argument për të tërhequr popullsi të re rezidente në zonë, ose kthimin e popullsisë së larguar. Shndërrimi i banesave të braktisura, ose të rrënuara në bujtina pritëse do të mund të rrisë gjithashtu kapacitetin pritës turistik.

Lidhja me Sarandën, Rivierën dhe vargmalet jug-perëndimore të bregdetit Jon përbën gjithashtu një prioritet në integrimin makro-territorial të Bashkisë Dropull. Kjo lidhje jo vetëm do të lehtësojë aksesin mes zonave të banuara që ndodhen në këtë pjesë të territorit, por kontribuon gjithashtu në rritjen e shtrirjes së zonës

që do të impaktohet nga ndërhyrjet për zhvillimin e turizmit bazuar tek natyra, pejzazhi dhe bioproduktet, për të krijuar një zonë më të madhe impakti e lëvizshmërie, duke kontribuar kështu në atë që ndryshe konsiderohet si "turizmi fluid". Në këto kushte dhe për të rritur konkurrencën ekonomike, krijimi i një lidhjeje të shpejtë me portin e Sarandës do të bëjë më eficient jo vetëm turizmin në kuptimin e lëvizjes së pasagjerëve, por edhe zhvillimin ekonomik bazuar tek shkëmbimi i mallrave, duke ulur kostot aktuale (taksa etj.) që mbarten nga përdorimi i porteve alternative si ai i Igumenicës.

Në kuadër të zhvillimit dhe integritetit ekonomik në rajon dhe më gjerë, krijimi i kushteve për të nxitur rritjen e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme do të jetë prioritarë. Në këtë kuadër parashikohet gjithashtu që pranë zonës ndërkufitare, midis poleve Vrisera dhe Jorgucat, të krijohet një "Park Zhvillimi", ku të sigurohet hapësirë dhe kushte të përshatshme për vendosjen dhe operimin e qendrave të: trajnimit dhe arsimit profesional për degët kryesore ekonomike të zonës; kërkimit (mbi produktet vendase, ciklin dhe procesin e prodhimit etj.); testimit dhe kontrollit të cilësisë; si dhe start-upeve. Të gjitha këto ndërhyrje me qëllim zhvillimin e dijes dhe teknologjisë synojnë të shndërrojnë Luginën e Drinosit në një "luginë zhvillimi dhe progresi", duke i dhënë rëndësi Bashkisë së Dropull si një pikë strategjike dhe komplementare në zhvillimin ekonomik të makro-Rajonit ndërkufitar, me mjaft mundësi bashkëpunimi me qendrat rajonale Gjirokastër e Janinë, dhe territorin përreth tyre.

Si pjesë e këtij makro-Rajoni ndërkufitar, projektet me fokus Bashkëpunimin Ndërkufitar janë me mjaft rëndësi. Programi "Greqi- Shqipëri 2014-2020" që synon të përmirësojë cilësinë e jetesës në rajonet kufitare Greqi- Shqipëri duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm lokal, është një mundësi shumë e mirë që Bashkia Dropull dhe njësitë e tjera fqinje përtej kufirit mund të përdorin për të hartuar programe të përbashkëta zhvillimi. Programi mbulon 11 njësi rajonale kufitare në Greqi dhe 4 në territorin Shqipëtar, dhe ka një vlerë rreth 42 million Euro, me një kontribut rreth 36 milion Euro nga Bashkimi Europian, përmes instrumentit të Asistencës së Para-Aderemit, IPA. Për të realizuar këtë objektivë duhet bërë trajnimi dhe përgatitja e stafit të Bashkisë, në mënyrë që të jenë të aftë të evidentojnë,

hartojnë, prezantojnë dhe implementojnë projektet të këtij karakteri.

Në përfundim, në këto kushte ngritja e kapaciteteve lokale dhe promovimi i imazhit dhe potencialeve vendase përbëjnë dy iniciativa mjaft të rëndësishme, të cilat do të arrijnë të sigurojnë një bazë të shëndetshme operacionale për implementimin dhe realizimin e çdo sipërmarrjeje në territorin e Bashkisë Dropull.

Për realizimin e këtij objektivit strategjik janë përcaktuar një seri programesh strategjike si më poshtë:

- Programi Strategjik OS2PS1: Zhvillimi i Bujqësisë;
- Programi Strategjik OS2PS2: Zhvillimi i Blegtorisë;
- Programi Strategjik OS2PS3: Kultivimi dhe Përpunimi i Bimëve Medicinale dhe Eterovajore
- Programi Strategjik OS2PS4: Zhvillimi i Turizmit;
- Programi Strategjik OS2PS5: Zhvillimi i Biznesit dhe Industrisë Përpunuese;
- Programi Strategjik OS2PS6: Krijimi i "Parkut të Zhvillimit";
- Programi Strategjik OS2PS7: Ngritja e kapaciteteve institucionale dhe financiare në dobi të hartimit të Projekteve të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA;
- Programi Strategjik OS2PS8: Ngritja e kapaciteteve lokale;
- Programi Strategjik OS2PS9: Brandimi dhe promovimi i Bashkisë Dropull.

OS_3: Ruajtja e karakterit rural të vendbanimeve dhe përmirësimi i cilësisë dhe kushteve të jetesës

Territori i Bashkisë Dropull përbëhet nga 41 fshatra dhe ka një karakter të theksuar rural, i cili mer vlera të mëdha falë zhvillimit të bujqësisë e blegtorisë, pejzazhit të pasur dhe habitateve natyrore të shumta që e rrethojnë. Në këto kushte qëllimi i këtij objektivit është të promovojë dhe shtyjë më tej zhvillimin e territorit dhe ta bëjë atë të jetueshëm, pa kompromentuar karakterin dhe vlerat e tij të pazëvendësueshme. Përmes politikave specifike të zhvillimit do të nxitet rehabilitimi i mjaft zonave të banuara, të cilat momentalisht janë të braktisura, ose në kushte kritike. Në çdo fshat do të rigjenerohet qendra e tij dhe sistemi kryesor infrastrukturor shërbyes, me qëllim rigjallërimin e jetës së banorëve, rritjen e sigurisë dhe cilësisë së hapësirave publike, si dhe për t'i bërë të gjithë fshatrat të vizitueshëm në kuadër të zhvillimit të turizmit. Për këtë qëllim do të ngrihet gjithashtu një sistem rrugësh këmbësore



Source/ General Local Plan of Dropull Municipality



Source/ General Local Plan of Dropull Municipality

dhe biçikletash, i cili ndër të tjera do të lidhë të gjithë fshatrat dhe vendet e atraksionit turistik midis tyre.

Do të konservohen zonat me karakteristika të veçanta arkitektonike, historike dhe kulturore, ku ndër të tjera përveç kishave, manastireve dhe objekteve të tjera të shpallura si Monumente Kulture, edhe banesat vendase historike do t'i nënshtrohen restaurimit dhe një pjesë e tyre do të vihen në përdorim me funksione alternative (bujtina, shtëpi muze, kantina etj.).

Për të mirëpritur rritjen e popullsisë, qoftë atë të shtimit natyral, por edhe shtimin si pasojë e kthimit të popullsisë së larguar, ose ardhjen e popullsisë së re, si pasojë e kushteve tërheqëse që do të sigurojë zhvillimi ekonomik në 15 vjeçarin e ardhshëm, politika të ndryshme do të ndiqen edhe përsa i përket akomodimit të këtij shtimi në shtëpi banimi dhe zona të ndërtueshme. Për të shmangur konvertimin e tokës bujqësore dhe zonave natyrore në tokë të ndërtueshme, do të synohet së pari rehabilitimi i banesave të braktisura ose të rrënuara, suke synuar futjen e tyre në tregun e strehimit; së dyti do të promovohet densifikimi i zonave ekzistuese të banimit aty ku është e mundur; së treti do të parashikohet rritja e zonave ekzistuese të banimit. Gjithashtu do të përdoren edhe instrumenta financiare dhe mbështetje financiare për të garantuar ofrimin e banesave me kosto të përballueshme në rastet e familjeve dhe personave në nevojë.

Do të dakortësohet për një set rregullash ndërtimi (të cilat do të detajohen në dokumentin e Rregullores) në stil dhe materiale, në mënyrë që të ruhet karakteri lokal i banesave tradicionale me gurë. Kjo është një praktikë që vë në përdorim materialet lokale, krijon identitet dhe i përshtatet kushteve të territorit, traditës dhe kulturës vendase. Ndër të tjera, vetë banorët e kanë aplikuar këtë praktikë tashmë prej disa vitesh në mirëkuptim midis tyre.

Brenda 15 vjeçarit të parashikuar nga PPV do të plotësohen të gjitha nevojat për shërbime publike: shëndetësore, arsimore, transport etj. Do të plotësohen gjithashtu rrjetet e shërbimit me ujë të pijshëm, energji dhe sistemit të kanalizimeve, të cilat momentalisht janë pjesërisht jashtë funksionit si pasojë e amortizimit, ose janë ngritur në mënyrë individuale nga secila familje (gropa septike, puse etj.) në zonat e reja të banimit.

Përpos përmirësimit të aksesit, plotësimi me elemente të dizajnit urban, si ndriçimi, gjelbërimi, hapësirat cilësore publike dhe ambientet kulturore, etj., do të ndikojnë gjithashtu në rritjen e sigurisë në vend, duke kontribuar në përdorimin më të shumtë dhe në çdo kohë të hapësirave të përbashkëta.

Për realizimin e këtij objekti strategjik janë përcaktuar një seri programesh strategjike si më poshtë:

- Programi Strategjik OS3PS1: Rikualifikimi i banesave të braktisura/ rrënuara dhe futja e tyre në tregun e strehimit;
- Programi Strategjik OS3PS2: Restaurimi i banesave/ objekteve historike dhe bërja e tyre pjesë në programet turistike;
- Programi Strategjik OS3PS3: Rikualifikimi i hapësirave publike (qendrat e fshatrave) dhe aplikimi i praktikave të dizajnit urban për të rritur cilësinë e hapësirave dhe sigurinë;
- Programi Strategjik OS3PS4: Ngritja e Qendrave Sociale (sigurimi i shërbimeve dhe përkrahjes ndaj popullsisë në nevojë, sidomos moshës së tretë);
- Programi Strategjik OS3PS5: Unifikimi në stil dhe materiale ndërtimi (përdorimi i materialit vendas, gurit);
- Programi Strategjik OS3PS6: Plotësimi me shërbime publike: arsim dhe shëndetësi;
- Programi Strategjik OS3PS7: Plotësimi me shërbime publike: transporti publik;
- Programi Strategjik OS3PS8: Rehabilitimi dhe shtrirja e plotë e rrjetit të kanalizime dhe ujësjellësit.

OS_4: Mbrojtja e pejzazhit, habitateve natyrore dhe mobilizimi ndaj emergjencave

Me karakterin e saj të theksuar rural, Bashkia Dropull ka rreth 78% të sipërfaqes së saj totale prej 45,409.93 ha, të konsideruar si sipërfaqe Natyrore, rreth 18.3% sipërfaqe Bujqësore, dhe rreth 2.02% sipërfaqe Ujore. Në këto kushte është e kuptueshme se edhe problematikën, të cilat shqetësojnë territorin e Bashkisë kanë një karakter të theksuar natyror, dhe se zgjidhja e këtyre problematikave përbën një objektiv parësorë për Bashkinë e Dropullit.

Një nga problematikën më madhore, që vë në rrezik dhe kompromenton një sërë asetesh të tjera, është rënia e zjarreve, që veçanërisht këtë vit shkaktoi mjaft dëme në sipërfaqe të tëra pyjesh, duke rrezikuar edhe zonat e banuara në afërsi të tyre. Duke qenë se ndër shkaktarët kryesorë mbeten përgjithësisht temperaturat e larta gjatë stinës së verës, të cilat përbëjnë

faktorë natyrorë jashtë kontrollit të drejtëpërdrejtë njerëzor, marja e masave në mobilizim trupash dhe mjetesh për fikjen e zjarreve është një domosdoshmëri për Dropullin. Në terma afatgjatë, marrja e masave për parandalimin e thellimit të mëtejshëm dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike duhet të kthehet në një prioritet për autoritetet kombëtare dhe vendore në planifikimin dhe qeverisjen e territorit.

Thatësira e skajshme gjatë stinës së verës përbën një tjetër problematikë. Ndonëse zona e Dropullit ndodhet në një nga territoret më të pasura me burime ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore, mungesa e manaxhimit të kësaj pasurie, përkundrajt procesve natyrore dhe përdorimit pa kriter, krijon situata emergjente, sidomos gjatë periudhës më të nxehtë. Rehabilitimi i rezervuarëve ujorë ekzistues dhe planifikimi i krijimit të rezervuarëve të rinj, aty ku është e nevojshme, do të ndihmonte në mirë- manaxhimin dhe parandalimin e situatave ekstreme. Në këtë cikël do të mund të integrohet gjithashtu grumbullimi i ujërave të shiut, për t'u përdorur më pas në periudha krize për ujitje në sistemin bujqësor, ose pas trajtimeve përkatëse edhe si ujë për gjënë e gjallë në sistemin blegtoral.

Në kuadër të këtij objektivi parashikohet edhe marja e masave për mbrojtjen nga erozioni dhe rrëshqitjet, duke shtuar pyllëzimin, duke krijuar argjinatura, si dhe duke ndërmarrë masa të posaçmë inxhinierike. Prezantimi i politikave dhe masave të rrepta për mbrojtjen e pyjeve, duke rritur kontrollin dhe vigjilencën gjithashtu, parashikohen si masa për të ndaluar prerjen në masë të pyjeve, sidomos në Njësinë e Pogonit. Manaxhimi i pyjeve, por dhe kullotave përbën një tjetër masë të rëndësishme për mbrojtjen e habitateve natyrore dhe atyre prodhuese.


Bashkia Dropull synon gjithashtu të krijojë një sistem të rregullt grumbullimi dhe manaxhimi të mbetjeve. Duke qenë se aktualisht në territorin e Bashkisë Dropull zhvillon aktivitetin një biznes që meret në mënyrë të veçantë me riciklimin e letrave dhe kartonave, për të prodhuar më pas nën-produkte (qese letre dhe kuti paketimi) që i shërbejnë bizneseve të tjera prodhuese në Bashkinë Dropull, dhe jo vetëm, synohet promovimi i riciklimit në masë të letrës, duke ndikuar në manaxhimin e mbetjeve dhe gjithashtu në edukimin dhe ndërgjegjësimin e banorëve. Duke qenë se në Bashkinë Dropull operojnë një sërë biznesesh, zhvillimi i të cilave synohet të nxitet edhe më tej,

kontrolli dhe manaxhimi i ndotjes që ato shkaktojnë në ambientet përreth, sidomos ato natyrore, është mjaft me rëndësi, ndaj marja e këtyre masave është me prioritet. Për realizimin e këtij objektivi strategjik janë përcaktuar një seri programesh strategjike si më poshtë:


- Programi Strategjik OS4PS1: Mobilizimi për mbrojtjen ndaj zjarreve;
- Programi Strategjik OS4PS2: Masa për manaxhimin e thatësirave ekstreme (rehabilitimi i rezervuarëve, projektimi i rezervuarëve të rinj, grumbullimi dhe trajtimi për përdorim i ujërave të shirave etj.);
- Programi Strategjik OS4PS3: Manaxhimi i rreziqeve natyrore (erozioni, rrëshqitjet e tokës etj.);
- Programi Strategjik OS4PS4: Manaxhimi i pyjeve dhe kullotave;
- Programi Strategjik OS4PS5: Manaxhimi i mbetjeve dhe promovimi i riciklimit dhe kompostimit;

3.3 Sistemet Territoriale

Me hartimin e Strategjisë së Territorit, Plani dhe Projekteve Strategjike pritet një ndryshim i mundshëm në sistemet e territorit, të cilat ndikohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga ndërhyrjet e propozuara. Ndërkohë që në nivel planesh territoriale sigurohet krijimi i përdorimeve të përputhshme të tokës, në nivel strategjik duhet të kuptohet dhe pranohet që të gjitha sistemet territoriale (bujqësore, natyrore, ujorë, urbane dhe infrastrukturore) mund të ndryshojnë, dhe kjo ndodh për dy arsye: si pasojë e efekteve afatgjata të strategjisë dhe planit, porë në çdo aspekt (territorial, mjedisor, social dhe ekonomik); dhe si pasojë e efekteve të sektorëve të ndryshëm mbi njëri-tjetrin dhe si rezultat duhen parashikuar, rregulluar dhe marrë masa ligjore e procedurale për zbutjen e efekteve, ose për realizimin e tyre. Si pasojë e këtyre faktorëve dhe ndikimeve, priten ndryshime edhe në përdorimet e tokës, pra në konvertime të saj nga një sistem në tjetrin. Këto konvertime mund të ndodhin mbi bazën e propozimeve të planit të përdorimit të tokës dhe të infrastrukturave, si dhe përmes procedurave ligjore të vendosura në legjislacion sektorial në fuqi (për bujqësinë, tokat natyrore, ujërat etj.). Më hartimin e strategjisë së zhvillimit, dhe detajimit të saj me anë të programeve dhe projekteve strategjike, krijohet një ide e përgjithshme mbi ndryshimet e mundshme që mund t'i ndodhë një territori të caktuar dhe sistemeve përkatëse. Më pas hartimi i planit të përdorimit të propozuar të tokës dhe infrastrukturave legjitimon të gjitha ndryshimet e propozuara nga strategjia



Harta e Peisazhit dhe Ndërhyrjet Përmirësuese. Editimi grafik nga E. Janku



territoriale dhe programet e projektet përkatëse.

Bazuar në VKM nr.671/2015, propozimet në kuadër të Strategjisë Territoriale për Bashkinë Dropull nuk ndryshojnë sistemet territoriale, pra në thelb ato mbeten të njëjtët: sistemi natyror, urban, bujqësor, ujqor dhe infrastrukturor, por disa territore brenda kufirit të Bashkisë mund të pësojnë ndryshime bazuar në tendencat e zhvillimit që propozon strategjia, e më tej plani. Në kuadër të këtyre ndryshimeve, janë konvertime të tokës bujqësore në ato pjesë të territorit ku parashikohen zhvillime si p.sh. krijimi i aksit të shpejtë Dropull – Sarandë; ndërtimi i segmentit rrugor Dropull – Livadhja; kalimi i linjës hekurudhore që planifikohet edhe nga PPK; ngritja e "Parkut të Biznesit" dhe Stacionit Multimodal; zgjerimi i zonës ekonomike përgjatë Rrugës Interurbane SH4; apo dhe krijimi i vendbanimit të ri pranë Stacionit. Edhe pse këto ndërhyrje mund të shkaktojnë konvertime të një pjese të territorit nga një sistem territorial në tjetrin, ato do të planifikohen të realizohen në mënyrë sa më kompakte, duke lejuar zhvillimin, por pa shkaktuar ndryshime të konsiderueshme në sistemet territoriale. Harta në vijim shpreh në mënyrë të përafërt konvertime e pritshme të sistemeve në territorin e Bashkisë Dropull. Duhet theksuar se në këtë seksion janë treguar tendencat e mundshme të transformimeve, ndërkohë që gjatë hartimit të Planit të Propozuar të Tokës këto tendenca do të materializohen dhe konkretizohen, dhe sipas rastit do të përgatiten për procedurat ligjore për konvertim.


Përcaktimi i territorit në bazë të 5 sistemeve: urbane, natyror, bujqësor, ujqor dhe infrastrukturor.

Territori në administrimin e Bashkisë Dropull është trefishuar në krahasim me sipërfaqjen e mëparshme të njësive administrative ku ajo bënte pjesë.


Me zgjerimin e sipërfaqjes së këtij territori, janë shtuar dhe sipërfaqje Natyrore, Ujqore, Infrastrukturore dhe të Vëndbanimeve. Duke u mbështetur në VKM nr. 671, datë 29.07.2015 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", për një planifikim sa më të mirë të territorit përcaktohet ndarja e tij në pesë sisteme territoriale si:

- Sistemi Natyror / Sistemi Ujqor / Sistemi Infrastrukturor / Sistemi Urban / Sistemi Bujqësor

Këto sisteme janë parë të reflektuara në territorin e Bashkisë Dropull dhe duke



Harta e Rëndësisë Kombëtare. Burimi / PPV Dropull



përdorur programin GIS për të përpunuar dhe analizuar këto të dhëna, territori është ndarë në pesë sisteme, duke zbatuar kushtet për ndarjen e territorit, përcaktuar nga VKM nr. 671 datë 29.07.2015. Në këto kushte mund të thuhet se:

Sistemet e Territorit / % të territorit të Bashkisë Dropull

Sistemi Natyror / 78%

Sistemi Ujor / 1.30%

Sistemi Infrastrukturor / 0.66%

Sistemi Urban / 2.02%

Sistemi Bujqësor / 18.03%

3.3.1 Sistemi Natyror

Sistemi Natyror në Bashkinë Dropull zë përqindjen më të madhe, me një total prej 78% të territorit, ose sipërfaqjes totale të Bashkisë. Në brendësi të këtij sistemi qëndron zona e mbrojtur me 3.83% të territorit, kullotat me 39.15 %, pyjet me 0.05% dhe bujqësia me 15.43% të territorit.

- Zonat e Mbrojtura

Monument natyre "Bredhi i Sotirës"

Bredhi i Sotirës është bërë pjesë e zonave të mbrojtura si zonë e kategorisë së III me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 102, datë 15.01.1996, Monument natyre Bredhi i Sotirës me një sipërfaqje prej 1,740.00 ha, nga të cilat vetëm 1,586.75 ha ndodhen brenda territorit të Bashkisë Dropull, me gati 75% pyje dhe pjesa tjetër kryesisht kullota dhe sipërfaqje shkëmbore.

Monumenti i natyrës Bredhi i Sotirës ndodhet në pjesën Jugore të Shqipërisë, në kufi me Greqinë. Gjithashtu ndodhet në skajin verior të Bashkisë së Dropullit, mbi Malin e Strugarës. Kjo zonë kufizohet në veri me Majën e Amblikos me lartësi 1,333 m dhe ndjek kurrizin në drejtim të kuotës 653 m, deri në Përroin e Selos. Në lindje ndjek rrugën automobilistike në kufirin shtetëror me Greqinë, maja e Musovunit dhe maja e Murganës. Bredhi i Sotirës ndodhet 0.4 km nga Sotira në vijë ajrore, 0.3 km nga fshati Selo në vijë ajrore dhe 3.7 km në vijë ajrore nga rruga kryesore, duke e bërë këtë zonë një vend të qetë dhe me vlera të larta biodiversiteti nga pikpamja e habitateve dhe llojeve, me vlera të konsiderueshme shkencore dhe eko-turistike. Kufijtë e dixhitalizuar përfshijnë:

- Në Veri, Maja Amblikos 1,333 m / (4441247.93L/4412892.19V);
- Në Lindje, Pika me koordinata (4447193.44L/4412740.14V), Maja Murganës 1,806.4 m / (4447390.40L/4406172.80V);
- Në Jug, Maja Murganës 1,806.4 m / (4447390.40L/4406172.80V);
- Në Perëndim: Kuota 1,735.7 m /

(4440171.44L/4410136.31V).

Në Zonën e mbrojtur të Bredhit të Sotirës, sipas hartave të përbërjes Gjeologo-inxhinjerieke të tokave evidentohen ndarje në tre klasifikimeve kryesore bazuar në gjenezën e shkëmbinjve, veçorive petrografike dhe geomorfologjike: shkëmbinj të fortë, gëlqerorëdolomitike dhe evaporite. Në klasifikimin e parë janë shkëmbinj me qëndrueshmëri të madhe ujore dhe me shpate shumë të pjerrët, me deformim të vogël dhe luginat lumore kanë formën 'V' të lidhur me proceset sipërfaqësore. Në klasifikimin e dytë gëlqerorë dolomitike janë kryesisht përfaqësime ndërthurjesh midis shtresave gëlqerore dhe dolomitike, ku shkëmbi përbëhet prej lënde të pakristalizuar. Këta shkëmbinj qëndrojnë vertikalisht në lartësi mbi 1,000 m, me pjerrësi më të vogël ku përqëndrohet dhe bimësia. Në klasifikimin e tretë janë përbërje evaporitike që përfaqësohen nga gjipset, anhidridet dhe kripa e gurit. Ato janë të buta me thyerje, pjerrësi të lehtë bimësi të dendur dhe me kraste sipërfaqësore të zhvilluara.

- Biodiversiteti

Bredhi i Sotirës përfaqëson një natyrë të virgjër, komplekse dhe të pasur me vlera si nga ana eko- turistike dhe nga ajo shkencore. Hapësira në të cilën ndodhet dhe pozicionimi i tij largë rrugës dhe vendbanimeve e bëjnë të pasur në aspektin e biodiversitetit të habitateve dhe llojeve të vegjetacionit, ku një pjesë dominante zihet nga Flora e Dushkajave të përherëblerta, e cila karakterizohet nga pyjet: qarr, mëllëzë, shkozë, frashër, rrapishtet, (*Crataegus monogyna*) bimë- mjekësore me veti të larta dhe përdorime të ndryshme industriale dhe vetiake, (*Rubus ulmifolius*) një lloj manaferrash të egra, (*Sanguisorba minor*) e cila është një bimë në familjen e (*Rosaceae*), ose trëndafilave, që përbën një nga 4,828 speciet e njohura dhe rritet në pjesët shkëmbore të parkut. Kjo bimësi gjen përdorim gjithashtu në mjeksi në formën e çaj-it. Shoqërim interesant dhe dominant mbetet edhe *Abies borisii-regis* (*Huetio-Abietum*), ndryshe Bredhi i Bardhë me prejardhje Ballkanike. Kati shkurror përbëhet kryesisht nga murrizi (*Crataegus heldreichii*), dëllinja e zezë (*Juniperus communis*), (*Daphne mezereum*) etj. Një element, i cili i shton vlerat peizazhistike zonës është dhe pasuria e rrjetit hidrografik më rrjedha të shumta sezonale dhe përrenj si ai i Selos që kalon në vendbanimin e Selos dhe furnizon lumenjtë e Kserjasit dhe Llongos që kalojnë në vendbanimin e Sotirës.

3.3.2 Sistemi Ujor

Sistemi ujor në Bashkinë e Dropullit zë

rreth 1.30% të sipërfaqes së përgjithshme. Ky sistem përbëhet nga rezervuarë, lumenj sezonalë dhe të përhershëm, si dhe infrastruktura mbështetëse për bujqesinë, pra kanalet ujitëse dhe të kullimit.

Lumi Drinos

Lumi Drinos është dega më e madhe e rrjetit hidrografik të lumit Vjosa. Gjatësia e shtratit të tij është 85 km dhe pjerrësia 5 m. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës të këtij lumi është 1,324 km², nga të cilat vetëm 1,078 km² shtrihen brenda territorit të Shqipërisë. Ky lum e ka fillimin e tij në Greqi, në shpatet e malit Elatos dhe futet në territorin shqipëtar në Baskinë e Dropullit midis Radatit dhe Kakavies, duke ndjekur një rrjedhë të rregullt Veri-Perëndimit.

Ultësira ndërmjet Malit të Gjerë dhe Lunxhëri-Buretos përbëhen nga formacione flishi në pjesën e sipërme të tyre, të mbushur me zhavorre. Shtrati i lumit Drinos është i vendosur mbi formacione flishi deri në Vrisera. Duke iu afruar Gjirokastrës flishet i nënshtrohen procesit të shpëlarjes.

Lumi Drino kalon nëpër një shtrat të gjerë, por kjo rrjedhje ngushtohet pas Urës së Leklit deri në derdhjen e tij në Vjosë. Gjatë rrjedhjes së tij nga ky lum dalin përrenj me rrjedhje të përkohshme sipërfaqësore shumë erodues që derdhen në konuse të mëdha depozitimi, si përroi i Vriserasë, i Suhës dhe Nemicës.

Prurja maksimale e Drinos me përsëritje 1 herë në 100 vjet në derdhje është $Q_{M1\%}=1840 \text{ m}^3/\text{s}$. Temperaturat e ujërave ndryshojnë nga $t = 8.4^\circ\text{C}$ në muajn Janar, deri në $t = 17.8^\circ\text{C}$ në Gusht. Ujërat e Drinos kanë një mineralizim mesatar prej $m_j = 380 \text{ mg/lit}$ dhe një fortësi prej 13.5 gradë Gjermane.

3.3.3 Sistemi Infrastrukturor

Infrastruktura rrugore zë rreth 0.69% të sipërfaqes së përgjithshme të territorit të Bashkisë Dropull, ose ndryshe një total prej 313.24 ha.

Infrastruktura / Sip. (ha) / % / Gjatësi (km)

Rrugë Interurbane Kryesore

52.07 ha

16.62 (të sipërfaqes totale të rrugëve)

49.61 km

Rrugë Interurbane Dytësore

27.62 ha

8.82% (të sipërfaqes totale të rrugëve)

62.08 km

Rrugë Urbane Kryesore

4.55 ha

1.45% (të sipërfaqes totale të rrugëve)

7.23 km

Rrugë Urbane Dytësore
9.51 ha
3.05% (të sipërfaqes totale të rrugëve)
21.06 km

Rrugë Urbane Lokale
206.69 ha
66.05% (të sipërfaqes totale të rrugëve)
726.27 km
*Sistemi Infrastrukturor, Klasifikimi sipas
Kodit Rrugor

Rrugët dhe transporti

Për Bashkinë Dropull Rruga Interurbane Kryesore SH4, e cila zë 16.62% të sipërfaqes totale të rrugëve, ose rreth 52.07ha, luan një rol mjaft të rëndësishëm përsa i përket jo vetëm lidhjes së saj me Bashkinë Gjirokastrë dhe me Rajonin e Janinës përtej kufirit, por siguron gjithashtu akses për të gjithë fshatrat e Njësi Administrative Dropull i Sipërm dhe Dropull i Poshtëm. Një sërë biznesesh dhe njësish ekonomike janë pozicionuar përgjatë kësaj rruge, jo vetëm për të krijuar ekonominë e shkallës, por edhe sepse ajo siguron akses të shpejtë të tyre në lidhje me tregjet brenda vendit dhe përtej kufirit. Përmes këtij aksi bëhet gjithashtu lidhja me Njësinë e Pogonit, edhe pse cilësia e kësaj rruge në këtë Njësi është mjaft e keqe, duke shkaktuar vështurësi aksesit dhe vonesa në kohë.

Rruga Interurbane Dytësore zë 8.82% të sipërfaqes totale të rrugëve, ose rreth 27.62 ha, dhe kalon përmes territorit të Bashkisë Dropull, duke lidhur fshatrat Vrahogoranxi, Glinë, Jorgucat, qeështë dhe qendra e re e Bashkisë Dropull, me Bashkinë Sarandë. Ky aks përbën një lidhje mjaft strategjike, pasi lidh zonat ekonomike të Dropullit me portin e Sarandës. Pavarësisht rëndësisë ekonomike që ka ky aks, terreni i vështirë ku ai kalon e bën jo shumë të favorshëm dhe të aksesueshëm për automjetet e tonazhit të rëndë, ndaj është kjo arsyeja që njësitë ekonomike të zonës së Dropullit dhe Gjirokastrës preferojnë dhe përdorin më së shumti portin e Igumenicës, me gjithë kostot shtesë doganore që aplikohen në këtë portë.

Rrugët Urbane Kryesore zënë 1.45% e sipërfaqes totale të rrugëve, ose rreth 4.55 ha, dhe duke konsideruar që thuajse të gjitha zonat e banuara të Bashkisë Dropull kanë karakter rural, janë të kufizuara vetëm në lidhjet e qendrës së fshatrave të Njësi Dropull i Poshtëm dhe Dropull i Sipërmme Rrugën Interurbane Kryesore SH4. Në brendësi të fshatrave, lidhja ndërmjet qendrave kryesore bëhet përmes Rrugëve Urbane Dytësore (3.05%

sipërfaqes totale të rrugëve, ose rreth 9.51 ha), të cilat gjenden më së shumti në Njësinë Dropull i Poshtëm, dhe vetëm në fshatrat Jorgucat dhe Bularat në Njësinë e Dropullit të Sipërm. Pjesa tjetër e infrastrukturës rrugore shërbyese në brendësi të fshatrave përbëhet nga Rrugë Lokale të karakterit rural, të cilat përbëjnë 66.05% të sipërfaqes totale të rrugëve, ose rreth 206.69 ha.









Mungesë të theksuar të infrastrukturës rrugore shërbyese ka Njësia e Pogonit, në të cilën të vetmet rrugë aksesit janë ato lokale. Cilësia e tyre mjaft e dobët, jo vetëm ka ndikuar në izolimin e fshatrave, por është dhe një nga faktorët kryesorë që ka çuar në braktisjen e banesave dhe aktiviteteve ekonomike në të gjithë fshatrat e Njësisë Pogon.

- "Hot Spots", Pikat e ndërprerjes së rrugëve lokale me rrugët interurbane kryesore

Duke marrë parasysh strukturën e mësipërme të sistemit infrastrukturor rrugor në territorin e Bashkisë Dropull, një ndër çështjet më problematike është ndërlidhja e rrugëve të kategorive të ndryshme midis tyre. Duke qenë se arteria kryesore shërbyese është Rruga Interurbane Kryesore SH4, që kalon përmes dy Njësi Dropull i Poshtëm dhe i Sipërm, të gjithë fshatrat që ndodhen në këtë pjesë të territorit kanë dalje të drejtpërdrejtë në këtë Rrugë. Vetëm një pakicë shumë e vogël e fshatrave kanë Rrugë Urbane Kryesore dhe Rrugë Urbane Dytësore. Pjesa tjetër kanë vetëm Rrugë Lokale të karakterit Rural. Në këto kushte, pavarësisht tabelave që lajmërojnë hyrjen dhe daljen nga çdo fshat, kalimi i drejtpërdrejtë nga Rrugët Lokale në atë Interurbane Kryesore, paraqet ngërçe në lëvizje dhe shndërrohet në një burim të drejtpërdrejtë aksidentesh. Për të shmangur këto problematika, më tej në propozimet për rrjetin infrastrukturor rrugor do të punohet për të ngritur një sistem hierarkik rrugësh sipas kategorive.

- Gjendja e infrastrukturës rrugore

Duke përjashtuar Rrugën Interurbane Kryesore SH4 dhe Rrugën Interurbane Dytësore Vrahogoranxi- Glinë- Jorgucat- Sarandë, që janë në gjendje të mirë dhe përbëjnë rreth 22.22% të sipërfaqes totale të rrugëve, përkthyer në 69.61 ha, pjesa tjetër e rrjetit të infrastrukturës rrugore në territorin e Bashkisë Dropull paraqitet problematike dhe në nevojë për ndërhyrje. Rreth 29.81% të sipërfaqes totale të rrugëve, përkthyer në 93.38 ha, janë kryesisht Rrugë Urbane Kryesore dhe Dytësore, të cilat janë në gjendje të



mesme. Pjesa tjetër e rrjetit infrastrukturor rrugor, që konsiston më së shumti nga Rrugë Lokale të karakterit rural, por edhe nga hierarki të tjera rrugësh, por të amortizuara, përbëjnë rreth 44.33% të sipërfaqes totale të rrugëve, përkthyer në 138.85 ha. Emergjentë paraqitet situata sidomos në Njësinë e Pogonit. Rrugët Lokale thuajse në të gjithë fshatrat nuk kanë pësuar asnjë mirëmbajtje që nga hapja e tyre, madje shumica janë ende të shtruara vetëm me çakull, ose të pashtuara fare, gjë që vështirëson aksesin dhe rrit koston oportune kohë. Në total 37.26% e sipërfaqes totale të rrugëve, e cila përbën rreth 116.71 ha, janë rrugë të asfaltuara, ndërsa 51.11% e sipërfaqes totale të rrugëve, e përkthyer në 185.14 ha janë të paasfaltuara. Përsa i përket Kategorive të Rrugëve, referuar Kodit Rrugor, përqindjet më të mëdha i zënë Rrugët Pejzazhistike me rreth 32.38% të sipërfaqes totale të rrugëve, përkthyer në 104.1 ha, dhe Rrugët Bujqësore me rreth 23.95% të sipërfaqes totale të rrugëve, përkthyer në 75.05 ha. Kjo shpjegohet edhe nga vetë karakteri i territorit të Bashkisë Dropull, ku bujqësia dhe turizmi bazuar tek pejzazhi dhe natyra janë dy karakteristikat kryesore të zhvillimit të territorit dhe baza kryesore ekonomike për Bashkinë Dropull.

Infrastruktura / Sipërfaqja (ha) / %

Rrugë Arterie
8.67 ha
2.8% (të sipërfaqes totale të rrugëve)

Rrugë Bujqësore
75.05 ha
23.96% (të sipërfaqes totale të rrugëve)

Rrugë e Brendshme Dytësore
19.07 ha
6.09% (të sipërfaqes totale të rrugëve)

Rrugë e Brendshme Kryesore
30.97 ha
9.89% (të sipërfaqes totale të rrugëve)
Rrugë Kolektor
45.92 ha
14.66% (të sipërfaqes totale të rrugëve)

Rrugë Korridor Shumë-funksional
1.25 ha
0.4% (të sipërfaqes totale të rrugëve)

Rrugë Pejzazhistike
104.1 ha
32.38% (të sipërfaqes totale të rrugëve)
Rrugë Rekreative
23.33 ha
7.45% (të sipërfaqes totale të rrugëve)

Rrugë Shërbimi
7.44 ha
2.38% (të sipërfaqes totale të rrugëve)

Lëvizja e banorëve drejt vendit të punës dhe linjat e transportit

Me një karakter të theksuar rural ekonomia e popullsisë në Bashkinë Dropull bazohet kryesisht tek bujqësia, blegtoria dhe ofrimi i shërbimeve.

Bujqësia dhe blegtoria zhvillohen në bazë familjeje, që përkthehet në banesa private, të cilat kanë zonën bujqësore, ose blegtorale të integruar dhe pranë zonës së banimit. Për sa i përket sektorit të shërbimeve dhe biznesit, njësitë ekonomike janë të përqëndruara përgjatë Rrugës Interurbane Kryesore SH4, e cila lidh midis tyre dhe kalon përmes dy Njësie, Dropull i Sipërm dhe Dropull i Poshtëm, duke lidhur territorin e Bashkisë Dropull edhe me Bashkinë Gjirokastrë dhe Rajonin e Janinës përtej kufirit. Lëvizja e banorëve nga vendi i banimit, drejt atij të punësimit në këtë rast, bëhet përmes automjeteve personale, ose me shërbimin taksi.

Duke qenë se popullsia minoritare përbën rreth 1/6 e popullsisë totale, nga ku rreth 1/2 e minoritetit Grek, marrëdhëniet me Greqinë kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë mjaft të ngushta. Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë është e punësuar në sektorë të ndryshëm jashtë kufirit, për t'u kthyer në Shqipëri (Bashkinë Dropull) në periudha sezonale, që variojnë nga vjetore, në mujore, javore, madje edhe ditore. Mobiliteti për këtë segment të popullsisë realizohet përgjithësisht me automjete personale, ose me anë të shërbimit taksi.

Në Bashkinë Dropull ka vetëm 1 linjë të transportit publik që ofrohet dhe manaxhohet nga Bashkia Dropull: Poliçan-Zagori- Gjirokastrë, me frekuencë dy herë në javë. Nëvojat e tjera për transportin publik mbulohen nga 4 operatorë privatë, të cilët operojnë në 4 linja kryesore:
o Gjirokastrë- Sofratikë (2 operatorë);
o Gjirokastrë-Kakavijë (2 operatorë);
o Llongo- Gjirokastrë (1 operator);
o Llongo- Pershkëpi (1 operator me frekuencë 2 herë në javë);
Stacionet ekzistuese zyrtare për linjat e mësipërme janë 5, nga një në çdo fshat: Dervician, Vanister, Sofratikë, Terihat dhe Grapsh.

Me ndërtimin dhe zhvendosjen e godinës së re të Bashksië në fshatin Jergucat, sistemi i transportit publik pritet të ketë ndryshime, si në oraret e funksionimit, ashtu edhe në shtimin e linjave dhe stacioneve, nga ku parashikohen stacionet: Haskovë, Goricë,

Frashtan, Jergucat, Zervat, Bodrishtë, Vriser dhe Kakavijë.

▪ Infrastruktura e shërbimit me ujë dhe kanalizimet

Shënim: Analizat e Infrastrukturës së shërbimit me ujë dhe kanalizimet, në mungesë të të dhënave nga sektori përkatës nuk janë gjeneruar ende. Deri në përfundim të procesit të hartimit të PPV-së (proces dakortësuar të kryhet me 1 ndalesë), grupi i punës do të punojë në vazhdimësi të sigurojë të dhëna të mjaftueshme për të kryer analizën.

3.3.4 Sistemi Urban/ Rural

Bashkia Dropull është një Bashki rurale, e cila përbëhet nga 3 Njësi Administrative dhe 41 fshatra. Njësia Dropull i Sipërm ka 16 fshatra, Njësia Dropull i Poshtëm 18 dhe Njësia e Pogonit ka 7 fshatra. Qendra më e madhe e banuar e Bashkisë Dropull është fshati Dervician në Njësinë Dropull i Poshtëm, që zë rreth 0.09% të të gjithë territorit të Bashkisë, e përkthyer kjo në 42.92 ha. Në Bashkinë Dropull Derviciani përbën zonën e vetme që mund të konsiderohet me karakter disi urban, ndërsa pjesa tjetër e banuar e territorit ka karakter të theksuar rural.

- Cilësia Fizike e Ndërtesave

Për kryerjen e kësaj analize grupi i punës ka kryer një ekspeditë 3 ditore në Bashkinë Dropull, duke lëvizur në të 41 fshatrat për të bërë dokumentimin e gjendjes, konstruksionit dhe përdorimit për çdo ndërtesë.

Referuar kësaj analize në Bashkinë Dropull ka gjithsej 6,700 ndërtesa, të cilat zënë rreth 0.16% të të gjithë territorit, e përkthyer në 73 ha sipërfaqe totale e ndërtuar. Për arsye vështirësie në akses nga totali i përgjithshëm u arrit tëurvejohen në terren vetëm 6,027 ndërtesa. Nga ky total:

1..1. 206 ndërtesa datojnë rreth viteve '30-të, ose më parë;

1..2. 1,344 ndërtesa datojnë rreth viteve '40- '50të;

1..3. 3,069 ndërtesa datojnë rreth viteve '80- '90; dhe

1..4. 1,408 ndërtesa datojnë në vitet 2000 e më pas.

Janë numëruar 5,052 banesa, të cilat kanë mbulesë me çati dhe 941, të cilat kanë tarracë. Të dhënat e grumbulluara në lidhje me cilësinë fizike të ndërtesave variojnë si më poshtë:

- Ndërtesa të rrënuara: 191 njësi, ose 3.48% e sipërfaqes së përgjithshme së ndërtuar;

- Ndërtesa në kushte të dobëta të cilësive fizike: 625 njësi, ose 8.15% e sipërfaqes së përgjithshme së ndërtuar;

- Ndërtesa në kushte të mesme të cilësive

fizike: 2,165 njësi, ose 29.26% e sipërfaqes së përgjithshme së ndërtuar;

- Ndërtesa në kushte relativisht të mira të cilësive fizike: 2,177 njësi, ose 45.28% e sipërfaqes së përgjithshme së ndërtuar;

- Ndërtesa të reja e në kushte shumë të mira të cilësive fizike: 68 ndërtesa, ose 1.47% e sipërfaqes së përgjithshme së ndërtuar;

- Ndërtesa në konstruksion, ende të papërfunduara: 44 ndërtesa, ose 0.84% e sipërfaqes së përgjithshme së ndërtuar.

- Ndërtesa të vjetra (vitet '30-të ose më parë dhe '40-'50), por të rikonstruktura: 479 njësi, ose 7.25% e sipërfaqes së përgjithshme së ndërtuar;

Duke qenë se Bashkia e Dropullit karakterizohet nga lëvizje aktive të emigracionit dhe migracionit, qoftë ato afat-gjatë, edhe ato në afate të shkurtra kohore, banueshmëria rezulton si më poshtë:

1..5. Banesa të braktisura: 278 njësi;

1..6. Banesa që banohen në kohë të pjesshme, gjatë fundjavave (gjatë javës familjarët janë të punësuar e banojnë në Greqi): 1,685 njësi;

1..7. Banesa që banohen përkohësisht, familjarët kthehen vetëm gjatë verës: 223 njësi;

1..8. Banesa pronarët e të cilave banojnë jashtë vendit, dhe që janë dhënë me qera: 10 njësi;

1..9. Banesa që banohen gjatë tërë vitit: 3,640 njësi.

▪ Vendbanimet Informale

Referuar letrës së Ministrisë së Zhvillimit Urban me Nr. 2826/1 Prot., datë 29.05.2017, në përgjigje të shkresës së Bashkisë Dropull për mbledhje të dhënash, me Nr.2512/1 Prot., datë 18.04.2017, sipas ALUIZNIT në territorin e Bashkisë Dropull, nuk ka Zona Informale të miratuara.

Ndërhyrjet informale në sistemin e vendbanimeve në territorin e Bashkisë Dropull kanë karakter të shpërhapur, duke u kufizuar në shtime anësore të ndërtesave, shtesa në numër katesh, ose ndërtesa të reja të cilat janë ndërtuar në krah të atyre ekzistuese, ose në tokë me përdorim bujqësor, por jo duke krijuar zona me karakter informal. Si rrjedhim i këtij fakti, dhe duke ju referuar sërish letrës së mësipërme nga ALUIZNI, në Bashkinë Dropull ka një total prej 144 lelesh të dhëna për legalizim e këtyre objekteve informale.

Përqëndrimin më të madh të këtyre objekteve e ka fshati Dervician, i cili përfaqëson dhe zonën me karakter më të theksuar urban në të gjithë territorin

NR.NDËRTESASH	KOHA E NDËRTIMIT
206	'20-'30 të
1,344	'40-'50 të
3,069	'80-'90 të

1,408 pas 2000

Burimi: Të dhëna të mbledhura nga grupi punës

CILËSIA FIZIKE	NR. NDËRTESASH	% NGA TOTALI
Ndërtesa të mënuara	191	3.48%
Ndërtesa në kushte të dobëta fizike	625	8.15%
Ndërtesa në kushte mesatare fizike	2,165	29.26%
Ndërtesa të reja në kushte shumë të mira	2,177	45.28%
Ndërtesa në konstruksion ende pa mbaruar	44	0.84%
Ndërtesa të vjetra ('20-'30, '40-'50)	479	7.25%

Burimi: Të dhëna të mbledhura nga grupi punës

GJENDJA E PËRDORIMIT	NR. NDËRTESASH
Banesa të braktisura	278
Banesa që banohen me kohë të pjesshme	1,685
Banesa që banohen përkohësisht (verë)	
Banesa pronarët e të cilëve banojnë jashtë vendit	233
Banesa që banohen gjatë tërë kohës	223

3,640

Burimi: Të dhëna të mbledhura nga grupi punës

Cilësia fizike e ndërtesave; Burimi: të dhëna të mbledhura nga grupi i punës

e Bashkisë Dropull, si dhe vendin që ka përjetuar dhe presionin më të madh për zhvillim. Të pakta kanë qenë ndërhyrjet informale sidomos në Njësinë e Pogonit dhe zonat e thella malore të Njësisë Dropull i Sipërm.

■ **Pronësia Publike/Private**
Ashtusi shumënjësi të tjetra administrative në territorin shqipëtar edhe Bashkia Dropull nuk ka një sasi të konsiderueshme pronash publike. Shumica e tyre si pasojë e privatizimeve që kanë ndodhur kanë kaluar në pronësi private¹¹.

Në total në Bashkinë Dropull ka 5,919 struktura në pronësinë private, të cilat kanë më së shumti përdorim banimi, por pa përjashtuar edhe njësitë ekonomike. Këto përbëjnë rreth 96.68% të të gjithë ndërtimeve në territorin e Bashkisë.

Në pronësi publike numërohen rreth 121 struktura, ose rreth 3.31% e fondit të ndërtuar në të gjithë Bashkinë Dropull, të cilat janë më së shumti struktura me përdorim administrativ, ose institucione publike si shkolla, kopshte, qendra shëndetësore etj.

■ **Trashëgimia Kulturore dhe Historike**
Bashkia Dropull ka një numër të konsiderueshëm objektesh me vlera historike dhe kulturore të shpërndara thuajse në të gjithë territorin e saj administrativ.

Bazuar dhe në karakterin e vetë zonës së Dropullit, zonë minoritare rurale e shtrirë përgjatë luginës së lumit Drinos dhe përgjatë vargmaleve, vendbanimet kanë vlera të mëdha qoftë si objekte me karakteristika të veçanta arkitekturore, qoftë edhe sipasojë e përshtatjes që kanë pësuar në kohë, duke krijuar një bashkëjetesë thuajse perfekte me terrenin e thyer malor dhe fondin natyror e bujqësor që përfaqëson dhe bazen e ekonomisë lokale.

Objektet me rëndësinë më të madhë

historike e kulturore në Bashkinë Dropull janë shpallur Monumete Kulture, dhe janë plot 42 objekte të Kategorisë së I, nga të cilat 3 janë të nënkategorisë "zona" dhe 38 të nënkategorizë "objekte".

Nga ky total dallojnë disa tipologji:

- Objekte banimi dhe fortifikime:
- Kala
- Vendbanime të rrënuara
- Banesa
- Kulla
- Objekte kulti:
- Manastire
- Kisha
- Varre
- Objekte infrastrukture:
- Ura
- Çezma
- Puse

Analiza e Tipologjive Hapësinore

Fjala "tipologji" nënkupton klasifikimime karakteristikave kryesore dalluese të një ose disa objekteve, apo dukurive. Kur flasim për "tipologjitë hapësinore" kemi parasysh një analizë komplekse, e cila konsiston në dallimin e karakteristikave, të cilat shpjegojnë marrëdhënien e objekteve (qoftë ato të banimit, dhe ato me përdorim ekonomik) midis tyre, ose në raport me territorin, ku ato ndodhen.

Në këto kushte, analiza e tipologjive hapësinore për territorin e Bashkisë Dropull është realizuar në dy shkallë të ndryshme¹²:

- Në nivel territorial – duke konsideruar fshatin me të gjithë territorin e tij administrativ si një njësi e vetme e banuar, është analizuar marrëdhënia e tij në lidhje me topografinë e territorit në të cilin ndodhet, afërsinëndaj rrugës kryesore, si dhe marrëdhënien me elementët e fortënatyrorë që kanë kushtëzuar mjaft faktorë zhvillimorë, në rastin konkret lumin. Duke analizuar çdo fshat me







#hyrnëDropull
gati për t'u eksploruar





Source: General Local Plan of Dropull Municipality

metodologjinë e mësipërme, u përfytuan 4 tipologji kryesore hapësinore territoriale si më poshtë:

- Tipologjia A – shtrirja e vendbanimit fshat ndodh përgjatë rrugës kryesore dhe përgjatë lumit, përgjithësisht në terren fushor;
- Tipologjia B – shtrirja e vendbanimit fshat ndodh e zhvendosur nga rruga kryesore dhe nga lumi, në terren kodrinor;
- Tipologjia C – shtrirja e vendbanimit fshat ndodh larg rrugës kryesore dhe lumit, shpesh e izoluar nga pjesa tjetër e territorit, e vendosur në terren malor;
- Tipologjia D – shtrirja e vendbanimit fshat ndodh pranë, ose në largësi të vogël nga rruga kryesore, ose lumi, por e ndarë në dy pjesë, në të dy anët e rrugës, ose lumit.

1. Në nivel vendbanimesh – duke marrë në konsideratë karakteristikat hapësinore të shtrirjes së vendbanimeve janë evidentuar gjithsej 22 tipologji për 41 fshatrat e Bashkisë Dropull. Tipologjitë bazë janë si më poshtë, ndërkohë pjesa tjetër ka karakter të përzier, që vjen si pasojë e ndërthurjes së tipologjive të mëposhtme:

3.3.5 Sistemi Bujqësor

Bashkia Dropull ka rreth 7,000 ha tokë bujqësore, e cila ndarë sipas Njësive Administrative rezulton që thuajse 87% e totalit zotërohet nga Njësitë Dropull i Poshtëm dhe i Sipërm, respektivisht me 46% dhe 41%, dhe vetëm 13% zotërohet nga Njësia e Pogonit. Në nivel Bashkie koeficienti i shfrytëzimit të tokës bujqësore, që është dhe tregues i efektivitetit ekonomik të përdorimit të saj, është 44%, dhe vlera maksimale arrihet në Njësinë e Dropullit të Sipërm me 49% dhe vlera minimale në Pogon me 21%. Nga këndvështrimi strukturor shpërndarja e tokës bujqësore gjithsej dhe pjesës së kultivuar, varion nga 50% në Njësinë Dropull i Sipërm, në 46% në Njësinë Dropull i Poshtëm dhe vetëm në 4% një Njësinë e Pogonit.

Përsa i përket strukturës së mbjelljes së tokës së punuar bujqësore sipas proukteve, në nivel Bashkie rreth 72% e saj kultivohet me bimë foragjere, 25% me drithra dhe 2.6% me perime, fruta, patate, fasule e bimë medicinale. Ndërkohë që Njësitë Dropull i Poshtëm dhe i Sipërm, si produkt primar kanë drithrat dhe bimët foragjere, Njësia e Pogonit dallohet për prodhimin e frutave që përbëjnë rreth 50% të prodhimit frutor në nivel Bashkie, ose 25% të produktit bujqësor të kësaj Njësie. Përsa i përket fermave bujqësore, numrin më të madh të njësive bujqësore e zotëron

Njësia e Dropullit të Poshtëm me rreth 2,300 njësi, ose rreth 46% të numrit total të njësive bujqësore. Ndërkohë Njësia e Pogonit regjistron numrin më të vogël të njësive bujqësore me rreth 700 njësi, ose 13% të numrit total në nivel Bashkie. Madhësia mesatare e njësisë ekonomike bujqësore për Bashkinë Dropull është rreth 1,3ha, ose rreth 36% më e vogël se madhësia mesatare e fermës bujqësore në nivel qarku dhe vendi, që vlerësohet me 2ha. Ky tregues është relativisht i përafërt në dy Njësitë Administrative të Dropullit të Poshtëm dhe të Sipërm, ndërkohë që Njësia e Pogonit regjistron vlerën mesatare më të ulët për madhësinë e fermës bujqësore/ njësisë ekonomike bujqësore, vlerësuar me 0.7ha.

Analiza e volumit të prodhimit bujqësor në vite në nivel Bashkie nxjerr në pah një rënie që për vitin 2016 vlerësohet të jetë në rreth (-43%), krahasuar me vitin 2015. Rënia më e madhe shënohet në Njësinë e Pogonit me rreth (-74%) të prodhimit, ndërkohë që rënia më e ulët konstatohet në Njësitë e Dropullit të Poshtëm me (-28%) dhe Dropullit të Sipërm me (-21%). Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në këtë rënie, si dhe në rritjen e stokut të prodhimit gjendje në magazine, rezultojnë të jenë të ndryshëm, ku përmenden: çmimet e larta të inputeve bujqësore, farëra, plehrave, pesticideve etj.; çmimi i lartë i karburantit për mekanikën bujqësore pas heqjes së subvencionit nga shteti; tarifat e larta të punimeve bujqësore dhe për rrjedhojë çmimet e larta të prodhimit vendas; çmimet e ulëta të produkteve bujqësore të importuara, të cilat janë të zhveshura nga taksimi dhe mbulohen me subvencione nga shteti etj. Në pamje të parë rënia më e madhe është shënuar në grupin e perimeve, vlerësuar me rreth (-71%), ndjekur nga rënia e grupit të drithrave me rreth (-27%).

Boniteti i Tokave

Boniteti është një tregues që vlerëson agro-prodhueshmërinë e tokës. Një kategori përfshin brenda të gjithë cilësitë e tokës, duke treguar që ajo mund të jetë e një standarti e një zhvillimi bujqësor të qëndrueshëm, ose që nuk është e përshatshme për zhvillimin e bujqësisë dhe nuk ka nivel nivel të mrië prodhimi. Tokat më të mira janë duke filluar nga kategoria e I deri në kategorinë e IV, ndërsa kategoritë VII deri në X janë toka të dobëta nga pikëpamja agroprodhuese, pasi nuk plotesojnë kërkesat e bimëve dhe nuk janë të përshtatshme për bujqësi. Në këtë këndvështrim kategoritë I deri ne IV duhet të ruhen nga përdorimi me qëllime të tjera.

Në këtë kontekst, për Bashkinë Dropull fondi i tokës bujqësorë shtrihet përgjithësisht në fushën e Dropullit, përgjatë luginës së lumit Drinos, dhe shumë pak në Njësinë e Pogonit përgjatë rrjedhës së lumit të Suhës. Boniteti i tokave varion nga kategoria e III-IV që janë dhe tokat me prodhimtarinë më të lartë, në kategoritë më pak prodhuese V-VIII. Tokat bujqësore me cilësinë më të mirë të kategorisë III-IV shtrihen përgjatë ultësirës së fushës së Dropullit dhe përgjatë rrjedhës së lumit Drino, dhe u përket fshatrave të Njërive Dropull i Sipërm dhe Dropull i Poshtëm. Sa më shumë largohemi nga rrjedha e lumit Drino aq më pak prodhuese bëhet toka bujqësore.

KAPITULLI 4- PROGRAMET, POLITIKAT DHE KONSIDERATA FINANCIARE

4.1 Programet dhe Politikat

Për realizimin e Objektivave Strategjike dhe Programeve në funksion të tyre, për secilin program janë përcaktuar një sërë politikash, ose projektsh që vijojnë si më poshtë.

OS_1: Rritja e askesueshmërisë dhe integrimi territorial

Programi Strategjik OS1PS1: Lidhja e shpejtë me Portin e Sarandës dhe Itinerari Turistik drejt Rivierës. Implementimi i segmentit rrugor lidhës Vodhinë-Kërrë- Livadhja- Sarandë planifikohet të realizohet për të shkurtuar distancën dhe afatet kohore, si dhe rritur e përmirësuar cilësinë e infrastrukturës rrugore. Ky aks do t'i shërbejë në mënyrë të veçantë bizneseve dhe transportit të mallrave, të cilët do të inkurajohen që të përdorin Portin e Sarandës, në vend të atij të Igumenicës, për të ulur kostot në transport dhe taksa. Krijimi i kësaj lidhjeje të shpejtë do t'i shërbejë jo vetëm Bashkisë Dropull, por të tërë Rajonit Jugor të Shqipërisë. Ky aks do të realizojë gjithashtu një lidhje dhe integrim më të mirë të territorit të Bashkisë Dropull me zonën e Rivierës, duke rritur mundësitë e integritit edhe përsa i përket zhvillimit të turizmit dhe tërheqjes së turistëve edhe drejt zonës së Dropullit.

Programi Strategjik OS1PS2: Përmirësimi i infrastrukturës rrugore ekzistuese dhe implementimi i sistemit "sloë line" infrastrukturor alternativ që lidh më mirë fshatrat midis tyre, si dhe siguron akses ndaj vendeve me atraksion turistik.

Për realizimin e këtij programi/ projekti do të ndërmeren një seri ndërhyrjesh strategjike me karakter infrastrukturor

lidhës:

- Krijimi i akseve lidhëse këmbësore dhe për bicikleta (sloë line) për të lidhur fshatrat dhe zonat e shërbimit midis tyre;
- Zgjatja e këtyre akseve lidhëse edhe në fshatrat që ndodhen në pjesën më të lartë të territorit (që momentalisht janë dhe zonat më të izoluar);
- Krijimi i një sistemi të plotë lidhës sidomos në zonën e Pogonit;
- Lidhja e këtyre akseve me zonat e atraksionit turistik: ballkone natyrore, kisha, manastire, parqe natyrore dhe objekte të tjera me rëndësi;
- Lidhja e këtyre akseve me zonat e zhvillimit të agro-turizmit, bujtinat pritëse dhe fermat e bio- produkteve;
- Markimi me sinjalistikën përkatëse orientuese;
- Krijimi i kushteve të sigurta të lëvizjes aty ku terreni është i thyer (zonat e ngjitjes në male);
- Krijimi i një ndërfaqeje online dhe aplikacioni të posaçëm që përmban të gjitha itineraret dhe informacionet përkatëse për secilin prej tyre.


Programi Strategjik OS1PS3: Konsolidimi i pikave kufitare në Koshovicë, Radat dhe Sopik (përmirësimi i portave hyrëse të Bashkisë Dropull dhe lidhjeve strategjike rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare). Për realizimin e këtij objekti do të ndërmeren disa projekte strategjike:

- Rregullimi estetik dhe pejzazhistik i portave kufitare;
- Plotësimi me të gjitha shërbimet përkatëse i pikave kufitare;
- Vendosja e sinjalistikave orientuese.


Programi Strategjik OS1PS4: Krijimi i Terminalit Multimodal Interurban pranë polit Jorgucat. Terminali do të ndërtohet para ish-fabrikës së plastikës, në një sipërfaqe rreth 11,280m².

Terminali duhet të ofrojë këto shërbime:

- Hapësirë për parkim dhe ndalimin e autobusave interurbanë;
- Infrastrukturë lidhëse me Stacionin e Trenit;
- Hapësirë për parkim të përkohshëm të automjeteve personale;
- Hapësirë për parkim afatgjatë;
- Biletari dhe Tabela Elektronike Informuese për udhëtarët;
- Hapësirë dhe Vendndalim për ndërlidhjen mes llojeve të ndryshme të transportit, automjete individuale dhe autobuza të transportit publik lokal dhe ndërqytetas;
- Hapësirë për parkimin e biçikletave;
- Hapësirë për marrjen me qera të biçikletave;
- Hapësirë për tregëtimin dhe ofrimin



Harta e Sistemit Bujqësor




Legjenda

- Park Linear
- Breza Mbrojtëse
- Zona Pyjore
- Zona Shtimi i Pylezimit
- Zona e Mbrojtur
- 🚲 Itinerare lineare/Zona Sport
- Itinerare lidhëse me zonat urbane



Harta e Rezervuareve dhe Itinerareve lidhëse



Manaxhimi i rezeqëve natyrore;

e shërbimeve bazike që lehtësojnë udhëtimin e individëve.

Programi Strategjik OS1PS5: Krijimi i Stacionit të Trenit.

Zgjatimi i hekurudhës edhe në këtë pjesë të Rajonit Jugor është një projekt strategjik i qeverisë Shqipëtare. Në këtë kuadër, dhe duke ndjekur edhe propozimin për implementimin e kësaj infrastrukture edhe nga Bashkia fqinje e Gjirokastrës, është propozuar traseja e kalimit të hekurudhës në territorin e Bashkisë Dropull, shoqëruar me Stacionin Qëndror në afërsi të Peshkëpisë së Poshtme.

Ky Stacion do të ofrojë:

- Hapësirë për ndalimin e trenave;
- Infrastrukturë lidhëse dhe lidhje të shpejtë me Terminalin Multimodal;
- Hapësirë pritëse për pasagjerët;
- Biletari dhe qendër informacioni;
- Hapësirë magazinimi mallrash;
- Hapësirë për marrjen me qera të biçikletave;
- Hapësirë parkimi automjeteve.

Programi Strategjik OS1PS6: Centralitetet e Bashkisë Dropull / Polet: Dervician, Sofratikë, Jorgucat, Vrisera dhe Poliçan.

Duke promovuar zhvillimin policentrik të Bashkisë Dropull, që konsiston me krijimin e disa poleve/ qendrave që do të mirëpresin shërbimet bazë dhe alternative për zhvillimin ekonomik dhe social, territori i Bashkisë shihet i organizuar rreth 5 poleve kryesore, që sigurojnë mbulimin e plotë me të gjitha shërbimet. Përpos ofrimit të shërbimeve bazë si edukim dhe shëndetësi, këto pole shihen të specializuara në drejtime të ndryshme të zhvillimit ekonomik, që përkrijnë dhe me potencialet kryesore të territoreve në të cilat ato bëjnë pjesë, duke siguruar kështu krijimin e një cikli të plotë ekonomik për Bashkinë Dropull. Polet janë si më poshtë:

- Poli Dervician:

Portë Hyrëse për Bashkinë Dropull dhe qendër ofrimi shërbimesh. Bazohet tek zhvillimi i Bujqësisë dhe Turizmit, ku turizmi religjioz dhe agro-turizmi janë dy format kryesore përfaqësuese.

- Poli Sofratikë:

Zonë me rëndësi arkeologjike. Ka një ekonomi që bazohet tek zhvillimi i Bujqësisë dhe Turizmit bazuar tek arkeologjia, besimi fetar dhe ritet përkatëse, dhe agro-turizmi.

- Poli Jorgucat:

Qendër administrative dhe multimodale. Hapësirë pritëse e industrive përpunuese dhe Parkut të Biznesit, i cili sjell një seri aktiviteteve alternative për ekonominë e Bashkisë Dropull. Bujqësia është një tjetër bazë e zhvillimit ekonomik, e cila

shihet edhe si lëndë e parë për industrinë përpunuese. Ky pol mirëpret edhe Tregun Rajonal dhe zhvillimin e agro-turizmit.

- Poli Vrisera:

Portë Hyrëse për Bashkinë Dropull, këtë herë parë në kontekstin e Makro-Rajonit Ndërkufitar me Greqinë. Zonë me karakter bujqësor, që mirëpret gjithashtu përqëndrimin e shërbimeve dhe shkëmbimeve tregëtare. Ky pol shihet në një marrëdhënie të ngushtë me polin e Jorgucatit, ku të gjithë sëbashku janë pjesë e Parkut të Biznesit të Makro-Rajonit Ndërkufitar, duke u lidhur kështu ngushtësisht me Rajonin e Janinës.

- Poli Poliçan:

Ky pol ka një karakter të theksuar malor, ku përpos bujqësisë, blegtoria zë një vend të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik. Potencialet e mëdha natyrore, pejzazhi dhe tradita krijojnë bazat për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit që bazohet në këto potenciale. Turizmi religjioz, agro-turizmi dhe turizmi bazuar në natyrë janë karakteristikat kryesore të zhvillimit të këtij poli. Bimësia medicinale dhe ekonomia bazuar në këtë bimësi përbën një tjetër potencial zhvillimi për zonën.

OS_2: Integrimi në rajonin ekonomik ndërkufitar përmes zhvillimit dhe diversifikimit të ekonomisë lokale

Programi Strategjik OS2PS1: Zhvillimi i Bujqësisë:

1. Studimi dhe rehabilitimi i sistemit të kullimit dhe vaditjes për të gjithë territorin e Bashkisë Dropull:

- Evidentimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të kanaleve;
- Plani i detajuar i Veprimit për zgjerimin, pastrimin dhe rikonstrukcionin e rrjetit;
- Mirëmbajtja e rrjetit.

2. Hartimi i instrumenteve të manaxhimit të tokës për bujqësinë:

Instrumentat e manaxhimit do të orientojnë zhvillimet që nuk i shërbejnë sektorit të bujqësisë, jashtë sipërfaqeve me Kategori Bazë të përdorimit të tokës të propozuar B.Bujqësi, me qëllim mbrojtjen e tokës bujqësore.

Nxitja e rritjes së numrit të fermave bujqësore dhe rritja e madhësisë së fermave nga 1.39ha (mesatarta e Bashkisë Dropull), në 4-5ha/fermë, do të mbështetet me anë të kredimit për pajisje për fermerët, të cilët më pas mund të grupohen dhe krijojnë ferma mbi 4ha.

Nxitja e zhvillimeve të strukturave në funksion të bujqësisë (magazina, stalla, pika grumbullimi, kooperativa bujqësore etj.), përmes shfrytëzimit të aseteve publike dhe private në skema të

partneritetit publik-privat PPP.

3. Tregjet Rajonale dhe Vendore të produkteve:

Në Bashkinë Dropull është parashikuar 1 treg rajonal dhe 3 tregje lokale që i shëbejnë secilës Njësi, për të mundësuar akses dhe tregëtimin e produkteve për të gjithë fermerët vendorë, pavarësisht vendodhjes së tyre, dhe largësisë ndaj tregut të madh rajonal. Tregjet lokale do të kenë gjithashtu lidhje të drejtpërdrejta me fermat e agro-turizmit, duke krijuar një cikël të plotë të produkteve, nga vendi i prodhimit, në ato të tregëtimit dhe konsumit.

- Tregu Rajonal (në Jorgucat në një sipërfaqje prej 4,650m² përballë Terminalit/ Dropull i Sipërm);

- Tregu Lokal 1 (në Dervician përballë fushës së sportit, në një sipërfaqje prej 2,526m²/ Dropull i Poshtëm);

- Tregu Lokal 2 (në Vrisera, duke nisur nga Lapidari deri në fund të rrugës pranë qendrës administrative, në një sipërfaqje rreth 1,670m² / Dropull i Sipërm);

- Tregu Lokal 3 (në Poliçan, pranë fushës së futbollit, në një sipërfaqje prej 1,002m²/ Pogon).

Ndër të tjera, krahas hapësirave për grumbullim, magazinim dhe tregëtim, Tregu Rajonal do të sigurojë edhe:

- Hapësirë edhe për certifikimin dhe kontrollin e cilësisë së produkteve;

- Hapësirë për parkimin e automjeteve të transportit të produkteve;

- Zyrën e informimit mbi produktet vendase;

- Qendrën e informimit mbi fermat kryesore që operojnë në Bashkinë Dropull, për të lehtësuar lidhjen e fermerëve jo vetëm me tregëtuesit, por edhe me industrinë përpunuese industriale dhe artizanale;

- Hapësirën e reklamimit të produkteve alternative që industritë përpunuese prodhojnë me produktet parësore lokale që ofron zona;

- Hapësira alternative sociale si: bare, restorante, vende degustimi etj.

Ndërkohë Tregjet Lokale do të sigurojnë hapësira për tregëtimin e produkteve me pakicë, kryesisht për konsum familjar, ose biznesesh të vogla. Këto tregje do të jenë drejtpërdrejtë të lidhura me fermat dhe pikat kryesore të zhvillimit të agro-turizmit, duke krijuar zinxhirin e plotë të produktit nga toka-tek fermeri-tek konsumatori.

4. Hartimi i Planeve të Pejzazhit për trajtimin e tokave bujqësore

Me qëllim rritjen e atraksionit dhe përmirësimin e imazhit të Bashkisë

Dropull, pejzazhi i pasur dhe i larmishëm që e karakterizon mund të luajë rolin e një katalizatori mjaft të rëndësishëm. Sistemi Bujqësor zë 18.03% (8,308.7ha) të sipërfaqes totale të Bashkisë së Dropullit (45,409.93ha), duke zënë vendin e dytë pas atij Natyror me 78%. Në këto kushte, detyrimisht vjen si kërkesë që kjo sipërfaqe të trajtohet me kujdes dhe prioritet jo vetëm në aspektin ekonomik fitim-prurës, por edhe në atë estetik e pejzazhor.

Kjo qasje e alternuar/ bashkërenduar kultivimi mund të nxisë më tej vlerat e prodhimit dhe të forcojë identitetin lokal. Kultura e pejzazhit mbështetet në konceptin se toka bujqësore e kultivuar, mundet të jetë gjithashtu një pasuri pejzazhore, duke u trajtuar sipas praktikave përkatëse, pa cënuar prodhimtarinë e tokës dhe ciklin e prodhimit. Kjo kulturë promovon përdorimin e të njëjtës sipërfaqje toke në stinë dhe periudha të ndryshme prodhimi, duke kultivuar sipas këtyre periudhave, produkte të ndryshme. Në këtë mënyrë jo vetëm bëhet më eficient prodhimi i të njëjtës sipërfaqje toke, por dhe rritet sasia e prodhimit dhe cikli i prodhimit shtrihet në periudha më të gjata kohore. Kultura e pejzazhit është një proces, i cili kërkon koordinim midis kultivimeve të tokave bujqësore me njëra-tjetrën, nuk kufizon prodhimin, ndërkohë që në fasha të caktuara vendos përdorime të prodhimit duke eficientuar kultivimin e tokës bujqësore.

Programi Strategjik OS2PS2: Zhvillimi i Blegtorisë.

Zhvillimi i blegtorisë për Bashkinë Dropull është po aq me rëndësi sa bujqësia. Ndonëse për arsye të ndryshme, ku më me rëndësi është faktori migrim/emigrim, pra largimi i popullsisë, blegtoria ndër vitë ka pësuar një humbje rëndësie në kontributin e zhvillimit ekonomik, potenciale që ajo ka është mjaft i madh. Rënia e këtij kontributi është matur sipas dy faktorëve kryesorë: (a) ulje e numrit të fermave blegorale (në 94 ferma për vitin 2016) dhe (b) ulje e kontributit në produkte blegtorale që këto ferma japin. Në këto kushte, edhe pse Njësia e Pogonit është zona që përfaqësohet me 50% të totalit të fermave blegtorale, kontributi që kjo Njësi ka në produkte është vetëm 11% e totalit (Njësitë Dropull i Poshtëm dhe Dropull i Sipërm kontribuojnë thuajse në të njëjtin nivel, me rreth 45% të totalit të produkteve blegtorale). Madhësia mesatare e fermave është 122ha/fermë, ku Njësia Pogon ka sipërfaqen më të madhe më 152ha, dhe Njësia Dropull i Poshtëm sipërfaqen më

të vogël me 101ha. Rreth 60% e kullotave janë verore dhe pjesa tjetër dimërore. Vetëm 37% e fermave (përkatesisht në Njësinë Dropull i Sipërm) nuk janë të dhëna me qera dhe punohen nga fermerët pronarë, ndërsa pjesa tjetër janë të tëra të dhënë me kontrata qeraje (përgjithësisht ferma në pronësi publike).

1. Stimulimi i fermerëve (përmes
incentivave) për të rritur numrin e
fermave blegtorale:

- Mbështetje teknike nga Bashkia Dropull dhe partnerë të tjerë të fushës;
- Akses në tregje dhe mundësi për tregëtimin e produkteve blegtorale;
- Integrim i mirë me njësitë e tjera ekonomike (agro-turizmi etj.);
- Krijimi i shoqatave të fermerëve për të lehtësuar ndarjen e informacionit dhe manaxhimin e burimeve.

kullësore:


- Pastrim i kullotave nga gurët dhe shkurret, me qëllim rritjen e hapësirës së përdorshme;
- Pastrim i kullotave nga bimësitë helmuese;
- Përdorimi i plehrave azotike në sasi të vogla për të rritur cilësinë e kullotave.

3. Rritja e kapacitetit kullësorë:

- Kullotja sipas një grafiku të caktuar, që lejon kullotjen e qëndrueshme, duke lënë hapësirat e nevojshme kohore për rigjenerim dhe riprodhim të bimësisë së kullotave.

4. Rritja e shkallës së përdorimit dhe shfrytëzimit të kullotave duke:

- Stimuluar fermerët aktualë dhe ato potencialë (kthim popullsie dhe tërheqje e popullsisë së re banuese përmes incentivave;
- Rritje e numrit të kontratave të qiradhënies;
- Akses më i mirë në tregjet rajonale e lokale, pra interes më i madh në përdorimin



Harta: Objektivi Strategjike 2, Integrimi në Rajonin Ekonomik përmes Zhvillimit dhe Diversifikimit të Ekonomisë Lokale - Zhvillimi i Bujqësisë

e fermave dhe përfitimin ekonomik që ato sjellin.

5. Rehabilitimi i burimeve ujore natyrore dhe shtimi i burimeve ujore të krijuara nga njeriu (lerat) për të plotësuar të gjitha nevojat që fermat kanë, dhe do të kenë në të ardhme.

6. Tregjet Rajonale dhe Lokale

Një komponent shumë i rëndësishëm për të stimuluar rritjen e interesit dhe angazhimin në aktivitetin dhe fermat blegtorale lidhet ngushtë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me kthimin e investimit dhe përfitimin ekonomik. Në këto kushte kjo përkthehet në produkte cilësore dhe akses më të mirë në tregje rajonale dhe lokale.

Qëllimi i Programit Strategjik për Zhvillimin e Blegtorisë është që të stimulojë sa më shumë pjesëmarrjen aktive në këtë aktivitet ekonomik, ndaj është me rëndësi lehtësimi i aksesit të produkteve në Tregun Rajonal të propozuar, si dhe në Tregjet Lokale. Duke qenë se blegtoria

është aktivitet karakteristik veçanërisht për Njësinë e Pogonit, fokusi më i madh do të përqëndrohet në këtë zonë, por jo vetëm. Lidhja e fermerëve me tregjet dhe të gjitha shërbimet që ato ofrojnë (siç u shpjeguan më sipër) do të rrisë mundësinë e futjes së produkteve në tregun lokal dhe atë rajonal, duke i dhënë mundësinë atyre të bëhen pjesë e brand-it lokal të produkteve për zonën e Dropullit, si dhe do të rrisë përfitimin ekonomik të fermerëve dhe Bashkisë.

7. Rritja e vullmit total të prodhimit blegtoral:

Duke ndërmarrë të gjitha këto politika dhe projekte strategjike, synohet të rritet interesi i fermerëve për të punuar dhe mbajtur aktive fermat blegtorale, duke çuar kështu rrejdhisht në rritjen e vullmit total të prodhimit blegtoral.


Programi Strategjik OS2PS3: Kultivimi dhe Përpunimi i Bimëve Medicinale dhe Eterovajore:

Duke veçuar Njësitë Administrative të





Source/ General Local Plan of Dropull Municipality



Harta: Objektivi Strategjik 2, Integrimi në Rajonin Ekonomik përmes Zhvillimit dhe Diversifikimit të Ekonomisë Lokale - Zhvillimi i Blegtorisë

Dropullit të Poshtëm dhe Pogonit për llojin e përshtatshëm të tokës dhe kushteve favorizuese, do të promovohet kultivimi i mëtejshëm i bimëve medicinale dhe eterovajore, duke rritur kështu gamën e përdorimit të tokës në këto Njësi. Edhe pse momentalisht vetëm një total prej 7ha në të dy Njësitë kultivohet me bimë medicinale, mundësitë për të diversifikuar përdorimin janë të mëdha, ndaj Bashkia do të promovojë këtë nismë edhe më tej përmes incentivave dhe metodave të tjera alternative. Në kuadër të këtij programi, në terma kohorë, fillimisht synohet rritja e sipërfaqes së kultivuar dhe më tej ngritja e njësive grumbulluese dhe përpunuese të produkteve, duke ja shtuar ato sasisë së prodhimeve lokale, të cilat do promovohen në tregjet rajonale, kombëtare e ndërkombëtare përmes markës së produkteve të Bashkisë Dropull.

- Shtimi i sipërfaqeve të kultivuara me bimë medicinale dhe eterovajore;
- Krijimi i qendrave grumbulluese (Dropull i

Poshtëm dhe Pogonit);

- Krijimi i qendrës përpunuese të prodhimeve medicinale dhe eterovajore.


Programi Strategjik OS2PS4: Zhvillimi i Turizmit:

Kombinimi i zhvillimit rural që e karakterizon territorin, me peizazhe të rralla dhe habitate natyrore të pasura, me zhvillimin e degëve si bujqësia, blegtoria, kultivimi i bimëve medicinale, por edhe me industrinë përpunuese dhe ofrimin e shërbimeve, bën që turizmi të marrë një zhvillim të plotë 360 gradë dhe gjithëvjetor (pra që shkon përtej një sezoni të vetëm), duke u shndërruar në një promotor të rëndësishëm të vlerave të territorit të Bashkisë Dropull.

Për të përmbushur këtë program strategjik, disa nga projektet strategjike që parashikohen janë:

2. Zhvillimi i itinerareve turistike

Në kontekstin Rajonal krijimi i lidhjes së shpejtë me Portin e Sarandës do të shërbejë gjithashtu edhe si një itinerar



Harta: Objektivi Strategjike 2, Integrimi në Rajonin Ekonomik përmes Zhvillimit dhe Diversifikimit të Ekonomisë Lokale - Kultivimi dhe Përpunimi i Bimëve Medicinale

me karakter turistik duke qenë se synon ndër të tjera integrimin më të mirë të Bashkisë Dropull me Rivierën dhe Bregdetin Jonian, që përbëjnë një nga rajonet më të zhvilluara turistike. Ky itinerar do të përfshijë segmentin rrugor nga Vodhina në Kërrë, për të dalë më pas përmes Livadhjasë drejt Rivierës. Disa nga ndërhyrjet për implementimin e karakterit turistik të këtij itinerari janë:

- Pasurimi i peizazhit ku rruga do të kalojë, duke u shoqëruar me seri pemësh përgjatë saj dhe duke u hapur në ballkone panoramike, aty ku është e mundur;
- Sigurimi i akseve/ degëve të itinerarit, të dedikuara për biçikleta dhe këmbësorë, të cilat jo domosdoshmërisht ndjekin aksin e shpejtë të lëvizjes (që do të realizojë lidhjen me Portin e Sarandës). Gjatë këtyre degëzimeve me karakter turistik do të ketë shërbimet përkatëse, burime uji dhe mini-markete me produktet bazike;
- Lidhja me pikat kryesore të zhvillimit të agro-turizmit, bujtinat pritëse dhe fermat

e bio- produkteve.

Në kontekstin lokal territori i Bashkisë Dropull ka një sërë objektesh dhe zona me interes për zhvillimin e turizmit. Këtu mund të përfshihen: monumente natyrore; monumente kulture; objekte të rëndësishë së veçantë (p.sh. shtëpi me karakteristika të veçanta arkitektonike etj.); objekte kulturi; dhe vende panoramike. Duke i kombinuar këto të fundit dhe me kulturën vendase dhe jetën në fshat, mund të krijohen një sërë itinaresh, të cilat jo vetëm do të nxjerin në pah të gjitha potencialet turistike të zonës së Dropullit, por duke krijuar një rrjet lëvizjeje në territor, do të mundësojnë gjithashtu përmirësimin e aksesibilitetit dhe një lidhje më të mirë midis fshatrave të ndryshëm dhe zonave të atracionit turistik. Ky rrjet lëvizjeje me makina off-road, biçikleta dhe këmbësor është quajtur "sloë line", ose "linja e ngadaltë". Rrjeti ka segmente me tematika të ndryshme itinaresh:

- Itinere Pejzazhore;

- Itinerare të Ujit (përgjatë lumenjve);
- Itinerare Historiko-Kulturore;
- Itinerare të Kultiti;
- Itinerare të Agroturizmit;
- Itinerare të Ujit (përgjatë lumenjve);
- Itinerare me Tematika të Veçanta (sipas kalendarit të eventeve në zonë etj.);
- Itinerare të Përziera (që miksojnë elemente të itinerareve të ndryshme).

Në kuadër të zhvillimit të itinerareve do të ngrihen përgjatë tyre një sërë pikash të vogla shërbimi (me shërbimet bazë), si dhe do të vendosen në dizpozicion guida të posaçme (të printuara dhe në version elektronik) që japin informacion mbi të gjitha objektet dhe eventet me interes përgjatë itinerareve.

Banorë nga zona do të trajnohen në mënyrë të veçantë për të shërbyer si guida përgjatë itinerareve (ku synim do të jenë sidomos të rinjtë). Trajnime të veçanta do të bëhen edhe me banorët e tjerë (kryesisht të moshat e mesme dhe të moshuarit) në mënyrë që në bujtina, shtëpi pritëse, ferma, apo ndalesa të tjera të itinerareve, të dinë se si të sillen dhe presin turistat. Këto trajnime do të shërbejnë gjithashtu edhe për të rritur ndërgjegjësimin ndaj rëndësisë dhe përfitimeve që turizmi mund të sjellë.

3. Agro-turizmi

Zhvillimi i Agro-turizmit është një tjetër prioritet në kudër të zhvillimit të turizmit në tërësi në Bashkinë Dropull. Duke kombinuar mjaft nga potencialet që zona ofron (pejzazhin, produktet vendase, mikpritjen e banorëve etj.), kjo formë e turizmit i jep sidomos popullsisë vendase dhe banorëve mundësinë të jenë pjesë e drejtpërdrejtë e të gjitha shërbimeve dhe aktiviteteve që ofrohen. Kjo jo vetëm rrit përgjegjësinë dhe pjesëmarrjen, por dhe ndjenjën e përkatësisë dhe interesin për t'i zhvilluar gjërat më tej. Për sa i përket eksperiencës dhe përfitimeve të turistëve, ata do të kenë mundësinë të shohin dhe njohin nga afër aktivitetet kryesore ekonomike të zonës; të shijojnë produktet vendase, madje të kenë mundësinë t'i mbledhin, ose kultivojnë vetë ato; të njohin nga afër popullsinë vendase dhe kulturën e tyre; të jenë më tej promotorë të kulturës dhe traditës së Bashkisë Dropull, etj.

Fermat bujqësore, ose blegtorale do të përdorin potencialin që kanë për t'u shndërruar në atraksione turistike, duke ofruar shërbime alternative, si ofrimi i akomodimit, njohja me kafshët dhe format e përkujdesjes ndaj tyre, mbledhja dhe shijimi i produkteve, njohja me ciklin e produkteve etj.

Bashkia do të kujdeset të krijojë një frymë që mirëpret aktivitetin e fermave

bujqësore, duke:

- Hartuar një rregullore të veçantë mbi tipologjitë e fermave agroturistike (madhësia, sasia e kafshëve/ prodhimeve ose produkteve, vendet e akomodimit, lloji i strukturave etj.);
- Ofruar asistencë në ndërlidhjen e fermerëve me burime të ndryshme financimi për mbeshtjetjen e zhvillimit të agroturizmit (mikro-kredi ndërmjet lidhjes me Ministrinë e Bujqësisë, mundësi lidhjesh partneriteti mes investorëve dhe firmave private dhe fermerëve lokalë etj.);
- Ofruar infrastrukturën ndihmëse në funksion të agroturizmit (itinerare turistike, transporti alternativ, brandimi dhe promovimi i produkteve lokale nën një emër që përfaqëson të tërë zonën e Dropullit etj.).


4. Zhvillimi i Turizmit Malor dhe Eko-turizmit

Turizmi malor dhe eko-turizmi janë dy nga format më potenciale, të zhvillimit të turizmit në territorin e Bashkisë Dropull. Pejzazhi mjaft i pasur, ku ndër të tjera ka një larmishmëri që sjell si fushat dhe luginat përgjatë rrjedhës së lumenjve, por edhe majat e thepisura të maleve, krijon mundësi pa fund për zhvillimin e turizmit bazuar në këto potenciale. Sidomos zona e Pogonit është një territor ende i pa-transformuar në një pjesë të mirë të tij, dhe me mjaft mundësi për shfrytëzimin e natyrës së virgjër për zhvillimin e turizmit bazuar natyra.


Në këto kushte është e domosdoshme mbështetja me infrastrukturën e nevojshme: evidentimi dhe markimi i shtigjeve kryesore, pajisja me shërbimet bazë, ngritja e bujtinave dhe shtëpive pritëse, përgatitja e guidave të posaçme dhe aktiviteteve në natyrë, trajnimi i popullsisë etj.

5. "Wayfinding"

Bashkia do të hartojë një manual për mënyrat e trajtimit të llojeve të ndryshme të infrastrukturave rrugore, në varësi të karakterit dhe përdorimit të tyre, për të themeluar kështu një traditë dhe sistem që lidh karakterin e zonës me një formë specifike të ndërhyrjes në të, duke vendosur disa kritere dhe standarte bazë. Për të lehtësuar lëvizjen sidomos me biçikletë dhe në këmbë, do të hartohet një program specifik për planifikimin e shenjave drejtuese në të gjithë territorin e Bashkisë, sidomos në ato zona ku parashikohet të kalojnë itineraret turistike. Jo vetëm shenjat dhe sinjalistika në territor, por dhe harta të printuara dhe në version elektronik, do të prodhohen dhe shpërndahen për të lehtësuar lëvizjen e



Harta: Seksionet e Prerjeve të Segmenteve Rrugore



Skema: shërbimet publike, transporti publik

banorëve dhe turistëve. Të gjitha këto do të jenë në sinton me elementët e dizajnit të prodhuar për brandimin dhe marketimin e Bashkisë Dropull, duke krijuar një paketë të plotë unike dhe tërheqëse.

6. Ndërfaqe online dhe Aplikacionet Elektronike

Që strategjia e zhvillimit të turizmit të funksionojë plotësisht është e nevojshme që të promovohet dhe ndahet me këdo. Për këtë arsye do të krijohen: një ndërfaqeje online, një aplikacion i posaçëm, dhe produkteve të tjera si harta, broshura etj. Këto materiale do të informojnë këdo mbi të gjitha detajet e nevojshme në lidhje me zhvillimin e turizmit në territorin e Bashkisë Dropull (atraksione, itinerare, evente, akomodim, shërbime etj.).

Programi Strategjik OS2PS5: Zhvillimi i Biznesit dhe Industrisë Përpunuese (mbështetja e sipërmarrjeve të reja, lidhja me fermerët vendas etj.).

Diversifikimi i aktiviteteve ekonomike në Bashkinë Dropull është një prioritet me mjaft rëndësi. Sidomos kur bëhet fjalë për nxitjen e zhvillimit të biznesit dhe industrisë përpunuese, që edhe momentalisht shihen të kenë një zhvillim të konsiderueshëm. Bashkia Dropull do të sigurojë hapësirë dhe mundësi për rritjen e numri të këtyre njësive ekonomike, duke krijuar veçanërisht një rrjet marrëdhëniesh të ngushta mes fermerëve lokal bujqësorë e blegtoralë, me njësitë e industrive përpunuese dhe ato të biznesit. Kjo lidhje jo vetëm do të rriste efikasitetin dhe impaktin real ekonomik dhe përfitues të prezencës së këtyre njësive ekonomike në territorin e Bashkisë Dropull, por do të përbëjë gjithashtu një burim të sigurtë punësimi për banorët vendas.

Prania e bizneseve dhe Industrive përpunuese do të mundësohet që të akomodohet në ato pjesë të territorit që sigurojnë akses të mirë dhe të shpejtë në infrastrukturën kryesore ndihmëse (rrugë kryesore strategjike, tregje etj.), por pa impaktuar negativisht në mjedis dhe pa prishur ekuilibrat e habitateve natyrore të zonave përreth. Këto njësi do të nxiten gjithashtu të bëjnë investime në infrastrukturën lokale dhe përmirësimin e shërbimeve, në kuadër të bashkëpunimit që do të kenë me Bashkinë Dropull (incentivat e alokimit, akomodimit etj.).

Do të krijohet gjithashtu një fond i përcaktuar për të mbështetur nismat e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përmes të cilit Bashkia do të mund të mbështesë veçanërisht sipërmarrjet e vogla që hapen për herë të parë, të cilat operojnë në fushat parësore të ekonomisë lokale dhe lidhen me objektivat e Vizionit

të Zhvillimit Hapësinor. Këtu përmendim ndërmarrje, të cilat fokusohen në ofrimin e shërbimeve turistike (jo-hoteleri), në fushën e bujqësisë e blegtorisë, dhe në shërbime të tjera të lidhura me ekonominë inovative që shfrytëzon potencialin vendas. Çdo vit Bashkia do të organizojë një thirrje për ide të reja për krijimin e sipërmarrjeve, dhe përmes aplikimeve individë ose grupe individësh mund të aplikojnë dhe konkurojnë për financim. Përzgjedhja do të bëhet në bazë të kreativitetit, aplikueshmërisë në realitet, dobishmërisë dhe përftitimeve, si dhe studimit të fizibilitetit dhe tregut. Kjo iniciativë lidhet ngushtë edhe me operimin dhe funksionimin e "Parkut të Zhvillimit" që do të shpjegohet në programin strategjik pasues.

Programi Strategjik OS2PS6: Krijimi i "Parkut të Zhvillimit".

Në vazhdimësi të programit strategjik për diversifikimin e ekonomisë lokale, si dhe mbështetjes së krijimit të ciklit të plotë ekonomik (prodhim – përpunim – tregëtim), propozohet gjithashtu krijimi i një zone me karakter të theksuar edukativ, eksplorues dhe zhvillues. Kjo zonë nën emrin "Parku i Zhvillimit" do të sigurojë hapësirë për edukim të specializuar (shkolla dhe kurse profesionale), kërkim, testim dhe ngritjen e sipërmarrjeve, ku të gjitha sëbashku do të kenë si qëllim integrimin e popullsisë vendase dhe promovimin e prodhimeve lokale. E vendosur pranë zonës ndërkufitare, midis Kakavijës e Vrisesasë, kjo zonë do të synojë të shndërrojë Luginën e Drinosit në një luginë zhvillimi e progresi dhe do të jetë një urë lidhëse midis dy qendrave Gjirokastër e Janinë dhe zonave ekonomike përreth tyre, duke shërbyer si një hapësirë e përbashkët kërkimi e zhvillimi, për një ekonomi sa më të integruar e të qëndrueshme.

"Parku i Zhvillimit" do të sigurojë hapësira për:

- Start Up-e dhe sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- Qendra të trajnimit dhe edukimit të specializuar sipas degëve kryesore ekonomike të zonës: turizëm, bujqësi, blegtori, shërbime, përpunim etj.;
- Zyra të këshillimit për karrierën;
- Kërkim mbi produktet vendase, ciklin dhe procesin e prodhimit etj.;
- Testimi dhe kontroll të cilësisë së produkteve;
- Qendër informimi mbi shërbimet që ofron "Parku i Zhvillimit".

Programi Strategjik OS2PS7: Ngritja e kapaciteteve institucionale dhe financiare në dobi të hartimit të Projekteve të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA.



Bashkia Dropull bën pjesë në makro-rajonin ndërkufitar Shqipëri – Greqi, ku e gjendur mes dy qendrave rajonale Gjirokastrë dhe Janinë, ka mundësi të përfitojë dhe shfrytëzojë mjaft nga potencialet që ky rajon ofron. Edhe pse për Bashki të vogla si ajo e Dropullit (ku të ardhurat janë të limituara), bashkë-financimi i projekteve IPA mund të mbarti kosto të mëdha, shihet me mjaft rëndësi ngritja e kapaciteteve lokale për aftësim mbi vlerësimin e projekteve të mundshme të bashkëpunimit ndërkufitar, dhe më tej brenda parashikimeve financiare përkatëse, hartimin e tyre.

Programi “Greqi- Shqipëri 2014-2020” që synon të përmirësojë cilësinë e jetesës në rajonet kufitare Greqi- Shqipëri duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm lokal, është një mundësi shumë e mirë që Bashkia Dropull dhe njësitë e tjera fqinje përtej kufirit mund të përdorin për të hartuar programe të përbashkëta zhvillimi. Programi mbulon 11 njësi rajonale kufitare në Greqi dhe 4 në territorin Shqipëtar, dhe ka një vlerë rreth 42 million Euro, me një kontribut rreth 36 milion Euro nga Bashkimi Europian, përmes instrumentit të Asistencës së Para-Aderemit, IPA.

Disa nga hapat përgatitorë për këtë program janë:

- Të vendosen marrëdhënie shumë të mira me njësitë fqinje (brenda dhe jashtë vendit);
- Të njihet mirë territori ndërkufitar, pikat e dobëta dhe potencialet e tij, dhe më pas të punohet mbi bazën e tyre;
- Të realizohet trajnimi dhe përgatitja e stafit të Bashkisë, në mënyrë që të jenë të aftë të evidentojnë, hartojnë, prezantojnë dhe implementojnë projektet të këtij karakteri;
- Të zhvillohen takime informimi të vazhdueshme midis autoriteteve të njëjësive bashkëpunuese.

Programi Strategjik OS2PS8: Ngritja e kapaciteteve lokale.

Për të garantuar zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë Dropull, dhe ofrimin sa më cilësor të shërbimeve, është tejet e nevojshme që të punohet për ngritjen e kapaciteteve lokale, ku përfshihen administrata vendore dhe komuniteti. Në këtë aspekt janë identifikuar 5 fusha prioritare:

- Planifikim dhe Menaxhim Teritori;
- Trajtimi i Çështjeve Sociale (duke përfshirë aspekte të barazisë gjinore);
- Zhvillim Rural dhe Menaxhim Pyjesh;
- Turizëm dhe Guida Turistike;
- Menaxhim i Rreziqeve Natyrore.

Përsa i përket planifikimit dhe menaxhimit të territorit, trajnimet mund të konsistojnë

në:

- Hartim politikash zhvillimi;
- Përdorimi i instrumentave të drejtimit të zhvillimit;
- Përdorim i GIS dhe Regjistrat të Territorit;
- Menaxhim Projektesh;
- Rregulla të përdorimit të tokës.

Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve lokale do të kryhet me anë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione arsmiore, Agjenci dhe Organizata, të cilat operojnë në Bashkinë Dropull dhe Rajonin e Gjirokastrës, sipas tematikave të mësipërme.

Programi Strategjik OS2PS9: Brandimi dhe promovimi i Bashkisë Dropull.

Bashkia Dropull në bashkëpunim me aktorë të përzgjedhur nga shoqëria civile, akademia, instancat shtetërore dhe subjekte private, mund të bashkëpunojnë sëbashku për të krijuar një PPP (Partneritet Publik Privat) me qëllim krijimin e një “marke”, e cila përfaqëson produktet më të mira vendase. Më tej ky partneritet mund të krijojë një fond të veçantë dhe të merret me promovimin dhe marketimin e produkteve vendase në tregjet kombëtare e ndërkombëtare. Krijimi i një logoje që garanton sigurinë e cilësisë së produkteve është një hap shumë i rëndësishëm, jo vetëm për të rritur aksesueshmërinë e produkteve në tregje të ndryshme, por edhe për të promovuar identitetin dhe vlerat e Bashkisë Dropull.

Pjesë e programit strategjik të Bashkisë Dropull është dhe promovimi i vlerave lokale përsa i përket objekteve dhe zonave kryesore të atraksionit turistik. Këto, të lidhura me historinë, kulturën, prodhimet lokale dhe shërbimet kryesore të ofruara në territorin e Bashkisë, përbëjnë një kompleks mjaft të pasur për t’i dhënë jetë brandimit të Bashkisë Dropull si një destinacion rëndësishëm që nuk duhet humbur. Të gjithë këto elementë më pas mund të përkthehen në harta tematike, tabela sinjalistike, apo edhe elemente të dizajnit të hapësirave dhe objekteve të ndryshme. OS_3: Ruajtja e karakterit rural të vendbanimeve dhe përmirësimi i cilësisë dhe kushteve të jetesës

Programi Strategjik OS3PS1: Rikualifikimi i banesave të braktisura/ rrënura dhe futja e tyre në tregun e strehimit.

Programi Strategjik OS3PS2: Restaurimi i banesave/ objekteve historike (kishave etj.) dhe bërja e tyre pjesë në programet turistike.

- Për të dy Programet Strategjike të mësipërme:

Për shkak të lëvizjeve migratore dhe më së shumti emigratore, një pjesë e



konsiderueshme e popullsisë së Bashkisë Dropull për momentin ndodhet jashtë. Kjo bën që një pjesë e banesave të banohen përkohësisht, vetëm gjatë verës, ose gjatë fundjavave (rreth 1,685 banesa), ndërsa një pjesë tjetër të jetë totalisht e braktisur, ose e pabanuar (rreth 501 banesa). Pjesa më e madhe e këtyre banesave të braktisura (ndërtuar rreth viteve '20të-'30të, por edhe më të vjetra), edhe pse përfaqësojnë banesat më të bukura të zonës së Dropullit, me stil, motive dhe detaje të veçanta arkitektonike, duke qenë se janë lënë në braktisje, pas asnjë përkujdesje, janë thuajse në rrënim dhe në kushte të mjerueshme.

Për të shpëtuar këtë pasuri historike e kulturore të Bashkisë Dropull, Bashkia do të krijojë një platformë, në të cilën do të identifikojë dhe regjistrojë të gjitha këto banesa, duke përshkruar karakteristikat e secilës, si dhe do të krijojë gjithashtu një fond të posaçëm për të siguruar restaurimin dhe rikualifikimin e tyre. Sipas karakteristikave, një pjesë e tyre mund të rifuten më pas në tregun e banesave, disa të tjera që mund të jenë edhe banesat më të veçanta mund të shndërrohen në Shtëpi Muze e Muze Etnografik, apo hapësira artistike të dedikuara ekspozitave të ndryshme. Disa prej banesave mund të rikonceptohen dhe të mobilohen me interior dhe funksione në stilin origjinal, për t'u shndërruar në bujtina, ose shtëpi pritëse, duke kirjuar për pushuesit ndjesinë e të ndjerit vërtetë në zonën e Dropullit, e duke u përballur me traditën, kulturën, zakonet dhe mënyrën vendase të të jetuarit.

Bashkia e Dropullit ka gjithashtu një sërë objekte të rëndësishme të veçantë në formën e Monumenteve të Kulturës. Veçanërisht objekte kulti (kisha dhe manastire) ka një total prej 18 njësish, të cilat mbartin vlera të veçanta përsa i përket vjetërsisë së tyre dhe detajeve në ornamented he afreske. Të lëna në harresë dhe një pjesë të izoluara në zona të vështira për t'u aksesuar, këto objekte janë në kushte emergjente për ndërhyrje, ndaj iniciativa për t'i restauruar ato, jo vetëm do të ndihmonte në shpëtimin e tyre dhe përmirësimin e kushteve fizike, por dhe do të rriste dobishmërinë e tyre në terma ekonomikë, duke i bërë ato pjesë të itinerareve turistike.

Programi Strategjik OS3PS3: Rikualifikimi i hapësirave publike (qendrat e fshatrave) dhe aplikimi i praktikave të dizajnit urban për të rritur sigurinë dhe cilësinë e hapësirave publike.

Zonat e Dropullit, ashtu si dhe shumë zona të tjera rurale të vendit, ka një kulturë të

të organizuarit të jetës së komunitetit nëpër të ashtu-quajturat qendrat e fshatrave, të cilat në shumicën e rasteve konsistojnë në hapësira publike rreth një rrapi, ose peme tjetër karakteristike, apo një kishe, ose burimi ujor (çezme etj.). Në këtë aspekt, thuajse të gjithë fshatrat e Bashkisë Dropull kanë hapësira të tilla, të cilat janë një potencial shumë i madh përse i përket ndërhyrjeve që synojnë krijimin e identitetit të fshatrave dhe ri-organizimit të jetës sociale në hapësirat publike. Edhe pse shumë pak prej këtyre fshatrave kanë hapësira të dizenuara me të gjithë elementët e nevojshëm, prania e elementëve natyrorë që përbëjnë bazën dhe gjenezën e këtyre hapësirave, krijon mjaft lehtësi për përmirësime të mëtejshme.

Në këto kushte për të gjithë fshatrat do të punohet me qendrat e tyre dhe hapësirat kryesore publike, për të aplikuar metodat e dizajnit me elementët përkatës të mobilimit të hapësirave publike, për të rritur jo vetëm cilësinë e tyre, por mbi të gjitha për të rritur sigurinë dhe për të krijuar një identitet të veçantë për çdo fshat. Mobilimi do të konsistojë në:

- Rigjenerimin dhe vënien në mbrotje të elementëve kryesorë hapësirë-formues si pemë, burime ujore, kisha, ose objekte të tjera të veçanta;
- Pajisjen me ndriçim;
- Pasjjsjen me stola dhe elemente të tjera ulëse;
- Shtimin e gjelbërimit dhe bimësisë që krijon kushte për hijëzim, ngjyra dhe aroma të ndryshme sipas stinëve;
- Përdorimi i infrastrukturës së gjelbër si drenazhim natyror për reshjet;
- Shtimi i rrugëve lidhëse këmbësore dhe integrimi me rrjetet kryesore të levizjes;
- Integrimi i terreneve sportive, aty ku është e mundur;
- Integrimi i parqeve lokale dhe zonave me atraksion turistik që ndodhen në afërsi të zonave të banuara;
- Përdorimi i materialeve lokale për krijimin e elementëve të mobilitetit të hapësirave;
- Plotësimi me tabela dhe objekte të tjera informimi;
- Implementimi në afërsi të këtyre hapësirave, i shërbimeve të tjera plotësuese si ushqimore, bar, shtëpi kulture etj.

Lidhja e këtyre hapësirave kryesore publike me rrjetin infrastrukturor (fast line dhe sloë line) dhe të aksesit është gjithashtu një prioritet, ashtu siç është dhe integrimi i tyre në itineraret dhe guidat kryesore turistike. Pjesë e integruar e këtij Programi Strategjik është dhe rikualifikimi i banesave të rrënuara dhe në kushte jo të mira (që lidhet me dy PS të mëparshme),

Existing



Existing



Proposal



Proposal



Tregu Rajonal Jorgucat

Rrugë në Pogon / Hllomo

Existing



Existing



Proposal



Proposal



Terminali Dropull

Lëmi / Sheshi Publik

Existing



Proposal







Source/ Dropull Municipality

si dhe plotësimi me shërbimet kryesore të nevojshme.

Programi Strategjik OS3PS4: Ngritja e Qendrave Sociale (sigurimi i shërbimeve dhe përkrahjes ndaj popullsisë në nevojë, sidomos moshës së tretë).

Sipast të dhënave të gjeneruara në Bashkinë Dropull grupet në nevojë (të papunë, të pastrehë dhe grupe me probleme sociale) nuk përbëjnë një zë në totalin e popullsisë, por brenda kësaj kategorie, duke marrë për bazë karakteristikat e popullsisë lokale, janë konsideruar moshë e tretë, duke qenë se përbëjnë 16% të totalit. Pjesa tjetër e popullsisë përbëhet nga 4% të moshës 0-15 vjeç, dhe 81% të moshës 15-64 vjeç, të cilët përbëjnë dhe popullsinë më aktive përse i përket lëvizjeve migratore në territorin fqinj. Kjo bën që një pjesë e tyre të kthehen në Dropull gjatë sezoneve të caktuara (verë, ose dimër), ose gjatë fundjavave. Rrjedhimisht në këto kushte, popullsia që është banuese gjithëvjetore e Bashkisë Dropull, është më shumti ajo e moshës së tretë, e cila shpesh gjendet e vetme përball problematikave të ndryshme ditore.

Për këtë arsye, sëpari do të bëhet identifikimi në një platformë i të gjithë individëve dhe nevojave specifike që ato kanë. Më tej do të ngrihet një qendër e specializuar, e cila do të vërë në përdorim këtë platformë, duke aktivizuar programe të ndryshme për këtë grup të popullsisë. Programet do të asistojnë në mbajtjen në kontroll të vazhdueshëm të këtij grupi, për t'u siguruar që ato marin shërbimet e nevojshme në kohën dhe vendin e duhur, sidomos marjen e shërbimit shëndetësor. Platforma do të asistojë këtë grup popullsie edhe përse i përket manaxhimit të aseteve ekonomike që ato posedojnë (tokë bujqësore, ferma blegtorale etj.) në rast se ato nuk kanë kapacitetet dhe kushtet për t'i manaxhuar ato. Platforma nuk do të ketë përgjegjësi operacionale në këtë fushë, por vetëm funksion ndërlidhës dhe ndërmjetësues, midis këtij grupi të popullsisë dhe grupeve të tjera, të cilat mund të marin role specifike (qira-marrës, blerës potencialë, familjarë të tjerë që mund të marin përgjegjësi, etj.).

Programi Strategjik OS3PS5: Unifikimi në stil dhe materiale ndërtimi (përdorimi i materialit vendas, gurit).

Për plotësimin e këtij Programi Strategjik Bashkia Dropull do të dakortësojë për vendosjen e një seti rregullash ndërtimi (të cilat do të detajohen në dokumentin e Rregullores), që konsistojnë në unifikimin e tipologjive të ndërtimit dhe materialeve të

aplikuara, në mënyrë që të ruhet karakteri lokal i banesave tradicionale me gurë dhe drurë. Ky set rregullash do të jetë në formën e një manuali që jep informacione dhe udhëzime, pa u kthyer në një mjet detyrimi. Në këtë mënyrë banorët do të kenë mundësinë të informohen për karakterin që duhet të ketë banesa, dhe tipologjitë e ndryshme të materialeve, pa u kushtëzuar në çdo detaj ndërhyrjeje. Kjo do të kontribuojë në vendosjen e një rregulli të përgjithshëm, i cili lejon hapësirë të mjaftueshme edhe për individualizimin e ndërhyrjeve.

Praktika e sipër-përmendur vë në përdorim materialet lokale, krijon identitet dhe i përshtatet kushteve të territorit, traditës dhe kulturës vendase. Ndër të tjera, vetë banorët e kanë aplikuar këtë praktikë tashmë prej disa vitesh në mirëkuptim midis tyre.

Programi Strategjik OS3PS6: Plotësimi me shërbime publike: arsim dhe shëndetësi.

1. Shërbimi Shëndetësor

Në Bashkinë Dropull momentalisht ofrojnë shërbim shëndetësor vetëm 3 Qendra Shëndetësore (1 në Sofratikë, 1 në Vrisera dhe 1 në Poliçan), dhe 11 Ambulanca (8 në Njësinë Dropull i Poshtëm: Dervician, Sofratikë, Vanister, Frashtan, Lugar, Grapsh, Goranxi dhe Terihat; dhe 3 në Njësinë Dropull i Sipërm: Jergucat, Bularat, Vrisera). Në njësitë e sipër-përmendura gjendja e strukturave është e mirë, ndërkohë që në fshatra të tjerë si: Haskovë, Dhuvjan, Glinë, Peshkëpi e Poshtme (Dropull i Poshtëm); Zervat, Bodrishtë, Sotirë, Llongo, Pepel, Kërrë, Vodhinë, Klishar, Selo, Koshovicë (Dropull i Sipërm); Poliçan, Skore (Pogon), ekzistojnë ende godinat ku dikur ofrohej shërbimi i qendrave shëndetësore, por tashmë ato nuk funksionojnë më dhe kanë nevojë për restaurim dhe ri-vënie në funksion.

Shpërndarja e shërbimit në terma "njësisë që ofrojnë shërbimin" momentalisht është e mirë, duke marrë parasysh shpërndarjen e popullsisë në territor. Me projeksionimin e shtimit të popullsisë gjatë 15 vjeçarit të ardhshëm planifikohet restaurimi dhe ri-vënia në punë e njësive që momentalisht janë jashtë funksionit. Ndërkohë ka mjaft nevojë për përmirësim të mirëfilltë të gjendjes fizike të strukturave të këtyre njësive të ofrimit të shërbimit, shtim të aparaturave, si dhe shtim kapaciteti shërbimi si mjekë, infermierë etj., (duke qenë se popullsia e moshës së tretë përbën një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së Bashkisë Dropull).

Gjithashtu do ti kushtohet vëmendje sidomos përmirësimit të shërbimit përmes

agjentëve që mund të lëvizin lehtësisht në territor për të asistuar situatat emergjente dhe do të bëhet pajisja me makina të përshtatshme për terren të thyer malor. Për lehtësi aksesit dhe dhënieje shërbimi eficient, me përmirësimin e këtyre kushteve, do të integrohen dhe shërbime të tjera plotësuese, si shërbimi farmaceutik dhe veçanërisht i kujdesit ndaj moshës së tretë.

2. Shërbimi Arsimit

Ofrimi i Shërbimit Arsimit në Bashkinë Dropull bëhet në 3 nivele të ndryshme: arsim parashkollor (Kopshte), arsim 9-vjeçar dhe arsim i mesëm. Në këto kushte në territor operojnë:

- 1 Kopsht Privat në Dervician;
- 3 Kopshte Publike / të integruara pranë Shkollave 9-vjeçare (2 në Njësinë Dropull i Poshtëm: Dervician dhe Goranxi; dhe 1 në Njësinë Dropull i Sipërm: Jorgucat);

- 3 Shkolla 9-vjeçare (1 në Njësinë Dropull i Poshtëm: Dervician; dhe 2 në Njësinë Dropull i Sipërm: Bularat dhe Jorgucat). Ndërkohë ka dhe 7 Shkolla të tjera 9-vjeçare të shpërndara në Njësinë Dropull i Sipërm dhe Dropull i Poshtëm, të cilat nuk ofrojnë shërbim;

- 2 Shkolla të Mesme (1 në Njësinë Dropull i Poshtëm: Dervician; dhe 1 në Njësinë Dropull i Sipërm: Bularat).

Edhe pse numrat shfaqen si më sipër, përse i përket njërive që ofrojnë shërbimin arsimor në Bashkinë Dropull, për arsye të mungesës së nxënësve një pjesë e tyre këtë vit janë jashtë funksionit (p.sh. shkollat 9-vjeçare në fshatrat Bularat dhe Goranxi). Ndërkohë godina ekzistuese që diku ofronin shërbimin arsimor si shkolla 9-vjeçare ka edhe në fshatrat: Sofratikë, Frashtan dhe Peshkëpi e Poshtme (Dropull i Poshtëm); Vrisera, Bodrishtë dhe Zervat (Dropull i Sipërm); dhe Poliçan (Pogon). Një tjetër shkollë e mesme që dikur funksiononte ekziston edhe në Llongo (Dropull i Sipërm).

Të gjitha këto struktura sot janë jashtë funksionit për arsye të mungesës së nxënësve dhe nevojës për restaurim dhe plotësim kushtesh. Në fshatin Skore shkolla 9-vjeçare është restauruar nga vetë banorët, por për arsye të mungesës së nxënësve ajo sërish është jashtë funksionit.

- Në këto kushte fillimisht do të realizohet plotësimi me të gjitha kushtet e nevojshme (klasa funksionale me të gjitha hapësirat e nevojshme, laboratore, biblioteka, hapësira sportive, sistem ngrohje-ftohje etj.) të njësive që momentalisht janë funksionale dhe në shërbim të sistemit arsimor.

- Së dyti do të bëhet restaurimi dhe vënie në funksion e shkollave që momentalisht nuk ofrojnë shërbim: Goranxi, Peshkëpi e Poshtme, Vrisera, Bularat, Llongo dhe Poliçan.

Programi Strategjik mbi arsimin parashikon edhe hapjen e disa kurseve profesionale që lidhen me degë si bujqësia, blegtoria dhe turizmi, për të gjithë ata që duan të marrin edukim profesional në lidhje me degët specifike të punësimit. Akomodimi i hapësirës së nevojshme për klasat mësimore të këtyre kurseve do të realizohet fillimisht pranë shkollave ekzistuese dhe atyre që do të restaurohen, dhe më pas do të zhvendosen pranë Parkut të Biznesit, në hapësirën për kërkim dhe edukim.


Programi Strategjik OS3PS7: Plotësimi me shërbime publike: transporti publik:

Momentalisht në Bashkinë Dropull operon vetëm 1 linjë e transportit publik rrethqytetas, që ofrohet dhe manaxhohet nga Bashkia, linja Poliçan- Zagori- Gjirrokastër, me frekuencë dy herë në javë. Nevojat e tjera për transportin publik mbulohen nga 4 operatorët tjetër privatë, të cilët mbulojnë linjat Sofratikë- Gjirrokastër, Llongo- Gjirrokastër, Kakavijë- Gjirrokastër dhe Llongo- Peshkëpi, me një 2 herë në javë. Në këto kushte synohet përmirësimi i transportit publik rrethqytetas, si dhe ai lokal që ofron shërbimin në territorin e Bashkisë Dropull, për të lehtësuar lidhjen e individëve me vendet e banimit dhe ato të punësimit. Përmirësimi do të konsistojë në shtim linjash, automjeteve, si dhe rritje e frekuencës së orareve të shërbimit. Shërbimi do të mbulojë të gjithë territorin, qoftë për banorët, ashtu edhe për turistët në kuadër të zhvillimit të turizmit. Do të aplikohet gjithashtu bileta e shërbimit të transportit publik, e cila të jetë unike dhe do të ndahet në frekuenca kohore të ndryshme: 1 orëshe, 3 orëshe, ditore, 3-ditore, javore dhe abone mujore.

Përmirësimi i këtij shërbimi mer në konsideratë gjithashtu 3 linja të veçanta që do t'u shërbejnë nxënësve dhe mësuesve, për ofruar në mënyrë të plotë dhe eficientë, si dhe për të stimuluar më tej rritjen e frekuentimit të shërbimit arsimor. Një linjë do të shërbejë për Njësinë e Pogonit, dhe dy linja të tjera në Njësitë Dropull i Sipërm dhe Dropull i Poshtëm.

Programi Strategjik OS3PS9: Rehabilitimi dhe shtrirja e plotë e rrjetit të kanalizimeve dhe ujësjellësit.

Deri në vitin 2031 planifikohet që Bashkia Dropull të plotësojë të gjitha nevojat për përmirësimin dhe shtrirjen e mëtejshme të rrjetit KUB dhe KUZ. Për këtë qëllim



Harta: Objektivi Strategjike 2, Integrimi në Rajonin Ekonomik përmes Zhvillimit dhe Diversifikimit të Ekonomisë Lokale - Zhvillimi i Turizmit



Source/ General Local Plan of Dropull Municipality, E. Janku



Source/ General Local Plan of Dropull Municipality, B.Qaja



Source/ General Local Plan of Dropull Municipality, E. Janku

do të vihen në përdorim të gjitha kushtet favorizuese dhe burimet natyrore të zonës, pa kompromentuar ekzistencën, cilësinë dhe rigjenerimin e tyre. Aty ku është e mundur do të aplikohet gjithashtu teknologji sa më miqësore ndaj mjedisit, kryesisht me qëllimin e ndarjes së ujërave të bardha nga ato të zezat, si dhe do të aplikohet ripërdorimi i ujërave të reshjeve (kryesisht për ri-përdorim në bujqësi dhe blegtori, por jo vetëm). Do të ndalohet derdha e ujërave të zeza në burimet ujore (lumenj, rezervuare, ose pellgje ujëmbledhëse).

Do të vendoset gjithahstu në mbrojtje dhe do të rehabilitohet ujësjellësi historik i Selckës, që mbart mjaft vlera për zonën e Pogonit.

OS_4: Mbrojtja e pejzazhit, habitateve natyrore dhe mobilizimi ndaj emergjencave

Programi Strategjik OS4PS1: Mobilizimi për mbrojtjen ndaj zjarreve.

Një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballlet Bashkia Dropull lidhet me numrin e madh të zjarreve që bien gjatë stinës së verës. Territore natyrore dhe zona të banuara rrezikohen në mënyrë të vazhdueshme nga zjarret që bien si rrjedhojë e temperaturave të larta dhe thatësirave ekstreme.

Marja e masave për mbrojtjen ndaj zjarreve konsiston në një seri ndërhyrjesh që kanë si qëllim të parandalojnë vënien e zjarreve, por dhe të manaxhojnë situata emergjencash në raste zjarri:

- Pajisja me mjete zjarr-shuese (makina zjarrëfikëse etj.);
- Sigurim i aksesit të mirë në zonat potenciale të rënies së zjarrit, në mënyrë që të aksesohen lehtë nga automjetet dhe individët zjarrëfikës;
- Hartimi i Planeve të Zjarrit, të cilat duhet të hartohen duke marrë parasysh të gjitha masat e parandalimit dhe shuarjes së zjarreve për të gjitha zonat potenciale, dhe duhet të rishikohen periodikisht në mënyrë rigoroze. Planet duhet të jenë të pajisura me hartëzimin e të gjitha zonave potenciale, aksesin përkatës, dhe të gjitha burimet e mundshme ujore në afërsi të tyre;
- Ndalueset e Zjarrit dhe Brezat e Sigurisë reduktojnë dhe vonojnë përhapjen e zjarrit, si dhe rregullojnë qarkullimin dhe aksesin e mjeteve dhe të personave që do të asistojnë emergjencat. Rekomandohet të kenë minimumi 10m gjerësi, dhe mund të realizohen si konture përreth zonave të rrezikuara. Përgjithësisht përbëhen nga grupe bimësish që janë më rezistente ndaj zjarrit, që ndihmojnë në mbajtjen pastër

të dyshemesë së pyjeve, si dhe vonojnë përhapjen e zjarrit. Vendndodhja e tyre varet nga shtrirja e zonave të rrezikuara ndaj zjarrit dhe burimeve të zjarrit në afërsi.

Për të siguruar mbrojtjen maksimale duhet që të jenë vazhdimisht në mirëmbajtje dhe kontroll të vazhdueshëm;

- Përmirësimi i aksesit me rezervuaret në afërsi të zonave të rrezikuara. Do të identifikohen të gjitha burimet ujore natyrore dhe të ndërtuara nga njeriu, në afërsi të zonave të rrezikuara dhe do të sigurohet akses për të përdorur këto burime në rast emergjencash. Struktura të posaçme që grumbullojnë ujërat e shirave do të ndërtohen gjithashtu në afërsi, si një metodë alternative për të siguruar ujë, sidomos gjatë sezoneve të thata;

- Trajnimi i popullsisë lokale për të manaxhuar situatat e emergjencave përbën një tjetër masë të rëndësishme. Këtë Bashkia Dropull do ta realizojë në bashkëpunim me OJQ mjedisore, ekspertë mjedisorë, Bashki Fqinje me të cilat ndaj sipërfaqe pyjore të rrezikuara, si dhe më Ministrinë e Mjedisit.


Shënim: Për Zonat e Mbrojtura do të ndiqet Ligji në fuqi.

Programi Strategjik OS4PS2: Masa për manaxhimin e thatësirave ekstreme.

Ndonëse zona e Dropullit ndodhet në një nga territoret më të pasura me burime ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore, thatësira e skajshme gjatë stinës së verës përbën një problematikë madhore. Në këtë kuadër disa nga masat që do të ndërmerren janë:

- Krijimi i Planit të Manaxhimit të burimeve ujore. Ky Plan përpos se do të bëjë një hartëzim të të gjitha burimeve, sipas origjinës, përdorimit, kapacitetit, si dhe karakteristikave të tjera, do të krijojë mundësinë e identifikimit edhe të pikave të tyre kritike, duke i lidhur ato më tej me masat përkatëse manaxhuese;
 - Rehabilitimi i rezervuarëve ujorë ekzistues;
 - Planifikimi i krijimit të rezervuarëve të rinj (lerat për bagëtitë etj.), aty ku është e nevojshme (pranë fermave bujqësore, ose blegtorale);
 - Ngritja e pikave të posaçme që bëjnë grumbullimin e ujërave të shiut gjatë sezoneve më të lagështa, për t'u përdorur më pas në periudha krize për ujitje në sistemin bujqësor, shuarje zjarresh, ose pas trajtimeve përkatëse edhe si ujë për gjënë e gjallë në sistemin blegtoral.
- Programi Strategjik OS4PS3: Manaxhimi i rreziqeve natyrore (erozioni, rrëshqitjet e tokës etj.).**

Hartimi i një Plan Manaxhimi ndaj këtyre



*Harta: Objektivi Strategjike 4, Mbrojtja e Pejsazhit , Habitave dhe Mobilizimi ndaj Emergjencave:
Rreziku ndaj Zjarreve*



*Source/ General Local Plan of Dropull
Municipality, E. Janku*





rreziqeve është majft prioritar për Bashkinë Dropull, dhe në kudër të këtij Plani, disa nga masat që do të merren sidomos në kuadër të mbrojtjes nga erozioni dhe rrëshqitjet janë:

- Shtimi i pyllëzimit;
- Krijimi i argjinaturave përgjatë zonave të rrezikuara;
- Ndërmarrja e masave të posaçmë inxhinierike sipas rasteve specifike;
- Prezantimi i politikave dhe masave të rrepta për mbrojtjen e pyjeve, duke rritur kontrollin dhe vigjilencën gjithashtu (sidomos në Njësinë e Pogonit);

Programi Strategjik OS4PS4: Manaxhimi i pyjeve dhe kullotave.

Hartimi i Planit të Manaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave është një nga Projektet kryesore Strategjike të këtij Programi. Ky Plan do të mundësojë jo vetëm mbrojtjen e tyre, por dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm për të siguruar të ardhura të mjaftueshme për popullsinë dhe Bashkinë e Dropullit.

Programi Strategjik OS4PS5: Manaxhimi i mbetjeve dhe promovimi i riciklimit dhe kompostimit. Shërbimi i mbledhjes dhe manaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Dropull ofrohet përmes një firme të kontraktuar për mbulimin e këtij shërbimi në territorin e Bashkisë. Mbledhja realizohet me një makinë grumbulluese në një frekuencë kohore 2 herë në javë, dhe mbledhen mbetjet e një totali prej rreth 70-80 koshash, ose rreth 793 ton mbetje. Derdhja e tyre bëhet në Taroinë, pranë zonës së Peshkëpisë, dhe pa mundësi mbërritjeje në një landfill rajonal.

Në këto kushte synohet së pari shtimi i koshave të grumbullimit të mbetjeve në të gjitha zonat e banuara të Bashkisë Dropull, në njësitë ekonomike bujqësore dhe blegtorale (sidomos fermat), dhe bizneset e njësitë e përpunimit. Në bazë të popullsisë dhe të sasisë së prodhimit të mbetjeve do të përcaktohen dhe frekuencat e grumbullimit dhe itineraret përkatëse. Për zonat që paraqesin vështirësi në akses (veçanërisht zona e Pogonit), do të përcaktohen disa pika (stacione) transferimi të mbetjeve. Pas grumbullimit të përgjithshëm të mbetjeve do të behët transferimi i tyre në Landfill-in e Subashit, një bashkëpunim të cilin Bashkia Dropull dhe Bashkia Gjirokastrë kanë dakortësuar sëbashku. Gjithashtu do të krijohen kushtet e përshtatshme për riciklimin e mbetjeve, ku kompani të ndryshme riciklimi do të mund të bëjnë tërheqjen e mbetjeve sipas kategorive.

Bashkia do të ndërmarrë nismën të bëjë ndarjen e mbetjeve në burim dhe të stimulojë riciklimin e tyre më tej. Së

pari nisma do të aplikohet në 4 qendrat më të mëdha të banuara, pra 4 polet kryesore Dervician, Jorgucat, Vrisera dhe Poliçan, e më tej në të gjithë territorin. Për të implementuar këtë nismë Bashkia do të realizojë një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi për të gjithë banorët, si dhe do të pajisë çdo vend grumbullim më kosha të dedikuar mbledhjes së ndarë të mbetjeve, në: letra, qelq, plastikë dhe të përgjithshme. Pjesë e kësaj fushate dhe nisme, do të jetë edhe kompostimi, i cili sidomos në zonën e Dropullit ka mjaft hapësirë dhe mundësi të aplikohet, duke rritur mjaft përfitimet në fushën e bujqësisë. Kompostimi do të bëhet në bazë:

1. Kompostimi në bazë Ferme / Familje / Bujtine

Për aplikimin e kësaj politike Bashkia do të shpërndajë kutia kompostimi me madhësinë 1m3, të cilat do të shërbejnë për depozitimin e mbetjeve organike. Lënda e përfutur më pas do të mund të përdoret nga vetë fermat, familjet dhe bujtinat për qëllime bujqësore.

2. Kompostimi në bazë Njësive Administrative


Veçanërisht Njësitë Dropull i Poshtëm dhe Dropull i Sipërm janë ndër prodhuesit kryesorë të mbetjeve organike, duke qenë se kanë dhe sipërfaqen më të madhe të tokave bujqësore. Duke përdorur këtë potencial, do të krijohen qendra të posaçme kompostimi, dhe materialet e përfutura prej tyre do të mund të përdoren më pas si bazë për prodhimin bujqësor. Për çdo fermë do të ofrohet një kuti me material ekologjik, në të cilën do të vendosen mbetjet organike. Më pas do të jetë Bashkia ajo që do të realizojë transferimin e tyre tek qendrat e kompostimit. Bazuar në sasinë e depozituar nga secila fermë, ose grupim fermerësh, do të kryhet më tej shpërndarja e plehut, për të krijuar kështu një shërbim sa më cilësor dhe të drejtë.

4.2 Konsiderata Financiare

Bashkia e Dropullit përsa i përket nivelit të të ardhurave të gjeneruara nga burimet e veta, paraqet një nivel të ulët autonomie financiare përgjatë 5-viteve të konsideruara. Pas Reformës Territoriale dhe në vijim të Ligjit për vetë-qeverisjen vendore, Bashkia e re e Dropullit përballlet me sfidën e manaxhimit të burimeve financiare të kufizuar, përkundrajt nevojave gjithnjë e në rritje për shërbime dhe investime kapitale.

Në këtë kontekst planifikimi strategjik i investimeve kapitale në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike në territorin në administrim





Harta e Menaxhimit të Pyjeve, Kullotave, Monumeteve të Kulturës dhe Zonave të Mbrojtura.



Source/ General Local Plan of Dropull Municipality, E. Janku



Harta e Bashkisë Dropull Sipas Pesë Sistemeve të territorit, Ndryshimet nga Objektivat.



rezulton i domosdoshëm dhe një parakusht për zhvillimin ekonomik vendor. Rrjedhimisht vlerësohet thelbësor fuqizimi dhe përmirësimi i performancës financiare përsa i përket të ardhurave (veçanërisht rritja e mëtejshme e bazës së taksueshme dhe tatim paguesve) si dhe racionalizimi i shpenzimeve (kryesisht ato administrative dhe operative). Ligji i ri për Buxherin Vendor i vitit 2016 solli disa risi përsa i përket nivelit, llojit dhe numrit të taksave.

Përgjithësisht, në periudhën afatshkurtër efektet e heqjes së disa taksave dhe futjes/modifikimit të disa të tjera vlerësohet të kundër-bilancojnë njëra tjetrën, duke u përkthyer në një efekt pothuajse neutral për buxhetin vendor. Në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të veta të bashkisë, përdorimi i instrumenteve financiarë si huaja nga sistemi bankar (në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi), fondet shtetërore nga (FZHR, FSHZH etj) të orientuara kryesisht në mbështetje të zhvillimit të infrastrukturës, fondet nga donatorët e

huaj (Banka Botërore, USAID, KwË, WBIF, etj) për çështje që lidhen me trajtimin e mbetjeve dhe ujërave, asistencë teknike dhe ndërtim kapacitetesh, apo edhe format e partneritetit publik-privat, paraqesin një mundësi reale për realizimin e investimeve kapitale.

Në këtë drejtim, vlerësohet e domosdoshme rritja e kapaciteteve të bashkisë në drejtim të hartimit, menaxhimit, zbatimit dhe monitorimit të projekteve të investimeve nëpërmjet këtyre formave të financimit. Një burim tjetër të ardhurash, i cili kërkon ngritje të kapaciteteve lokale është i lidhur me programet e huaja të tilla si programi për Bashkëpunimin Ndërkufitar IPA me Greqinë, HORIZON 2020, etj. Në kuadër të këtyre programeve është e rëndësishme që të krijohen strukturat e duhura të bashkëpunimit, në mënyrë që të përfitohen projekte dhe të ardhura shtesë për realizimin e tyre.



Source/ General Local Plan of Dropull Municipality, E. Janku